

Publikationen

zur rechtlichen Zusammenarbeit

botuar nga
Enti për përfaqësim te Republikës së
Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ
dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e
regjistruar (IRZ)



Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Botimi 1/2020, vëllimi i 9-të, viti i 6-të
Aktuelle Rechtsprechung des EGMR
Newsletter 1/2020, 9. Band, 6. Jahrgang



Република Северна Македонија
Министерство за правда

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2020

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 12-65)

Blerina Starova Zlatku (faqe 66-93)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, Drejtor i Fushës së Projektit për Europën Juglindore I (Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi), dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RMV-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe:

Sonya Zayneb Ouertani – menaxher projekti në IRZ-ë dhe Rita Linderöth, Menaxhere e Lartë e Projektit pranë IRZ-së

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i tij u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
para GJEDNJ-së

dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 1/ 2020, vëllimi i 9-të, viti i 6-të, në gjuhën shqipe

~~~~~

Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von der Regierungsvertreterin von  
Nordmazedonien vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 1/2020, 9. Band, 6. Jahrgang in albanischer Sprache

*Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leserinnen und Leser,*

Sie halten eine neue Ausgabe des bereits im sechsten Jahr erscheinenden Newsletters zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richterinnen und Richtern, Staatsanwältinnen und -anwälten sowie Behördenmitarbeiterinnen und –mitarbeitern in Nordmazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Nordmazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Nordmazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der Regierungsvertreterin von Nordmazedonien und Direktorin des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V., der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., und der Ost-Ausschuss - Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen wie die Bayer AG sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Nordmazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch

*Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashura lexuese dhe lexues,*

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të gjashtë të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatorëve de operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtareve dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe prokurorëve dhe punonjëseve dhe punonjësve të organeve administrative në Maqedoninë e Veriut. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë së Veriut ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë e Veriut janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterin), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Komisioni i Lindjes - Shoqata e Europës

eine institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristinnen und Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen.

Der vorliegende Newsletter wird auch in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> und die albanische unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Praktika gjyqësore, Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle anderen Urteile des EGMR gegen Nordmazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigsten Rechtsprechungen des EGMR sind deshalb mithilfe dieses Newsletters allen Richterinnen und Richtern sowie Staatsanwältinnen und -anwälten in Nordmazedonien zeitnah direkt auf ihren eigenen Schreibtischen zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet.

Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Ost-Ausschuss - Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Bayer AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoninë e Veriut IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit (MFDK).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislationit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike.

Edhe ky buletin do të botohet në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së tek adresa

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> dhe versioni në shqip tek adresa

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm



Deshalb gilt Frau Botschafterin Anke Holstein und ihren Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV), dass die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzerinnen und Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Das sind bei der IRZ Frau Sonya Zayneb Ouertani und Frau Rita Linderoth, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin und Senior Projektmanagerin betreut haben und Frau Nata-scha Andreevsk-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Leserinnen und Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe dieser Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im Dezember 2020

***Danica Djonova LL.M***

*Kommissarische Direktorin des Büros  
für die Vertretung Nordmazedoniens  
vor dem EGMR*

***Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner***

*Leiter des Projektbereichs Südosteuropa I  
(Bosnien und Herzegowina, Montenegro,  
Nordmazedonien und Serbien)*

nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlini plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zonjës Ambasadore Anke Holstein dhe kolegëve të sai me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministrinë gjermane të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MFDK), e cila ka mundësuar punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve dhe përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura .

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegeve dhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij bulletini. Këto janë në IRZ-ë Zj Sonya Zayneb Ouertani dhe Z Rita Linderoth, të cilat janë kujdesur për këtë botim në Bon si menaxhere projekti dhe Zj Natascha Andreevska-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ- në bashkërendimin me partnerin e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexueset dhe lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, dhjetor 2020

**Danica Djonova LL.M.**

*Drejtore e Komanduar e Agjencisë  
për përfaqësimin e Maqedoninë e Veriut  
para GJEDNJ-së*

**Avokat Dr. Stefan Pürner**

*Drejtor i Fushës së Projektit  
për Europën Juglindore I  
(Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi,  
Maqedonia e Veriut dhe Serbi)*

## Përmbajtja

|                                    |     |
|------------------------------------|-----|
| <i>Parathënia e botuesve</i> ..... | 4-5 |
|------------------------------------|-----|

### I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

|                                                                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <i>Ilgar Mammadov kundër kundër Azerbajxhanit (çështje gjyqësore për mosrespektim vendimi) [DHM] - 15172/13, Vendimi 29.5.2019 [DHM]</i> ..... | 12 |
| <i>Sigurður Einarsson dhe të Tjerë kundër Islandës - 39757/15, Vendimi 4.6.2019 [Seksioni II]</i> .....                                        | 16 |
| <i>Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë [DHM] - 41720/13, Vendimi 25.6.2019 [DHM]</i> .....                                                 | 19 |
| <i>López Ribalda dhe të Tjerë kundër Spanjës - 1874/13 dhe 8567/13 Vendimi 17.10.2019 (DHM)</i> .....                                          | 26 |
| <i>Iliasi dhe Ahmedi kundër Hungarisë [DHM] - 47287/15, Vendim 21.11.2019 [DHM]</i> .....                                                      | 30 |
| <i>Z.A. dhe të Tjerë kundër Rusisë [DHM] - 61411/15, 61420/15, 61427/15 et al., Vendimi 21.11.2019 [DHM]</i> .....                             | 38 |
| <i>Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë - 41288/15, Vendimi 14.1.2020 [Seksioni II]</i> .....                                                | 44 |
| <i>Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë [DHM] - 201/17, Vendim 20.1.2020 [DHM]</i> .....                                                | 49 |
| <i>Buturugă kundër Rumanisë - 56867/15, Vendim 11.2.2020 [Seksioni IV]</i> .....                                                               | 53 |
| <i>N.D. dhe N.T. kundër Spanjës [DHM] - 8675/15 dhe 8697/15, Vendimi 13.2.2020 [DHM]</i> .....                                                 | 55 |
| <i>S.M. kundër Kroacisë [DHM] - 60561/14, Vendimi 25.6.2020 [DHM]</i> .....                                                                    | 60 |

## II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

|                                                                                                                                                                                    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Arsovski</b> , A. nr.30206/06, aktgjykim nga data 7 shkurt 2019 .....                                                                                                           | 66 |
| <b>Ziberi</b> , A.nr.2166/15, aktgjykim nga data 6 qershor 2019 .....                                                                                                              | 68 |
| <b>Bileski kundër Maqedonisë së Veriut</b> , A.nr.78392/14,<br>aktgjykim nga data 6 qershor 2019 .....                                                                             | 69 |
| <b>ASP PP SHPKNJ P</b> , A.nr.66313/14, aktgjykim nga data 6 qershor 2019.....                                                                                                     | 71 |
| <b>Atanasov</b> , A.nr.46082/14, aktgjykim nga data 26 shtator 2019 .....                                                                                                          | 72 |
| <b>Jakimovski dhe Kari transport</b> , A.nr.51599/11,<br>aktgjykim nga data 14 nëntor 2019 .....                                                                                   | 73 |
| <b>Romeva kundër Maqedonisë së Veriut</b> , A.nr.32141/10,<br>aktgjykim nga data 12 dhjetor 2019.....                                                                              | 75 |
| <b>Sinadinovska</b> , A.nr.27881/06, aktgjykim nga data 16 janar 2020 .....                                                                                                        | 78 |
| <b>L.R.</b> , A.nr. 8067/15, aktgjykim nga data 23 janar 2020 .....                                                                                                                | 82 |
| <b>Trajkovski dhe Çipovski</b> , A.nr. 53205/13 dhe 63320/13,<br>aktgjykim nga data 13 shkurt 2020 .....                                                                           | 86 |
| <b>Strezovski dhe 7 aplikantë të tjerë</b> , A.nr.14460/16, 14958/16,<br>14962/16, 14966/16, 27884/16, 16064/17, 20229/17 dhe 30206/17,<br>aktgjykim nga data 27 shkurt 2020 ..... | 88 |
| <b>Auto Atom SHPK Koçani</b> , A.nr.21954/16, aktgjykim nga data 28 maj 2020 .....                                                                                                 | 92 |

## I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 46

#### Neni 46-4, Çështje gjyqësore për mosrespektim vendimi

Çështje gjyqësore kundër Azerbajxhanit për mosrespektimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Europiane: shkelje

***Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit (çështje gjyqësore për mosrespektim vendimi) [DHM] - 15172/13, Vendimi 29.5.2019 [DHM]***

**Faktet** - Në vitin 2013, kërkuesi, një politikan i opozitës, u akuzua për vepra penale dhe u vendos në paraburgim pasi komentoi për çështje politike në blogun e tij personal. Në një vendim të datës 22 maj 2014 (më poshtë “vendimi i parë Mammadov” - shih Shënimin Informativ 174), Gjykata Europiane gjeti një shkelje të të drejtave të kërkuesit sipas Nenit 5 § 1 (c) dhe 4, Nenit 6 § 2 dhe Nenit 18 të Konventës.

Në vijim kërkuesi u dënua. Në një vendim të 16 nëntorit 2017 (Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit (nr. 2), 919/15 - më poshtë “vendimi i dytë Mammadov”), Gjykata konstatoi se procedimet penale në lidhje me të kishin qenë të padrejta dhe në shkelje të Nenit 6 § 1.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës sipas Nenit 46 të Konventës, miratoi një seri vendimesh dhe rezolutash të përkohshme duke theksuar të metat themelore në procedurat penale të vëna në dukje në konkluzionet e Gjykatës sipas Nenit 18 të Konventës të kombinuar me Nenin 5 dhe duke kërkuar lirin e menjëhershëm dhe të pakushtëzuar të kërkuesit.

Më 5 dhjetor 2017, në Rezolutën e tij të Përkohshme CM/ResDH (2017)429, Komiteti i Ministrave vendosi t’i referonte Gjykatës, në përputhje me Nenin 46 § 4 të Konventës, pyetjen nëse Republika e Azerbajxhanit kishte dështuar të përmbushte detyrimin e saj sipas Nenit 46 § 1 për të respektuar vendimet përfundimtare të Gjykatës, dhe në veçanti vendimin e parë Mammadov.

Kërkuesi u la i lirë në 13 gusht 2018, pas një vendimi të Gjykatës së Apelit.

**Ligji** - Neni 46: Meqenëse kjo ishte hera e parë që Komiteti i Ministrave filloi procedurat e shkeljes, Gjykata sqaroi natyrën e detyrës së saj në dritën e historikut të hartimit të Protokollit Nr. 14 dhe kornizës ligjore përkatëse për procesin e ekzekutimit, përkatësisht Nenit 46 të Konventës.

Procedurat e shkeljes nuk ishin konceptuar për të prishur ekuilibrin themelor institucional midis Gjykatës dhe Komitetit të Ministrave. Ky i fundit ishte kompetent për të vlerësuar masat specifike që duhen marrë nga një Shtet për të siguruar dëmshpërblimin maksimal të mundshëm për shkeljet e gjetura në një vendim. Detyra e Gjykatës në procedurat e shkeljes ishte të bënte një vlerësim përfundimtar juridik të çështjes së pajtueshmërisë me vendimin në fjalë. Përkundër këtij sfondi, Gjykata do të kryente vlerësimin e saj duke marrë parasysh përfundimet e Komitetit të Ministrave në procesin e mbikëqyrjes, pozicionin e Qeverisë së paditur dhe parashtrimet e viktimës së shkeljes. Gjykata duhet të identifikojë detyrimet ligjore që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë, si dhe konkluzionet dhe frymën e këtij vendimi.

Data në të cilën Komiteti i Ministrave i referoi një pyetje Gjykatës në lidhje me pajtueshmërinë me një vendim ishte data në të cilën ajo gjykoi se Shteti në fjalë kishte refuzuar të respektonte një vendim të formës së prerë, sepse Komiteti nuk mund të konsideronte që veprimet e Shtetit të ishin “në kohë, të përshtatshme dhe të mjaftueshme”. Gjykata mori mendimin se pikëfillesa për shqyrtimin e saj duhet të jetë momenti kur një pyetje e tillë i drejtohet asaj.

Nuk përjashtohet që kompetencat e dhëna Komitetit të Ministrave sipas Nenit 46 nënkuptojnë gjithashtu që Komiteti mund të tërheqë një çështje të referuar Gjykatës. Sidoqoftë, Komiteti nuk e kishte bërë këtë pas lirim të kërkuarit.

(a) Objekti i kësaj çështjeje gjyqësore për mosrespektimin e vendimit - Pyetja thelbësore ishte nëse kishte pasur një dështim nga Republika e Azerbajxhanit për të miratuar masat individuale të nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës dhe për të korrigjuar shkeljen e Nenit 18 të Konventës të marrë në lidhje me Nenin 5.

(b) Masat individuale

(i) Vendimi i parë Mammadov

(α) Teksti i vendimit - Gjetjet e Gjykatës për shkeljen e Nenit 5 § 1 (c) të Konventës dhe të Nenit 18 të marra së bashku me Nenin 5 zbatohen për tërësinë e akuzave dhe procedurave paragjyqësore kundër kërkuarit. Shkelja e Nenit 18 kishte ndodhur sepse veprimet e autoriteteve ishin drejtuar nga arsye të papërshtatshme, pasi ato i kishin ngritur akuzat në mënyrë që të heshtnin ose ndëshkonin kërkuarin për kritikën

e tij ndaj Qeverisë. Kjo gjetje kishte dëmtuar çdo veprim që rezultonte nga ngritja e akuzave.

(β) Detyrimet përkatëse për Shtetin - Vendimi i parë Mammadov dhe detyrimi përkatës i *restitutio in integrum* fillimisht e kishin detyruar Shtetin të hiqte ose anulonte akuzat e kritikuara nga Gjykata si abuzive dhe t'i jepte fund paraburgimit të kërkuesit. Në fakt, paraburgimi i tij kishte përfunduar kur ai u dënua nga gjykata e shkallës së parë në mars 2014; ky dënim ishte bazuar tërësisht në akuzat e kritikuara. Fakti që ai ishte ndaluar bazuar në atë dënim (në vend që të mbahej i ndaluar në paraburgim) nuk e kishte vendosur atë përsëri në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin injoruar. Prandaj, *restitutio in integrum* do të kishte kërkuar që pasojat negative të ngritjes së akuzave penale të kritikuara të eliminoreshin, përfshirë edhe lirimin e kërkuesit nga paraburgimi.

Qeveria kurrë nuk kishte argumentuar se kishte pasur pengesa për të arritur *restitutio in integrum* me shkakun se do të ishte “faktikisht e pamundur” ose do të përfshinte një “barrë jashtë çdo proporcioni”. Kështu, nuk kishte pasur pengesa për të arritur *restitutio in integrum* në çështjen në fjalë.

(g) Përfundim - Detyrimi përkatës i *restitutio in integrum* i kishte kërkuar Azerbajxhanit të eliminonte pasojat negative të ngritjes të akuzave penale të kritikuara nga Gjykata si abuzive dhe të lironte Z. Mammadov nga paraburgimi.

(ii) Nëse Azerbajxhani kishte dështuar të përmbushte detyrimin e tij sipas Nenit 46 1 për të respektuar një vendim të formës së prerë

(α) Nëse masat individuale kishin siguruar *restitutio in integrum* - Në kohën që Komiteti i Ministrave ia kishte referuar çështjen Gjykatës, ishte e qartë që procedurat e brendshme nuk kishin dhënë dëmshpërblim Në të vërtetë, kur rishqyrtoi dënimin e kërkuesit në vendimin e saj të 29 Prillit 2016, Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë si të pasakta gjetjet e Gjykatës në vendimin e parë Mammadov në bazë të Nenit 5 § 1 (c) dhe nuk kishte bërë asnjë referencë në shkeljet e tjera të gjetura, përfshirë atë të Nenit 18 të Konventës në lidhje me Nenin 5. Gjykata e Apelit kishte gjetur që provat e mjaftueshme ishin mbledhur dhe vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe objektive para gjykatës së shkallës së parë. Komiteti i Ministrave kishte ndjekur nga afër procedimet para gjykatave vendase dhe kishte arritur në përfundimin se këto gjykata nuk kishin eliminuar pasojat negative të shkaktuara nga shkelja e Nenit 18 në lidhje me Nenin 5 të përcaktuara në vendimin e parë Mammadov.

Gjykata tashmë kishte konkluduar se konstatimi i saj i shkeljes së Nenit 18 në lidhje me

Nenin 5 në vendimin e parë Mammadov kishte dëmtuar procedimet penale pasuese. Prandaj kishte qenë logjike të kërkohej që të sigurohej lirimi i kërkuarit urgjentisht. Edhe duke supozuar se për qëllime të restitutio in integrum ishte e mjaftueshme të pritej për procedurat e brendshme që pasuan për të korrigjuar problemet e gjetura në atë vendim, ato procedura të brendshme nuk e kishin bërë atë.

Defektet e identifikuara në vendimin e parë Mammadov ishin konfirmuar më vonë nga Gjykata në vendimin e dytë Mammadov, në të cilin gjeti se dënimi i kërkuarit ishte bazuar në prova të vesuara ose të paraqitura keq.

Si pasojë, Gjykata konsideroi se efektet e gjetjes së saj të shkeljes së Nenit 18 të Konventës në lidhje me Nenin 5 në vendimin e parë Mammadov nuk ishin zhvendosur nga vendimi i dytë Mammadov, i cili në fakt kishte konfirmuar nevojën për masat individuale të kërkuara nga vendimi i parë i Mammadov.

Qeveria kishte paraqitur vendimin e Gjykatës së Apelit të 13 gushtit 2018 si një mjet për të eliminuar pasojat negative të ngritjes së akuzave penale të kritikuara si abuzive. Sidoqoftë, Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë përsëri gjetjet e Gjykatës dhe parashikoi vetëm lirimin me kusht të kërkuarit. Ky libër me kusht më vonë ishte shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Supreme të 28 Marsit 2019, i cili konsideroi se dënimi i kërkuarit ishte kryer plotësisht. Arsytimi kryesor i vendimit të Gjykatës së Lartë kishte konfirmuar, në nivelin më të lartë gjyqësor, dënimin e kërkuarit dhe refuzimin e gjetjeve të Gjykatës Europiane nga gjykatat vendase.

(β) Konsiderata përfundimtare - Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës duhet të përfshijë mirëbesimin nga ana e Palës së Lartë Kontraktuese. E gjithë struktura e Konventës mbështetet në atë supozim të përgjithshëm. Kjo strukturë përfshinte procedurën e mbikëqyrjes dhe ekzekutimi i vendimeve duhet të përfshijë mirëbesimin dhe të zhvillohet në një mënyrë që përputhet me “konkluzionet dhe frymën” e vendimit. Për më tepër, rëndësia e detyrimit të mirëbesimit ishte thelbësore kur Gjykata kishte gjetur një shkelje të Nenit 18, objekti dhe qëllimi i të cilit ishte të ndalonte keqpërdorimin e pushtetit.

Sipas Protokollit Nr. 14, ekzekutimi i shpejtë dhe i plotë i vendimeve të Gjykatës ishte jetik për mbrojtjen e të drejtave të kërkuarit dhe sepse autoriteti i Gjykatës dhe besueshmëria e sistemit vareshin në një masë të madhe nga efektiviteti i këtij procesi.

Azerbajxhani kishte ndërmarrë disa hapa drejt ekzekutimit të vendimit të parë Mammadov. Ai kishte vënë në dispozicion të kërkuarit kompensimin e drejtë të dhënë nga Gjykata dhe gjithashtu kishte prezantuar një Plan Veprimi në nëntor 2014



i cili, sipas mendimit të tij, përcaktonte masat e afta për të ekzekutuar vendimin. Më 13 gusht 2018, Gjykata e Apelit kishte liruar kërkesin, megjithëse lirimi kishte qenë me kusht dhe kishte vendosur një numër kufizimesh për një periudhë prej gati tetë muajsh derisa masa të shfuqizohej nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të 28 Marsit 2019. Sidoqoftë, të dy vendimet ishin pas referimit në Gjykatë të pyetjes nëse Shteti i paditur kishte përmbushur detyrimet e tij në bazë të vendimit të parë Mammadov.

Këta hapa të kufizuar nuk lejuan që Gjykata të konkludonte se Shteti Palë kishte vepruar me “mirëbesim”, në një mënyrë që përputhet me “konkluzionet dhe frymën” e vendimit të parë të Mammadov, ose në një mënyrë që do ta bënte praktike dhe efektive mbrojtjen e të drejtave të Konventës të cilat Gjykata kishte konstatuar se ishin shkelur në atë vendim.

Gjykata arriti në përfundimin se Azerbajxhani kishte dështuar të përmbushte detyrimin e tij sipas Nenit 46 § 1 për t’iu përmbajtur vendimit Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit të 22 majit 2014.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

## Neni 6

### Neni 6-3-b, Lehtësi të përshtatshme

Mbrojtjes iu mohua aksesit tek masa e të dhënave dhe përfshirjen në filtrimin e tyre elektronik nga prokuroria kur grumbulloi informacionin e duhur për hetim: *nuk ka shkelje*

***Sigurður Einarsson dhe të Tjerë kundër Islandës*** - 39757/15, Vendimi 4.6.2019 [Seksioni II]

**Faktet** – Kërkesit ishin në pozicione të larta në një bankë që u shemb pas krizës bankare të vitit 2008 në Islandë. Ata u proceduan për shkelje të besimit ose manipulim të tregut dhe u shpallën fajtorë.

Kërkesit u ankuan se mbrojtjes së tyre nuk i ishte dhënë akses në masën e madhe të të dhënave të mbledhura nga prokuroria gjatë fazës së hetimit dhe, ndër të tjera, nuk ishin në gjendje të shpreheshin në lidhje me filtrimin elektronik të këtyre të dhënave nga prokuroria për të mbledhur informacion të rëndësishëm për përfshirje në dosjen e hetimit. Ata pohuan se askush nuk kishte rishikuar përzgjedhjen nga prokuroria të dokumenteve të paraqitura në gjykatë dhe se atyre u ishte mohuar mundësia e kryerjes së një kontrolli duke përdorur sistemin elektronik të aplikuar (që ishte

“Clearwell”, një sistem zbulimi -elektornik).

**Ligji** – Neni 6 §§ 1 dhe 3 (b): Kishte pasur disa koleksione të dokumenteve/të dhënave: “koleksion i plotë i të dhënave” që përfshinte të gjithë materialin e marrë nga prokuroria (dhe që u përfshi si një e dhënë e nën-kategorisë “e etiketuar” si rezultat i kërkimeve të Clearwell duke përdorur fjalë kyçe të specifikuar por që më vonë nuk u përfshi në dosjen e hetimit); “dokumentet e hetimit”, të identifikuar nga ai material me anë të kërkimeve të mëtejshme dhe rishikimit manual si potencialisht të rëndësishëm për çështjen; dhe “provat në çështje”, që është materiali i përzgjedhur nga “dokumentet e hetimit” dhe aktualisht i paraqitur në gjykatën e faktit nga prokuroria.

Ishte e padiskutueshme që mbrojtjes i ishin paraqitur “provat në çështje” dhe iu dha një mundësi për t’u konsultuar me “dosjen e hetimit” që përmbante materiale të cilat nuk ishin dorëzuar në gjykatën e brendshme. Problemi në këtë çështje ishte nëse mbrojtja kishte të drejtën e aksesit, nga njëra anë, në masën e informacionit të mbledhur pa dallim nga prokuroria dhe që nuk përfshihej në dosjen e hetimit; dhe, nga ana tjetër, tek të dhënat “e etiketuara” të marra nga kërkimet e Clearwell-it, në mënyrë që të identifikohen provat që mund të ishin shfajësuese.

(i) Në lidhje me “koleksionin e plotë të të dhënave” – Për nga natyra e tij, ai përfshinte në mënyrë të pashmangshme një masë të dhënë që prima facie nuk ishte e rëndësishme për çështjen. Për më tepër, kur prokuroria kishte në zotërim një vëllim të madh të materialit të papërpunuar, mund të ishte legjitime që ajo të filtronte informacionin në mënyrë që të identifikonte atë që mund të ishte e rëndësishme dhe kështu të zvogëlonte dosjen në përmasa të menaxhueshme. Sidoqoftë, në parim një garanci e rëndësishme në një proces të tillë do të ishte të sigurohej që mbrojtjes t’i jepej një mundësi për t’u përfshirë në përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e asaj që mund të jetë e rëndësishme.

Në këtë rast, megjithatë, kërkuesit nuk kishin treguar ndonjë çështje specifike e cila mund të ishte sqaruar nga kërkimet e mëtejshme. Në mungesë të një specifikimi të tillë - i cili ishte i hapur për ta sipas ligjit të brendshëm - Gjykata kishte vështirësi të pranonte që një “përpjekje kërkimi” e këtij lloji do të ishte e justifikuar. Në atë aspekt, të dhënat në fjalë ishin më të ngjashme me provat e tjera që mund të ekzistonin, por nuk ishin mbledhur nga prokuroria, sesa me provat për të cilat prokuroria kishte njohuri, por të cilat ajo refuzoi t’ia tregonte mbrojtjes.

Kështu, nuk ishte një situatë e fshehjes së provave ose “mos-zbulimit” në kuptimin klasik, pasi prokuroria në fakt nuk kishte qenë në dijeni të përmbajtjes së masës së të dhënave, dhe në këtë kuptim nuk kishte asnjë avantazh ndaj mbrojtjes.

(ii) Sa u përket të dhënave “të etiketuara” si rezultat i kërkimeve fillestare të programit Clearwell – Ndërsa po ashtu këtu materiali i përjashtuar nuk ishte i rëndësishëm a priori për çështjen, kjo përzgjedhje ishte bërë nga prokuroria vetëm, pa e përfshirë mbrojtjen dhe pa ndonjë mbikëqyrje gjyqësore të procesit.

Mbrojtjes i ishin mohuar listat e dokumenteve - dhe në veçanti dokumentet e “etiketuara” - me arsyetimin se ato nuk kishin ekzistuar dhe se nuk kishte asnjë detyrim për të krijuar dokumente të tilla, dhe gjithashtu iu bë referencë pengesave teknike për ri-mbledhjen e të dhënave dhe kryerja e kërkimeve të reja, duke pasur parasysh vëllimin në fjalë.

Sa i përket mohimit të listave, ndërsa sipas ligjit të brendshëm nuk kishte asnjë detyrim mbi prokurorinë për të krijuar dokumente të cilat nuk ekzistonin tashmë, kërkimet e mëtejshme në të dhënat do të kishin qenë teknikisht mjaft të drejtpërdrejta. Në parim do të ishte e përshtatshme që mbrojtjes t’i jepej mundësia e kryerjes së një kërkimi për prova potencialisht shfajësuese. Çështjet e privatësisë nuk ishin pengesa të pakapërcyeshme në atë drejtim. Kështu, çdo refuzim për të lejuar që mbrojtja të ketë kërkime të mëtejshme të dokumenteve të “etiketuara” të kryera në parim do të ngrinte një çështje sipas Nenit 6 § 3 (b) në lidhje me sigurimin e lehtësive të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes.

Thënë kjo, përkundër ankesave të shpeshta në prokurori për mungesën e aksesit në dokumente, kërkuesit kurrë nuk kishin kërkuar zyrtarisht një urdhër gjykate për qasje në “mbledhjen e plotë të të dhënave” ose për kërkime të mëtejshme që do të kryheshin. Ata as nuk kishin sugjeruar masa të mëtejshme hetimore - të tilla si një kërkim i ri duke përdorur fjalë kyçe të sugjeruara prej tyre. Kjo mundësi e një rishikimi nga një gjykatë ishte një garanci e rëndësishme për të përcaktuar nëse duhet të sigurohet akses i të dhënave. Për më tepër, midis provave të paraqitura në gjykatën e faktit ishin përmbledhja e sendeve të sekuestruara dhe një ide e përafërt e përmbajtjes së tyre.

Në ato rrethana, dhe duke pasur parasysh që kërkuesit nuk kishin dhënë ndonjë specifikim të llojit të provës që kishin kërkuar, mungesa e aksesit në të dhënat në fjalë nuk ishte e tillë që kërkuesve t’u ishte mohuar një gjykim i drejtë në përgjithësi.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (gjashtë vota me një).

Gjykata gjithashtu konstatoi, njëzëri, një shkelje të Nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së paanësisë objektive të një prej gjyqtarëve të brendshëm, djali i të cilit ishte një punonjës i lartë i bankës në fjalë në momentin përkatës, dhe asnjë shkelje të Nenit 6

§§ 1 dhe 3 (d) në lidhje me pretendimin e dështimit për të thirrur dëshmitarë.

Neni 41: Konstatimi i një shkeljeje përbënte kompensim të mjaftueshëm dhe të drejtë për çdo dëm jo-financiar.

## Neni 2

### Neni 2-1, Hetimi i efektshëm

Dështimi i pretenduar për të kryer hetim efektiv në aksidentin e trafikut rrugor në të cilin një individ pësoi dëmtime të paqëllimta me rrezik për jetën: Neni 2 i zbatueshëm; nuk ka shkelje

## Neni 3

### Trajtim poshtërues, trajtim çnjerëzor

Dështimi i pretenduar për të kryer hetim efektiv në aksidentin e trafikut rrugor në të cilin një individ pësoi dëmtime të paqëllimta me rrezik për jetën: Neni 3 nuk është i zbatueshëm

## Neni 8

### Neni 8-1, Respektimi i jetës private

Dështimi i pretenduar për të kryer hetim efektiv në aksidentin e trafikut rrugor në të cilin një individ pësoi dëmtime të paqëllimta me rrezik për jetën: Neni 8 nuk është i zbatueshëm

***Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë [DHM]*** - 41720/13, Vendimi 25.6.2019 [DHM]

**Faktet** - Në vitin 2004, kërkuesi pësoi një aksident të rëndë rrugor, i cili e la atë me një paaftësi të rëndë fizike. Aksidenti ndodhi natën në një rrugë publike, dhe përfshiu dy shoferë të tjerë. Makina e kërkuesit u spostua nga një automjet në lëvizje dhe goditi një automjet të parkuar. Autoritetet menjëherë filluan një hetim penal kundër kërkuesit dhe dy personave të tjerë të përfshirë. Sidoqoftë, ai hetim, dhe në veçanti hetimet për përgjegjësinë e njërit prej dy shoferëve të tjerë, përfundimisht u pushua nga prokuroria në 2012 me arsyetimin se jo të gjithë elementët përbërës të një veprë

penale ishin të pranishëm. Vendimi i prokurorit u la në fuqi nga një Gjykatë e Rrethit, e cila hodhi poshtë ankesën e kërkuesit si të parashkuar.

Në kërkesën e tij në Gjykatën Europiane, kërkuesi u ankua sipas Nenit 3 të Konventës që autoritetet vendase nuk e kishin shqyrtuar çështjen në themel ose nuk kishin hedhur dritë mbi rrethanat e aksidentit dhe kishin aplikuar një afat të veçantë për shoferin i cili dyshohet se e kishte shkaktuar aksidentin.

Më 18 maj 2017, Dhoma që merrej me çështjen hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

### ***Ligji***

(a) Ankesa e kërkuesit në lidhje me zhvillimin e hetimit penal

Gjykata dëshironte, me rastin e çështjes në fjalë, të sqaronte gamën e garancive përkatëse procedurale të përcaktuara jo vetëm në Nenet 3, 6 § 1 dhe 13, të kundërtuara nga kërkuesi, por edhe në Nenet 2 dhe 8 të Konventës.

(i) Zbatueshmëria e Nenit 3 (aspekti lëndor)

Problemet shëndetësore të kërkuesit kishin të bënin drejtpërdrejt, ose të paktën tërthorazi, me aksidentin e tij. Dëmtimi i shëndetit të tij kishte rezultuar nga ngjarje të rastësishme ose nga sjellje të pakujdesshme. Hetimi i nisur nga autoritetet për rrethanat e aksidentit kishte të bënte me një vepër të paqëllimshme. Sidoqoftë, dëmtimet fizike dhe vuajtjet fizike ose mendore të pësuar nga një person si rezultat i një aksidenti të shkaktuar nga rastësia ose sjellja e pakujdesshme nuk mund të konsiderohen si rezultat i “trajtimit” të cilit i ishte “nënshtruar” dikush, në kuptimin e Nenit 3. Një trajtim i tillë karakterizohet kryesisht, megjithëse jo ekskluzivisht, nga një synim për të dëmtuar, poshtëruar ose ulur individin duke minuar ose zvogëluar dinjitetin e tij ose të saj njerëzor, ose duke u përpjekur të zgjojë ndjenjat e frikës, ankthit ose inferioritetit për të thyer rezistencën morale dhe fizike të një individi.

***Përfundim:*** i papranueshëm (shkaku lëndor i papajtueshëm).

(ii) Zbatueshmëria e Nenit 8

Para së gjithash, dëmtimet e marra nga kërkuesi kishin të bënin me angazhimin e tij vullnetarisht në një aktivitet - drejtimin e një automjeti në një rrugë publike - e cila në thelb ishte ajo që ndodhi në publik. Është e vërtetë që nga natyra e saj, ky aktivitet përfshinte një rrezik që në rast aksidenti mund të ndodhin dëmtime serioze personale. Sidoqoftë, ky rrezik është minimizuar nga rregullimet e trafikut që synojnë të garantojnë sigurinë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës. Së

dyti, aksidenti nuk ndodhi si rezultat i një akti dhune që synonte të dëmtonte integritetin fizik dhe psikologjik të kërkuesit. As nuk mund të asimilohej me ndonjë nga llojet e tjera të situatave ku Gjykata kishte gjetur më parë detyrimin pozitiv të Shtetit për t'u angazhuar në mbrojtje të integritetit fizik dhe psikologjik të individëve. Përkundër këtij sfondi, nuk kishte asnjë aspekt të veçantë të ndërveprimit ose kontaktit njerëzor që mund të tërhiqte zbatimin e Nenit 8 të Konventës në çështjen në fjalë.

**Përfundim:** i papranueshëm (shkaku lëndor i papajtueshëm).

(iii) Zbatueshmëria e Nenit 2 (aspekti procedural)

Në kontekstin e aksidenteve dhe sjelljes së pretenduar të pakujdesshme, Neni 2 është i zbatueshëm nëse aktiviteti në fjalë është i rrezikshëm nga natyra e tij dhe vë jetën e kërkuesit në rrezik real dhe të afërt, ose nëse dëmtimet që kërkuesi ka pësuar ishin kërcënuese për jetën. Në situata të tilla, zbatohet detyrimi procedural për të kryer një hetim formal efektiv. Sa më pak i dukshëm të jetë rreziku real dhe i afërt që buron nga natyra e aktivitetit, aq më e rëndësishme është kërkesa për nivelin e dëmtimeve të pësuar nga kërkuesi. Kjo veçanërisht kur një aktivitet privat me rrezik të lartë rregullohet nga një kornizë e hollësishme legjislative dhe administrative, mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e të cilës për uljen e rrezikut për jetën e personave të përfshirë është tej çdo dyshimi ose nuk kontestohet.

Në situata kur nuk është e qartë në momentin e ngjarjes ose incidentit nëse jeta e viktimës është në rrezik real dhe të afërt, apo nëse dëmtimet e pësuar janë seriozisht të rrezikshme për jetën, Gjykata konsideron se do të ishte e mjaftueshme për zbatimin e Nenit 2, që rreziku të duket real dhe i afërt, ose dëmtimet të shfaqen kërcënuese për jetën kur ato ndodhin. Sapo një çështje e tillë të ketë rënë në vëmendjen e autoriteteve, Neni 2 i imponon Shtetit ipso facto një detyrim sipas Nenit 2 për të kryer një hetim efektiv. Ky detyrim vazhdon të zbatohet për sa kohë nuk është vërtetuar se rreziku për jetën nuk ishte real dhe i afërt ose se dëmtimet ishin qartësisht jo të rrezikshme për jetën.

Pavarësisht nëse drejtimi i automjetit mund të shihet si një aktivitet veçanërisht i rrezikshëm apo jo, kur rreziku që buron nga natyra e aktivitetit është më pak i dukshëm, niveli i dëmtimeve të pësuar nga kërkuesi merr një rëndësi më të madhe. Kështu, në kohën e aksidentit, ekzistonte një pretendim i diskutueshëm se plagët e tij ishin mjaft të rënda për të paraqitur një rrezik serioz për jetën e tij.

**Përfundim:** Neni 2 i zbatueshëm

(i) Shkaqet sipas Nenit 2 (aspekti procedural)

Në rastet që kanë të bëjnë me shkaktimin e paqëllimtë të vdekjes dhe/ose vënien në rrezik të jetës pa dashje, detyrimi procedural që rrjedh nga Neni 2 kërkon që sistemi ligjor i Shtetit t'u sigurojë kërkuesve një mjet juridik në gjykatat civile, por nuk kërkon që një hetim penal të kryet në lidhje me rrethanat e aksidentit. Në të njëjtën kohë, asgjë nuk mund të pengojë ligjin e brendshëm që të sigurojë një mundësi të tillë.

Procedurat civile të filluara nga kërkuesi kundër shoqërisë së sigurimeve, në kuadrin e së cilës ai më pas akuzoi gjithashtu kompaninë e dhënies me qira, ishin të parëndësishme. Ato kishin të bënin me përgjegjësinë e pretenduar të këtyre ndërmarrjeve për mos përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kontratave të lidhura me të, dhe jo me përgjegjësinë për shkelje të dy drejtuesve të tjerë si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

Zgjedhja e kërkuesit për të ndërhyrë në procedurat penale të nxitura nga autoritetet si palë civile nuk duket e paarsyeshme. Autoritetet vendase kishin konsideruar për një periudhë të konsiderueshme kohe se kishte arsye për një hetim penal në çështje. Për më tepër, ky mjet juridik siguroi një ekzaminim të përbashkët të përgjegjësisë penale dhe përgjegjësisë civile që burojnë nga e njëjta sjellje me faj, duke lehtësuar kështu mbrojtjen e përgjithshme procedurale të të drejtave në fjalë Zgjedhja e padisë civile në gjykimin penal mund të ketë qenë e preferueshme për kërkuesin sepse, edhe nëse ai mbante barrën e provës se pretendimi i tij ishte i bazuar, autoritetet hetuese ishin gjithashtu nën një detyrim për të mbledhur prova, përfshirë provat e gjetura në vendin e aksidentit. Mendimet e ekspertëve të kërkuara nga organet hetimore dhe provat e tjera të mbledhura prej tyre në gjykimin penal mund të ishin përdorur nga kërkuesi në çdo procedurë civile dhe ndoshta do të kishin qenë thelbësore për përcaktimin e pretendimit të tij civil.

Duke pasur parasysh përpjekjet e përsëritura të autoriteteve vendase për të sqaruar rrethanat e aksidentit, Gjykata konsideron se kërkuesi normalisht mund të kishte pritur që gjykimi penal i lartpërmendur të adresonte ankesat e tij. Në këto rrethana, fakti që kërkuesi dështoi të ngrejë një padi civile të veçantë kundër dy shoferëve të tjerë nuk mund të drejtohet kundër tij kur vlerësohet nëse ai kishte shteruar mjetet juridike të brendshme. Kundërshtimi i Qeverisë në bazë të mos-shterimit të mjeteve juridike të brendshme u rrëzua.

Për më tepër, nëse gjykohet efektive, gjykimi penal në fjalë ishte në vetvete i aftë të përmbushte detyrimin e Shtetit sipas Nenit 2 për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv. Në këtë drejtim, menjëherë pas aksidentit, policia nxiti, kryesisht, një hetim

penal për rrethanat e aksidentit dhe mbledhi prova të përshtatshme për të sqaruar rrethanat në të cilat kishte ndodhur.

Autoritetet hetimore identifikuan të gjithë shoferët e përfshirë në aksident, përfshirë kërkuesin, dhe morën prova gojore prej tyre dhe nga dëshmitarët okularë. Sapo e lejoi gjendja e tij mjekësore, kërkuesi u përfshi aktivisht në gjykim. Si gjatë hetimit dhe fazave të rishikimit gjyqësor ai kishte akses në dosjen e çështjes, ishte në gjendje të sfidonte pavarësinë dhe paanësinë e autoriteteve përkatëse, si dhe aktet dhe masat e zbatuara prej tyre, dhe të kërkonte që provat shtesë të përfshiheshin në dosje. Ai ishte në gjendje të ankimonte vendimet e zyrës së prokurorit publik. Fakti që disa nga kërkesat e tij për prova shtesë dhe disa nga kundërshtimet e tij u rrëzuan ose që Gjykata e Kasacionit përfundimisht lejoi që një nga kërkesat e tij për çështjen e tij të transferohej për shkak të dyshimit të arsyeshëm nuk tregon që autoritetet hetimore dhe gjykatat nuk ishin të gatshme të përcaktonin rrethanat e aksidentit dhe përgjegjësinë e atyre që ishin përfshirë ose që u mungonte pavarësia e duhur.

Për më tepër, duke pasur parasysh provat e disponueshme, pavarësisht parregullsive në mbledhjen e kampionëve të gjakut të kërkuesit, Gjykata nuk gjeti arsye të mjaftueshme për të konkluduar se hetimi ose mbledhja e provave përfundimisht nuk kishin qenë mjaft të plota. Vendimi i autoriteteve vendase për të ndërprerë gjykimin nuk ishte marrë me nxitim ose arbitrarisht, dhe vinte pas vitesh pune hetimore të cilat kishin rezultuar në akumulimin e një numri të madh provash, duke përfshirë elementet kriminalistike dhe teknike. Këto prova adresonin pyetjet e ngritura brenda kuadrit të procedurave penale, duke përfshirë çështjet në lidhje me sjelljen e shoferëve të përfshirë dhe shkaqet e aksidentit.

Autoritetet kishin hedhur poshtë disa nga kërkesat e kërkuesit për mbledhjen e provave, por atyre u duhej lejuar një farë diskrecioni në vendosjen se cilat prova ishin të rëndësishme për autoritetet e hetimit.

Procedimet në lidhje me rrethanat e aksidentit zgjatën mbi tetë vjet. Është e vërtetë që ka pasur disa vonesa në gjykim, por, duke pasur parasysh arsyet për disa nga këto vonesa, nuk mund të thuhet se ato kanë ulur efektivitetin e hetimit. Gjykata përsëriti në lidhje me këtë se pajtueshmëria me kërkesën procedurale të Nenit 2 u vlerësua në bazë të disa parametrave thelbësorë, të cilët ishin të ndërlidhur, por, ndryshe nga kërkesat e gjykimit të drejtë të përcaktuara në Nenin 6, secili prej tyre i marrë veç e veç nuk është një qëllim në vetvete. Ato ishin kritere të cilat, të marra bashkërisht, mundësuan që të vlerësohej shkalla e efektivitetit të hetimit. Ishte në lidhje me këtë qëllim të një hetimi efektiv që duhej të vlerësohej çdo çështje që dilte, përfshirë ato



të shpejtësisë dhe përshtatshmërisë së arsyeshme, (shih Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë [DHM], 24014/05, 14 Prill 2015, Shënim Informativ 184).

Neni 2 nuk garanton të drejtën për të vendosur një dënim penal kundër një pale të tretë. Në mungesë të mospasjes së dukshme të paplotësisë në shqyrtimin e rrethanave nga autoritetet që lidhen me aksidentin e kërkuarit, vendimi i tyre për të mos ndjekur penalisht nuk mjafton për të gjetur Shtetin e paditur përgjegjës sipas detyrimit të tij procedural që buron nga Neni 2.

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të hetimit penal, Gjykata arriti në përfundimin se nuk mund të thuhej që sistemi ligjor i zbatuar në rastin aktual kishte dështuar të merrej në mënyrë të përshtatshme me çështjen e kërkuarit.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (trembëdhjetë vota me katër).

(v) Vlerësimi i Neneve 13 dhe 6 § 1

Gjykata unanimisht arriti në përfundimin se ishte e panevojshme të shqyrtohej ankesa në lidhje me efektivitetin e hetimit penal sipas Nenit 13.

Gjykata gjithashtu nuk konstatoi, gjashtëmbëdhjetë vota me një, asnjë shkelje të Nenit 6 § 1, sepse nuk mund të thuhej që kërkuarit i ishte refuzuar aksesit në gjykatë për përcaktimin e të drejtave të tij civile gjatë gjykimit penal.

Gjykata më tej nuk konstatoi, dhjetë vota me shtatë, asnjë shkelje të Nenit 6 § 1 duke qenë se nuk kishte shkelje të kërkesës së “gjatësisë së arsyeshme” në funksion të kompleksitetit të çështjes dhe faktit që autoritetet kishin mbetur aktive gjatë gjykimit penal.

(b) Ankesa në lidhje me trajtimin nga autoritetet përgjegjëse për hetimin të pretenduar nga kërkuari

Neni 3 (aspekti lëndor): Në disa çështje të mëparshme, të tilla si ato që kishin të bënin me familjarët e personave që ishin zhdukur (Kurt kundër Turqisë, 24276/94, 25 maj 1998; Çakıcı kundër Turqisë [SHM], 23657/94, 8 korrik 1999, Shënim Informativ 8 ; dhe Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë [DHM], 16064/90 et al., 18 Shtator 2009, Shënim Informativ 122), Gjykata kishte marrë parasysh mënyrën në të cilën autoritetet e brendshme kishin trajtuar një hetim për të shqyrtuar nëse sjellja e tyre përbënte trajtim çnjerëzor ose poshtëruar në shkelje të aspektit lëndor të Nenit 3.

Në raste të tilla, Gjykata merr parasysh një sërë faktorësh në vlerësimin e saj nëse mënyra në të cilën u krye hetimi përbënte në vetvete një trajtim në kundërshtim me Nenin 3 për familjarët e viktimave. Elementet përkatëse përfshijnë afërsinë e

lidhjeve familjare, shkallën në të cilën anëtar i familjes ishte dëshmitar i ngjarjeve në fjalë, përfshirjen e anëtarit të familjes në përpjekjet për të marrë informacion në lidhje me personin e zhdukur dhe mënyrën në të cilën autoritetet u përgjigjën këtyre kërtimeve.

Gjykata gjithashtu zbatoi parimet e vendosura në çështjet vijuese:

- ndalimi dhe mos-kthimi e një azilkërkuesi të pashoqëruar nën moshë (Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga kundër Belgjikës, 13178/03, 12 tetor 2006, Shënim Informativ 90);
- pretendimet e abuzimit seksual të një fëmije brenda një familjeje (M.P. dhe të Tjerët kundër Bullgarisë, 22457/08, 15 nëntor 2011);
- kushtet në të cilat trupat e të afërmeve të vdekur ishin konservuar gjatë një procedure identifikimi (Sabanchiyeva dhe të Tjerët kundër Rusisë, 38450/05, 6 qershor 2013, Shënim Informativ 164);
- vdekja e një personi në mungesë të kujdesit të duhur mjekësor në paraburgim, pasuar nga një hetim i brendshëm jo i përshtatshëm (Salakhov dhe Islyamova kundër Ukrainës, 28005/08, 14 Mars 2013, Shënim Informativ 161); dhe
- vuajtje emocionale e shkaktuar një të afërmi nga heqja e indeve nga trupi i një të vdekuri pa dijeninë ose pëlqimin e të afërmit (Elberte kundër Letonisë, 61243/08, 13 Janar 2015, Shënim Informativ 181).

Sidoqoftë, kjo çështje nuk përfshihej në asnjë nga rrethanat e shqyrtuara në rastet e lartpërmendura.

**Përfundim:** i papranueshëm (qartazi i pabazuar).

(Shih gjithashtu, në lidhje me Nenin 3, Kraulaidis kundër Lituanisë, 76805/11, 8 nëntor 2016, dhe Mažukna kundër Lituanisë, 72092/12, 11 prill 2017; dhe, në lidhje me Nenin 8, Friend dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (dhjetor.), 16072/06, 24 nëntor 2009, Shënim Informativ 123 dhe Denisov kundër Ukrainës [DHM], 76639/11, 25 Shtator 2018, Shënim Informativ 221)

## Neni 8

### Detyrime pozitive, Neni 8-1, Respektimi i jetës private

Vëzhgimi i fshehtë në video i arkëtareve të supermarketit dhe asistentëve të shitjeve nga punëdhënësi: *nuk ka shkelje*

**López Ribalda dhe të Tjerë kundër Spanjës** - 1874/13 dhe 8567/13 Vendimi 17.10.2019 (DHM)

**Faktet** - Kërkuesit kanë punuar si arkëtarë dhe asistentë të shitjeve në një supermarket. Supermarketi po pësonte humbje ekonomike. Për të hetuar këto humbje, punëdhënësi i kërkuesve vendosi të instalojë kamera vëzhgimi. Disa nga kamerat ishin të dukshme, ndërsa të tjerët ishin të fshehura. Kërkuesit u njoftuan për praninë e kamerave që ishin të dukshme, por jo për ato që ishin të fshehura. Kërkuesit u pushuan nga puna kur pamjet në video treguan se ata kishin vjedhur sende.

Me vendimin e datës 9 janar 2018 (Shih Shënimin Informativ 214), një Dhomë e Gjykatës u shpreh, gjashtë vota me një, që ka patur shkelje të Nenit 8. Sipas gjykatës, vëzhgimi në video i kryer nga punëdhënësi, që kishte ndodhur për një periudhë të zgjatur kohe, nuk ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në legjislacionin përkatës. Për më tepër, gjykatat e brendshme nuk kishin arritur të vendosnin një ekuilibër të drejtë midis të drejtës së kërkuesve për të respektuar jetën e tyre private dhe interesit të punëdhënësit të tyre për mbrojtjen e të drejtave të tij të pronës.

Më 28 maj 2018, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

**Ligji** - Neni 8

(a) Zbatueshmëria - Kërkuesit i ishin nënshtruar një mase mbikëqyrjeje me video të zbatuar nga punëdhënësi i tyre në vendin e tyre të punës për një periudhë prej dhjetë ditësh, ku kamerat ishin drejtuar drejt zonës së arkës së supermarketit dhe përreth saj. Kështu, ndërsa kërkuesit nuk ishin piketuar individualisht nga vëzhgimi në video, nuk ishte në diskutim që ata mund të ishin filmuar gjatë gjithë ditës së tyre të punës.

Lidhur me faktin nëse kërkuesit kishin pasur një pritshmëri të arsyeshme që jeta e tyre private do të mbrohej dhe respektohej, Gjykata vuri re se vendi i tyre i punës, një supermarket, ishte i hapur për publikun dhe se aktivitetet e filmuara atje - domethënë marrja e pagesave për blerjet nga klientët - nuk ishin të një natyre intime ose private. Prandaj, pritshmëria e tyre për mbrojtjen e jetës së tyre private ishte domosdoshmërisht e kufizuar. Sidoqoftë, edhe në vende publike, krijimi i një regjistrimi sistematik ose të përhershëm të imazheve të personave të identifikuar dhe përpunimi pasues i imazheve të regjistruara në këtë mënyrë mund të ngrejë pyetje që ndikojnë në jetën private të individëve në fjalë. E drejta e brendshme kishte siguruar një kornizë ligjore zyrtare dhe të qartë që e detyronte personin përgjegjës të sistemit të vëzhgimit me video, madje edhe në një vend publik, për t'u dhënë informacion paraprak personave që monitorohen nga një sistem i tillë. Kërkuesit ishin

informuar në lidhje me instalimin nga punëdhënësi i tyre i kamerave të tjera CCTV në supermarket dhe ato kamera kishin qenë të dukshme dhe të pozicionuara për të filmuar hyrjet dhe daljet në dyqan. Në ato rrethana, kërkuessit kishin një pritshmëri të arsyeshme që ata të mos i nënshtroheshin vëzhgimit me video në zonat e tjera të dyqanit pa u informuar më parë.

Sa i përket përpunimit dhe përdorimit të regjistrimeve video, ato ishin parë nga një numër njerëzish që punonin për punëdhënësin e kërkuessve edhe para se kërkuessit të informoheshin për ekzistencën e tyre. Për më tepër, ato përbënin bazën e shkarkimit të kërkuessve dhe ishin përdorur si prova në gjykimet në gjykatën e punës.

Kështu që Neni 8 ishte i zbatueshëm.

#### (b) Themeli

(i) Parimet e përgjithshme - Parimet e vendosura nga Gjykata në çështjen Bărbulescu kundër Rumanisë [DHM] ishin të transpozueshme, mutatis mutandis, në rrethanat në të cilat një punëdhënësi mund të zbatojë masat e mbikëqyrjes me video në vendin e punës. Këto kritere duhej të zbatoheshin duke marrë parasysh specifikën e marrëdhënieve të punës dhe zhvillimin e teknologjive të reja, të cilat mund të mundësojnë marrjen e masave që ishin gjithnjë e më ndërhyrëse në jetën private të punonjësve. Në atë kontekst, për të siguruar proporcionalitetin e masave të mbikëqyrjes me video në vendin e punës, gjykatat e brendshme duhej të merrnin parasysh faktorët e mëposhtëm gjatë peshimit të interesave të ndryshme konkurruese:

- nëse punonjësi ishte njoftuar mbi mundësinë e marrjes së masave të mbikëqyrjes me video nga punëdhënësi dhe për zbatimin e masave të tilla: ndërsa në praktikë punonjësit mund të njoftohen në mënyra të ndryshme, në varësi të rrethanave të veçanta faktike të secilit rast, njoftimi normalisht duhet të jetë i qartë për natyrën e monitorimit dhe të jepet para zbatimit;

- shkalla e monitorimit nga punëdhënësi dhe shkalla e ndërhyrjes në privatësinë e punëmarrësit: në lidhje me këtë, niveli i privatësisë në zonën që monitorohet duhet të merret parasysh, së bashku me çdo kufizim në kohë dhe hapësirë dhe numrin e njerëzve që kishin qasje në rezultate;

- nëse punëdhënësi kishte dhënë arsye të ligjshme për të justifikuar monitorimin dhe shkallën e tij: sa më ndërhyrës monitorimi, aq më i qenësishëm të ishte arsyetimi që do të kërkohej;

- nëse do të kishte qenë e mundur të vendoset një sistem monitorimi i bazuar në metoda

dhe masa më pak ndërhyrëse: në lidhje me këtë, duhet të ketë një vlerësim në dritën e rrethanave të veçanta të secilës çështje, nëse qëllimi i ndjekur nga punëdhënësi mund të ishte arritur pa ndërhyrë në privatësinë e punonjësit në një masë të tillë;

- pasojat e monitorimit për punonjësin që i nënshtrohet: duhet të merret parasysh, veçanërisht, përdorimi i bërë nga punëdhënësi i rezultateve të monitorimit dhe nëse këto rezultate janë përdorur për të arritur qëllimin e deklaruar të masës;

- nëse punonjësit ishin pajisur me garanci mbrojtëse të përshtatshme, veçanërisht kur operacionet e monitorimit të punëdhënësit ishin të një natyre ndërhyrëse: këto garanci mbrojtëse mund të marrin formën, ndër të tjera, të: ofrimit të informacionit për punonjësit në fjalë ose përfaqësuesit e personelit për sa i përket instalimit dhe shtrirjes së monitorimit; një deklarami i një mase të tillë para një organi të pavarur; ose mundësia e bërjes së një ankese.

(ii) Aplikimi - Gjykatat e punës kishin identifikuar interesa të ndryshëm në fjalë dhe kishin konstatuar që instalimi i vëzhgimit me video ishte justifikuar nga arsye legjitime, përkatësisht dyshimi se ishin kryer vjedhje. Gjykatat më pas kishin ekzaminuar shkallën e monitorimit dhe shkallën e ndërhyrjes në privatësinë e kërkuesve, duke zbuluar se masa ishte e kufizuar në lidhje me zonat dhe personelin që monitorohej dhe se kohëzgjatja e saj nuk kishte tejkaluar atë që ishte e nevojshme për të konfirmuar dyshimet për vjedhje. Ky vlerësim nuk mund të konsiderohej i paarsyeshëm.

Detyrat e kërkuesve ishin kryer në një vend që ishte i hapur për publikun dhe përfshinte kontakte të përhershme me klientët. Ishte e nevojshme që, në analizën e proporcionalitetit të një mase vëzhgimi me video, të dalloheshin vendet e ndryshme në të cilat ishte kryer monitorimi, në dritën e mbrojtjes së privatësisë që një punonjës normalisht mund të priste. Kjo pritshmëri ishte shumë e lartë në vende që ishin private nga natyra, të tilla si tualetet ose dhomat e zhveshjes, ku mbrojtja e shtuar, apo edhe ndalimi i plotë i mbikëqyrjes video, ishte i justifikuar. Mbetej lartë në mjediset e mbyllura pune siç janë zyrat. Ishte dukshëm më e ulët në vendet që ishin të dukshme ose të aksesueshme për kolegët ose, si në rastin e kërkuesve, për publikun e gjerë.

Kohëzgjatja e monitorimit (dhjetë ditë) nuk dukej e tepruar në vetvete. Vetëm menaxheri i supermarketit, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe përfaqësuesi i sindikatës kishin parë regjistrimet e marra përmes vëzhgimit të kundërshtuar me video përpara se të ishin informuar vetë kërkuesit. Duke marrë parasysh këta faktorë, Gjykata doli e mendimit se ndërhyrja në privatësinë e kërkuesve nuk kishte arritur një shkallë të konsiderueshme. Pasojat e monitorimit të kundërshtuar për kërkuesit kishin qenë të konsiderueshme. Sidoqoftë, vëzhgimi me video dhe regjistrimet

nuk ishin përdorur nga punëdhënësi për ndonjë qëllim tjetër përveç se për të gjurmuar ata që ishin përgjegjës për humbjet e regjistruara të mallrave dhe për të marrë masa disiplinore ndaj tyre. Për më tepër, shkalla e humbjeve të identifikuar nga punëdhënësi sugjeronte që vjedhjet ishin kryer nga një numër individësh dhe dhënia e informacionit çdo anëtar të personelit mund të kishte shmangur qëllimin e vëzhgimit me video, i cili ishte për të zbuluar ata që ishin përgjegjës për vjedhjet por edhe për të marrë prova për përdorim në procedimet disiplinore ndaj tyre.

Kërkesa për transparencë dhe e drejta pasuese e informimit ishin thelbësore në natyrë, veçanërisht në kontekstin e marrëdhënieve të punës, ku punëdhënësi kishte kompetenca të konsiderueshme në lidhje me punonjësit dhe çdo abuzim me këto kompetenca duhej të shmangej. Dhënia e informacionit individit që monitorohet dhe masa e tij përbënin vetëm një nga kriteret që duheshin marrë parasysh për të vlerësuar proporcionalitetin e një mase të këtij lloji në një rast të caktuar. Sidoqoftë, nëse një informacion i tillë mungon, garancitë mbrojtëse që vijnë nga kriteret e tjera do të ishin akoma më të rëndësishme. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh rëndësinë e së drejtës për informacion në raste të tilla, vetëm një kërkesë mbizotëruese në lidhje me mbrojtjen e interesave të rëndësishëm publikë ose privatë mund të justifikonin mungesën e informacionit paraprak.

Gjykatat e punës që kishin shqyrtuar pretendimet e kërkuarve kishin kryer një balancim të hollësishëm midis, nga njëra anë, të drejtës së tyre për respektimin e jetës së tyre private, dhe, nga ana tjetër, interesit të punëdhënësit për të siguruar mbrojtjen e pronës së tij dhe funksionimin e shoqërisë. Gjykatat e brendshme kishin verifikuar nëse vëzhgimi me video ishte justifikuar nga një qëllim legjitim dhe nëse masat e marra për atë qëllim ishin të përshtatshme dhe proporcionale, duke vërejtur në veçanti se qëllimi legjitim i ndjekur nga punëdhënësi nuk mund të arrihej me masa më pak ndërhyrëse për të drejtat e kërkuarve.

Në rrethanat specifike të çështjes, duke pasur parasysh veçanërisht shkallën e ndërhyrjes në privatësinë e kërkuarve dhe arsyet legjitime që justifikojnë instalimin e vëzhgimit me video, gjykatat e punës kishin qenë në gjendje, pa tejkalluar kufirin e vlerësimit të parashikuar për autoritetet e brendshme, të mbështesnin mendimin se ndërhyrja në privatësinë e kërkuarve kishte qenë proporcionale. Kështu, ndërsa Gjykata nuk mund të pranonte propozimin që, në përgjithësi, dyshimi më i vogël i keqpërdorimit ose ndonjë keqbërje tjetër nga ana e punonjësve mund të justifikojë instalimin e vëzhgimit me video të fshehtë nga një punëdhënësi, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se shkelja ishte kryer dhe shkalla e humbjeve të identifikuar në rast do të dukej se përbënin një justifikim të konsiderueshëm. Kjo për më tepër në një situatë

kur funksionimi normal i një shoqërie rrezikohet jo thjesht nga sjellja e dyshuar e një punonjësi të vetëm, por më tepër nga dyshimi për një veprim të përbashkët nga disa punonjës, pasi kjo krijoi një atmosferë të përgjithshme mosbesimi në vendin e punës.

Duke pasur parasysh garancitë domethënëse të parashikuara në kuadrin ligjor spanjoll, duke përfshirë mjetet juridike që kërkuesit nuk kishin përdorur dhe peshën e vlerësimeve që justifikonin vëzhgimin me video, siç u morën parasysh nga gjykatat e brendshme, autoritetet e brendshme nuk kishin dështuar të përmbushin detyrimet e tyre pozitive sipas Nenit 8, siç është tejkallimi i marzhit të tyre të vlerësimit.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (katërmbëdhjetë vota me tre).

Gjykata gjithashtu konstatoi, njëzëri, që nuk ka patur shkelje të Nenit 6 § 1, posaçërisht në lidhje me përdorimin e imazheve të vëzhgimeve në video.

(Shih Bărbulescu kundër Rumanisë [DHM], 61496/08, 5 shtator 2017, Shënim Informativ 210; Köpke kundër Gjermanisë (dec.), 420/07, 5 tetor 2010, Shënim Informativ 134; dhe Buletini Informativ mbi vëzhgimin në vendin e punës)

### Neni 3

#### Dëbimi

Dështimi i Shtetit të Paditur për të vlerësuar rrezikun e mohimit të aksesit në procedurat e azilit në një vend të tretë të konsideruar të sigurt, duke përfshirë rikthimin: *shkelje*

#### Trajtimi poshtërues

Kushtet e ndalimit në zonën transit: nuk ka shkelje

### Neni 5

#### Neni 5-1, Heqja e lirisë

De facto ndalimi që zgjat njëzet e tre ditë në zonën transit të kufirit tokësor: i papranueshëm

**Iliasi dhe Ahmedi kundër Hungarisë [DHM]** - 47287/15, Vendim 21.11.2019 [DHM]

**Faktet** – Kërkuesit, shtetas të Bangladeshit, mbërritën në zonën e transitit që gjendet në kufirin midis Hungarisë dhe Serbisë dhe paraqitën kërkesa për azil. Kërkesat e tyre u refuzuan dhe ata u shoqëruan përsëri për në Serbi.

Në gjykimin sipas Konventës, ata u ankuan, ndër të tjera, se heqja e lirisë së tyre në zonën e transitit kishte qenë e paligjshme, se kushtet e ndalimit të tyre të pretenduar të paligjshëm ishin të papërshtatshme dhe se dëbimi i tyre në Serbi i kishte ekspozuar ata ndaj një rreziku real të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues.

Me vendim të datës 14 mars 2017 (shih [Shënimin Informativ 205](#)) një Dhomë e Gjykatës vendosi, njëzëri, se kishte pasur një shkelje të Nenit 3 në lidhje me dëbimin në Serbi të kërkuësve dhe një shkelje të Nenit 5 § 1. Sipas mendimit të Gjykatës, autoritetet hungareze nuk i kishin përfillur raportet mbi vendin dhe provat e tjera të paraqitura nga kërkuësit dhe kishin vendosur një barrë të padrejtë dhe të tepruar të provës dhe nuk kishin arritur t'u siguronin atyre informacion të mjaftueshëm. Sa i përket Nenit 5 § 1, kërkuësit ishin privuar nga liria e tyre pa ndonjë vendim zyrtar të autoriteteve vetëm për shkak të një dispozite të përgjithshme të ligjit të interpretuar në mënyrë elastike.

Gjykata gjithashtu u shpreh, njëzëri, se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 3 në lidhje me kushtet e ndalimit në zonën e transitit, por shkelje të Nenit 5 § 4 dhe Nenit 13 të marra së bashku me Nenin 3.

Më 18 shtator 2014, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

### ***Ligji*** – Neni 3

#### **(a) Dëbimi në Serbi**

Kërkuësit nuk ishin larguar nga zona e transitit me vullnetin e tyre të lirë. Largimi i kërkuësve nga Hungaria për këtë arsye i ngarkohej Shtetit të paditur.

Përmbajtja e detyrave të Shtetit dëbues sipas Nenit 3 ndryshonte në varësi të faktit nëse vendi pritës ishte vendi i origjinës së azilkërkuësve ose një vend i tretë dhe, në situatën e fundit, nëse Shteti dëbues kishte shqyrtuar themelin e kërkesës për azil apo jo.

Gjykata shtoi se në të gjitha rastet e largimit të një azilkërkuësi nga një Shtet Kontraktues në një vend të tretë ndërmjetës pa shqyrtimin e kërkesave të azilit në themel, pavarësisht nëse vendi i tretë pritës është një Shtet Anëtar i BE-së apo jo, ose nëse ai është një Shtet Palë në Konventë apo jo, ishte detyra e Shtetit dëbues të shqyrtonte me hollësi çështjen nëse ekzistonte apo jo një rrezik real që azilkërkuësit t'i refuzohej hyrja në vendin e tretë pritës, në një procedim të përshtatshëm të kërkesës për azil, duke e mbrojtur atë nga rikthimi, domethënë, duke u larguar, drejtpërdrejt ose jo, në vendin e tij ose të saj të origjinës pa një vlerësim të duhur të rreziqeve me të



cilat përballet në këndvështrim të Nenit 3. Nëse vërtetohet se garancitë ekzistuese në këtë drejtim ishin të pamjaftueshme, Neni 3 nënkupton një detyrim që azilkërkuesit nuk duhet të zhvendosen në vendin e tretë në fjalë.

Përveç kësaj çështjeje kryesore, kur rreziku i pretenduar në lidhje me nënshtrimin ndaj një trajtimi në kundërshtim me Nenin 3 kishte të bënte, ndër të tjera, me kushtet e paraburgimit ose kushtet e jetesës për azilkërkuesit në një vend të tretë pritës, ai rrezik do të duhej të vlerësohej gjithashtu nga Shteti dëbues.

Nëse është konstatuar ex post facto në procedimet kombëtare ose ndërkombëtare që azilkërkuesi nuk përballet me një rrezik në vendin e tij ose të saj të origjinës, kjo nuk mund të shërbejë për ta liruar Shtetin në mënyrë retrospektive nga detyrimi procedural i përshkruar më sipër. Nëse do të ishte ndryshe, azilkërkuesit të cilët përballeshin me një rrezik vdekjeprurës në vendin e tyre të origjinës mund të zhvendoseshin në mënyrë të ligjshme dhe pa formalitete në vende të treta “të pasigurta”. Një qasje e tillë në praktikë do të bënte të pakuptimtë ndalimin e keqtrajtimit në rastet e dëbimit të azilkërkuesve.

Në lidhje me azilkërkuesit pretendimet e të cilëve ishin të pabazuara ose, aq më tepër, të cilët nuk kishin asnjë pretendim të arsyeshëm në lidhje me ndonjë rrezik përkatës që kërkonte mbrojtje, Shtetet Kontraktuese ishin të lirë, në pajtim me detyrimet e tyre ndërkombëtare, të rrëzonin pretendimet e tyre në themel dhe t’i kthenin ato në vendin e tyre të origjinës ose një vend të tretë i cili i pranonte ata. Forma e një shqyrtimi të tillë në themel do të varej natyrshëm nga serioziteti i pretendimeve të bëra dhe provave të paraqitura.

Në rastin konkret, bazuar në Ligjin Hungarez të Azilit i cili parashikonte papranueshmërinë e kërkesave të azilit në një numër rrethanash dhe pasqyronte zgjedhjet e bëra nga Hungaria në transpozimin e së drejtës së BE-së, autoritetet hungareze nuk kishin shqyrtuar kërkesat e azilkërkuesve për azil në themel - d.m.th., nëse kërkuesit rrezikonin keqtrajtimin në vendin e tyre të origjinës, Bangladeshi. Në vend të kësaj, autoritetet hungareze i kishin shpallur kërkesat e azilit të papranueshme në bazë të faktit se kërkuesit kishin ardhur nga Serbia, e cila, sipas autoriteteve hungareze kishte qenë një vend i tretë i sigurtë dhe, për këtë arsye, mund të merrte përsipër shqyrtimin e pretendimeve për azil në themel.

Si pasojë, thelbi i ankesave të kërkuesve sipas Nenit 3 është se ata ishin larguar pavarësisht indicieve të qarta se ata në Serbi nuk do të kishin akses në një procedim të përshtatshëm azili të përshtatshme për t’i mbrojtur ata kundërrikthimit.

Meqenëse vendimi i kundërshtuar i autoriteteve hungareze për të larguar kërkuessit në Serbi nuk kishte të bënte me situatën në Bangladesh dhe themelin e kërkesave të azilkërkuessve, nuk ishte detyra e Gjykatës të shqyrtonte nëse kërkuessit kishin rrezikuar keqtrajtimin e tyre në Bangladesh. As nuk i takonte Gjykatës të vepronte si gjykatë e shkallës së parë dhe të merrej me aspektet e themelit të kërkesave të azilit në një situatë ku Shteti i paditur kishte zgjedhur - në mënyrë legjitime - të mos merrej me ato dhe në të njëjtën kohë dëbimi i kundërshtuar ishte bazuar në zbatimin e konceptit të “vendit të tretë të sigurt”. Pyetja nëse kishte një pretendim të arsyeshëm në lidhje me rreziqet e Nenit 3 në vendin e origjinës ishte e rëndësishme në rastet kur Shteti dëbues i kishte trajtuar ato rreziqe.

Prandaj, Gjykata duhej të shqyrtonte: (i) nëse këto autoritete kishin marrë në konsideratë informacionin e disponueshëm të përgjithshëm në lidhje me Serbinë dhe sistemin e saj të azilit në një mënyrë adekuate dhe me iniciativën e tyre; (ii) nëse kërkuessve u ishte dhënë një mundësi e mjaftueshme për të demonstruar se Serbia nuk kishte qenë një vend i tretë i sigurt në rastin e tyre të veçantë; dhe (iii) nëse autoritetet hungareze kishin dështuar të merrnin në konsideratë kushtet e pretenduara joadekuate të pritjes për azilkërkuessit në Serbi.

Autoritetet hungareze ishin mbështetur në një listë të “vendeve të treta të sigurta” të vendosur nga një dekret qeveritar i cili kishte vendosur një prezumim se vendet e listuara ishin të sigurta.

Konventa nuk i ndalon Shtetet Kontraktuese të krijojnë lista të vendeve që supozohen të sigurta për azilkërkuessit. Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian e bënë këtë, veçanërisht, në pajtim me [Direktivën e Procedurave të Azilit](#). Sidoqoftë, çdo prezumim që një vend i caktuar ishte “i sigurt”, nëse do të merrej parasysh në vendimet në lidhje me një azilkërkuess konkret, duhej të mbështetej mjaftueshëm fillimisht nga një analizë e kushteve përkatëse në atë vend dhe, në veçanti, të sistemit të tij të azilit. Sidoqoftë, në rastin konkret, procesi i vendim-marrjes në atë aspekt nuk kishte përfshirë një vlerësim të plotë të rrezikut që paraqitej nga mungesa e aksesit efektiv në procedimet e azilit në Serbi, përfshirë rrezikun erikthimit.

Për më tepër, në çështjen e kërkuessve, vendimet e dëbimit nuk kishin marrë parasysh rezultatet autoritare të UNHCR-së për një rrezik real të mohimit të aksesit në një procedim efektiv të azilit në Serbi dhe largimin pa formalitete nga Serbia në Maqedoninë e Veriut dhe më pas në Greqi, dhe duke iu nënshtruar kështu në Greqi kushteve të papajtueshme me Nenin 3.

Autoritetet hungareze i kishin përkeqësuar rreziqet me të cilat përballen kërkuesit duke i detyruar ata të hyjnë në Serbi në mënyrë të paligjshme në vend që të negocionin një kthim të rregullt në një përpjekje për të marrë garanci nga autoritetet serbe.

Së fundmi, në lidhje me argumentin e Qeverisë se të gjitha palët në Konventë, përfshirë Serbinë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, kishin të njëjtat detyrime dhe se Hungaria nuk do të mbante një barrë shtesë për të kompensuar sistemet e tyre të mangëta të azilit, ky nuk ishte një argument i mjaftueshëm për të justifikuar një dështim nga Hungaria - e cila kishte vendosur të mos shqyrtonte themelin e kërkesave të azilkërkuesve - për të përmbushur detyrimin e saj procedural, që buron nga natyra absolute e ndalimit të keqtrajtimit sipas Nenit 3.

Si përmbledhje, Shteti i paditur kishte dështuar të përmbushte detyrimin e tij procedural sipas Nenit 3 për të vlerësuar rreziqet e trajtimit në kundërshtim me atë dispozitë përpara se të largonte kërkuesit nga Hungaria.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

(b) Kushtet e ndalimit në zonën transit:

Dhoma e Madhe miratoi analizën e Dhomës në çështjen konkrete në lidhje me kushtet fizike në të cilat kërkuesit kishin jetuar, ndërsa ishin të ndaluar në zonën e transitit. Kërkuesit ishin ndaluar në një zonë të mbyllur prej rreth 110 metrash katrorë për 23 ditë. Ngjitur me atë zonë atyre u ishte siguruar një dhomë në një nga disa kontejnerë të dedikuar. Dhoma përmbante pesë shtretër, por në momentin përkatës, kërkuesit kishin qenë banorët e vetëm. Kushtet higjienike ishin të mira dhe personave që qëndronin në zonë u sigurohej ushqim i një cilësie të kënaqshme dhe kujdes mjekësor, nëse ishte e nevojshme, dhe mund të kalonin kohën e tyre jashtë. Ata kishin mundësi për kontakt njerëzor me azilkërkuesit e tjerë, përfaqësuesit e UNHCR-së, OJQ-të dhe një avokat. Kërkuesit nuk kishin qenë më të prekshëm se çdo azilkërkues tjetër i rritur i ndaluar në atë kohë. Edhe nëse kërkuesit natyrisht ishin prekur nga pasiguria nëse ishin në paraburgim dhe nëse zbatoheshin garancitë ligjore kundër ndalimit arbitrar, shkurtësia e periudhës përkatëse dhe fakti që kërkuesit ishin në dijeni të zhvillimeve procedurale në procedurën e azilit, të cilat u zhvilluan pa vonesa, treguan se efekti negativ i ndonjë pasigurie të tillë mbi to duhet të ketë qenë i kufizuar. Si përmbledhje, situata për të cilën u ankuan nuk arrinte nivelin minimal të ashpërsisë së nevojshme për të përbërë trajtim çnjerëzor brenda kuptimit të Nenit 3.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

**Ligji** - Neni 5, par 1 dhe 4: Zbatueshmëria

Në bërjen e dallimit midis një kufizimi të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë në kontekstin e ndalimit të azilkërkuesve, qasja e Gjykatës duhej të ishte praktike dhe reale, duke pasur parasysh kushtet dhe sfidat e sotme. Ishte e rëndësishme që veçanërisht të njëhej e drejta e Shteteve, duke iu nënshtruar detyrimeve të tyre ndërkombëtare, për të kontrolluar kufijtë e tyre dhe për të marrë masa ndaj të huajve që anashkalojnë kufizimet e emigrimit.

Në përcaktimin e dallimit midis një kufizimi të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë në kontekstin e mbylljes së të huajve në zonat e transitit në aeroport dhe qendrat e pritjes për identifikimin dhe regjistrimin e migrantëve, faktorët e marrë në konsideratë nga Gjykata mund të përmbliidhen si më poshtë : (i) situata individuale e kërkuesve dhe zgjedhjet e tyre; (ii) regjimi i zbatueshëm ligjor i vendit përkatës dhe qëllimi i tij; (iii) kohëzgjatja përkatëse, veçanërisht në dritën e qëllimit dhe mbrojtjes procedurale që gëzojnë kërkuesit në pritje të ngjarjeve; dhe (iv) natyra dhe shkalla e kufizimeve konkrete të vendosura ose të përjetuara nga kërkuesit.

Rasti konkret kishte të bënte, me sa duket për herë të parë, me një zonë tranziti të vendosur në kufirin tokësor midis dy Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, ku azilkërkuesit duhej të qëndronin në pritje të shqyrtimit të pranueshmërisë së kërkesave të tyre për azil.

Kërkuesit nuk kishin kaluar kufirin nga Serbia për shkak të një rreziku të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e tyre në atë vend, por e bënë këtë me vullnetin e tyre të lirë. Ata kishin hyrë në zonën e transitit me iniciativën e tyre.

E drejta e Shteteve për të kontrolluar hyrjen e të huajve në territorin e tyre nënkupton domosdoshmërisht se autorizimi i pranimi mund të kushtëzohet nga pajtueshmëria me kërkesat përkatëse. Prandaj, në mungesë të faktorëve të tjerë domethënës, situata e një individi që aplikon për hyrje dhe pret një periudhë të shkurtër për verifikimin e të drejtës së tij ose të saj nuk mund të përshkruhet si heqje e lirisë që i ngarkohet Shtetit, meqenëse në këto raste autoritetet shtetërore nuk kishin ndërmarrë ndaj individit asnjë hap tjetër përveç reagimit ndaj dëshirës së tij ose të saj për të hyrë duke kryer verifikimet e nevojshme

Për sa kohë qëndrimi i kërkuesit në zonën e transitit nuk e kalonte në mënyrë të konsiderueshme kohën e nevojshme për shqyrtimin e një kërkeze azili dhe nuk kishte rrethana të jashtëzakonshme, kohëzgjatja në vetvete nuk mund të ndikonte në analizën e Gjykatës për zbatueshmërinë e Nenit 5 në një mënyrë vendimtare. Kjo veçanërisht kur individët, ndërsa prisnin për shqyrtimin e kërkesave të tyre për azil, kishin përfituar nga të drejtat procedurale dhe garancitë ndaj periudhave të tepërta

të pritjes. Fakti që rregullimet e brendshme ekzistonin duke e kufizuar kohëzgjatjen e qëndrimit në zonën e transitit ishte i një rëndësie të konsiderueshme në këtë drejtim.

Madhësia e zonës dhe mënyra në të cilën ajo kontrollohej ishin të tilla që liria e lëvizjes së kërkuësve ishte kufizuar në një shkallë shumë të konsiderueshme, në një mënyrë të ngjashme me atë që është karakteristikë e mjedisëve të paraburgimit të regjimit të lehtë.

Nga ana tjetër, ndërsa prisnin hapat procedurale të shkaktuara nga kërkesa e tyre për azil, kërkuësit kishin jetuar në kushte të cilat, megjithëse përfshinin një kufizim të konsiderueshëm të lirisë së tyre të lëvizjes, nuk e kishin kufizuar lirinë e tyre në mënyrë të panevojshme ose në një farë mase ose në një mënyrë të palidhur me shqyrtimin e kërkesave të tyre për azil. Përfundimisht, megjithë vështirësitë shumë të mëdha të krijuara nga një fluks masiv i azilkërkuësve dhe migrantëve në kufi, kërkuësit kaluan vetëm njëzet e tre ditë në zonë, një periudhë e cila nuk kalonte atë që ishte rreptësisht e nevojshme për të verifikuar nëse dëshira e kërkuësve për të hyrë në Hungari për të kërkuar azil atje mund të plotësohet. Situata e kërkuësve nuk u ndikua nga ndonjë mosveprim i autoriteteve hungareze.

Është më tej domethënëse që, në kontrast, për shembull, me personat e ndaluar në një zonë transiti në aeroport, ata që vendosen në një zonë tranziti kufitar tokësor - ashtu si me kërkuësit në rastin konkret - nuk kishin nevojë të hipnin në aeroplan për t'u kthyer në vendin nga kishin ardhur. Kërkuësit kishin ardhur nga Serbia, një vend që ka njohur [Konventën e Gjenevës në lidhje me Statusin e Refugjatëve](#) dhe territori i së cilës ishte vazhdim i drejtpërdrejtë i zonës së transitit. Në terma praktikë, për këtë arsye, mundësia që ata të largoheshin nga zona transit e kufirit tokësor ishte jo vetëm teorike, por edhe reale.

Ndërsa - si në rastin konkret - shumica e të gjithë faktorëve të tjerë të rëndësishëm nuk tregon për një situatë de facto privimi të lirisë dhe ishte e mundur që azilkërkuësit, pa një kërcënim të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tyre, të njohur nga ose të sjellë në vëmendjen e autoriteteve në kohën përkatëse, të ktheheshin në vendin e tretë ndërmjetësues nga kishin ardhur, Neni 5 nuk mund të shihej i zbatueshëm për situatën e tyre në një zonë transiti kufitar tokësor ku ata prisnin shqyrtimin e kërkesave të tyre për azil, me arsyetimin se autoritetet nuk kishin respektuar detyrimet e tyre të veçanta sipas Nenit 3. Konventa nuk mund të lexohet se lidh në një mënyrë të tillë zbatueshmërinë e Nenit 5 me një çështje të veçantë në lidhje me pajtueshmërinë e autoriteteve me Nenin 3.

Në rrethanat e çështjes faktike dhe në kontrast me situatën që mbizotëronte në disa prej çështjeve në lidhje me zonat e transitit në aeroport, dhe veçanërisht në

çështjen Amuur kundër Francës, rreziku i kërkuesve për humbjen e shqyrtimit të e kërkesave të tyre të azilit në Hungari dhe frika e tyre për akses të pamjaftueshëm në procedurat e azilit në Serbi, ndërsa ishte i rëndësishëm në lidhje me Nenin 3, nuk e bënte mundësinë e kërkuesve për të lënë zonën e transitit në drejtim të Serbisë thjesht teorike. Gjykata nuk mund të pranonte që vetëm kjo frikë, përkundër të gjitha rrethanave të tjera në rastin faktik (të cilat ishin të ndryshme nga ato të marra në çështjet në lidhje me zonat e transitit në aeroport), ishte e mjaftueshme për të zbatuar Nenin 5. Një interpretim i tillë i zbatueshmërisë së Nenit 5 do ta shrinte konceptin e heqjes së lirisë përtej kuptimit të tij të synuar nga Konventa.

Prandaj, rreziqet në fjalë nuk kishin ndikuar në bërjen të pavullnetshme të qëndrimit të kërkuesëve në zonën e transitit nga pikëpamja e Nenit 5 dhe, rrjedhimisht, nuk mund të shkaktonin, në vetvete, zbatueshmërinë e asaj dispozite.

**Përfundim:** i papranueshëm (shkaku lëndor i papajtueshëm).

Neni 41: 5 000 Euro secilit prej dy kërkuesve në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih Buletinin faktik për [Çështjet e “Dublinit”](#); T.I. kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), [43844/98](#), 7 mars 2000, [Shënim Informativ 16](#); M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë [DHM], [30696/09](#), 21 janar 2011, [Shënim Informativ 137](#); Mohammed Hussein dhe të Tjerë kundër Holandës dhe Italisë (dec.), [27725/10](#), 2 prill 2013, [Shënim Informativ 162](#); Tarakhel kundër Zvicrës [DHM], [29217/12](#), 4 nëntor 2014, [Shënim Informativ 179](#); dhe Paposhvili kundër Belgjikës [DHM], [41738/10](#), 13 dhjetor 2016, [Shënim Informativ 202](#). Shih Buletinin faktik për [Kushtet e ndalimit dhe trajtimin e të burgosurve](#); Amuur kundër Francës, [19776/92](#), 25 qershor 1996; Shamsa kundër Polonisë, [45355/99](#) dhe [45357/99](#), 27 nëntor 2003, [Shënim Informativ 58](#); Mogoş kundër Rumanisë (dec.), [20420/02](#), 6 maj 2004, [Shënim Informativ 79](#); Mahdid dhe Haddar kundër Austrisë (dec.), [74762/01](#), 8 dhjetor 2005, [Shënim Informativ 81](#); Riad dhe Idiab kundër Belgjikës, [29787/03](#) dhe [29810/03](#), 24 janar 2008, [Shënim Informativ 104](#); Nolan dhe K. kundër Rusisë, [2512/04](#), 12 shkurt 2009, [Shënim Informativ 116](#))

## Neni 5

### Neni 5-1, Heqja e lirisë

Azilkërkuesit e mbajtur për periudha të gjata në zonën e transitit në aeroport: [shkelje](#)

### Neni 3

#### Trajtimi poshtërues

Kushtet në të cilat u mbajtën azilkërkuesit në zonën e transitit në aeroport: *shkelje*

***Z.A. dhe të Tjerë kundër Rusisë [DHM]*** - 61411/15, 61420/15, 61427/15 et al., Vendimi 21.11.2019 [DHM]

***Faktet*** – Të katër kërkuesit, të cilët ishin azilkërkues, u mbajtën në zonën ndërkombëtare të transitit të Aeroportit Sheremetyevo në Rusi për periudha nga pesë muaj deri në një vit dhe dhjetë muaj pasi atyre iu refuzua hyrja në Rusi. Atyre u duhej të flinin në një dyshek në dysHEME në hapësirën e embarkimit të aeroportit, e cila ishte ndriçuar vazhdimisht, e mbushur me njerëz dhe e zhurmshme, dhe ushqeheshin nga racionet e urgjencës të siguruar nga zyra ruse e UNHCR-së. Nuk kishte dushe. Në procedimet në pajtim me Konventën, ata u ankuan se u ishte privuar në mënyrë të paligjshme nga liria e tyre (Neni 5 § 1 i Konventës) dhe për kushtet në të cilat ishin mbajtur (Neni 3).

Me vendimin e datës 28 mars 2017 (shih [Shënimin Informativ 205](#)), një Dhomë e Gjykatës u shpreh, gjashtë vota me një, që ka patur shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës. Kufizimi i azilkërkuesve Kërkues për periudha të gjata në zonën e transitit në aeroport pa mundësi hyrjeje në territorin rus ose një Shtet tjetër nga ai që ata kishin lënë u barazua de facto me heqjen e lirisë për të cilën nuk kishte asnjë bazë ligjore në të drejtën ruse. Dhoma konstatoi gjithashtu, gjashtë vota me një, një shkelje të Nenit 3 për shkak të kushteve që kërkuesit u detyruan të duronin në zonën e transitit për periudha të zgjatura.

Më 18 shtator 2017, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

#### ***Ligji***

Konsiderata paraprake – E drejta për t’u kufizuar liria vetëm në përputhje me ligjin dhe e drejta për kushte njerëzore, nëse ndalimi mbetet nën kontrollin e Shtetit, ishin garancitë minimale që duhej të ishin në dispozicion të atyre nën juridiksionin e të gjitha Shteteve Anëtare, pavarësisht “kriza së migrimit” në rritje në Europë.

Neni 5, par 1

(a) Zbatueshmëria

Në bërjen e dallimit midis një kufizimi të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë në kontekstin e ndalimit të azilkërkuesve, qasja e Gjykatës duhej të ishte praktike dhe reale, duke pasur parasysh kushtet dhe sfidat e sotme. Ishte e rëndësishme që

veçanërisht të njëjët e drejta e Shteteve, duke iu nënshtruar detyrimeve të tyre ndërkombëtare, për të kontrolluar kufijtë e tyre dhe për të marrë masa ndaj të huajve që anashkalojnë kufizimet e emigrimit.

Në përcaktimin e dallimit midis një kufizimi të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë në kontekstin e mbylljes së të huajve në zonat e transitit në aeroport dhe qendrat e pritjes për identifikimin dhe regjistrimin e migrantëve, faktorët e marrë në konsideratë nga Gjykata mund të përmbliidhen si më poshtë : (i) situata individuale e kërkuesve dhe zgjedhjet e tyre; (ii) regjimi i zbatueshëm ligjor i vendit përkatës dhe qëllimi i tij; (iii) kohëzgjatja përkatëse, veçanërisht në dritën e qëllimit dhe mbrojtjes procedurale që gëzojnë kërkuesit në pritje të ngjarjeve; dhe (iv) natyra dhe shkalla e kufizimeve konkrete të vendosura ose të përjetuara nga kërkuesit.

Në rastin konkret, duke pasur parasysh faktet e njohura në lidhje me kërkuesit dhe udhëtimet e tyre përkatëse dhe, veçanërisht, faktin që ata nuk kishin mbërritur në Rusi për shkak të një rreziku të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e tyre, por më shumë për shkak të rrethanave specifike të itinerarit të tyre të udhëtimit, nuk kishte dyshim se ata kishin hyrë në aeroport në mënyrë të pavullnetshme, por pa përfshirë autoritetet ruse. Prandaj ishte e qartë se, në çdo rast, autoritetet ruse kishin të drejtë të kryenin verifikimet e nevojshme dhe të shqyrtonin pretendimet e tyre para se të vendosnin nëse do t'i pranonin ato.

Autoritetet ruse nuk kishin kërkuar tu privonin lirinë kërkuesve dhe ata u kishin refuzuar menjëherë hyrjen. Kërkuesit kishin qëndruar në zonën e transitit thjesht sepse kishin pritur rezultatin e procedurave të tyre të azilit.

E drejta e Shteteve për të kontrolluar hyrjen e të huajve në territorin e tyre nënkupton domosdoshmërisht se autorizimi i pranimi mund të kushtëzohet nga pajtueshmëria me kërkesat përkatëse. Prandaj, në mungesë të faktorëve të tjerë domethënës, situata e një individi që aplikon për hyrje dhe pret një periudhë të shkurtër për verifikimin e të drejtës së tij ose të saj nuk mund të përshkruhet si heqje e lirisë që i ngarkohet Shtetit, meqenëse në këto raste autoritetet shtetërore nuk kishin ndërmarrë ndaj individit asnjë hap tjetër përveç reagimit ndaj dëshirës së tij ose të saj për të hyrë duke kryer verifikimet e nevojshme

Më tej ishte e rëndësishme nëse, në përputhje me qëllimin e regjimit të zbatueshëm ligjor, kishin ekzistuar garancitë procedurale në lidhje me përpunimin e kërkesave të azilit të kërkuesve dhe dispozitat e brendshme që përcaktonin kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të tyre në zonën e transitit dhe nëse ato ishin aplikuar në rastin konkret.



Për faktet, Qeveria e paditur nuk ishte në gjendje t'i referohej ndonjë dispozite të brendshme që përcaktonte kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të kërkuesve në zonën e transitit. Për më tepër, në shpërfillje të rregullave të brendshme ruse që i japin çdo azilkërkuesi të drejtën për t'u pajisur me një certifikatë shqyrtimi dhe për t'u vendosur në ambiente të strehimit të përkohshëm në pritje të shqyrtimit të kërkesës për azil, kërkuesit faktikisht ishin lënë në mundësitë e tyre në zonën e transitit. Autoritetet ruse nuk e kishin marrë përsipër që ata kishin një lloj përgjegjësie për kërkuesit, duke i lënë këta të fundit në një boshllëk ligjor pa ndonjë mundësi të kundërshtimit të masave që kufizonin lirinë e tyre. Ndërsa ishin në zonën e transitit, të katër kërkuesit kishin pak informacion në lidhje me rezultatin e kërkesave të tyre përkatëse për statusin e refugjatit dhe azilin e përkohshëm.

Për sa kohë qëndrimi i kërkuesit në zonën e transitit nuk e kalonte në mënyrë të konsiderueshme kohën e nevojshme për shqyrtimin e një kërkesë azili dhe nuk kishte rrethana të jashtëzakonshme, kohëzgjatja në vetvete nuk dukej se mund të ndikonte në analizën e Gjykatës për zbatueshmërinë e Nenit 5 në një mënyrë vendimtare. Kjo veçanërisht kur individët, ndërsa prisnin për shqyrtimin e kërkesave të tyre për azil, kishin përfitur nga të drejtat procedurale dhe garancitë ndaj periudhave të tepërta të pritjes. Fakti që rregullimet e brendshme ekzistonin duke e kufizuar kohëzgjatjen e qëndrimit në zonën e transitit ishte i një rëndësie të konsiderueshme në këtë drejtim.

Situata e kërkuesve ishte ndikuar shumë seriozisht nga vonesat dhe mosveprimi nga ana e autoriteteve ruse, të cilat u ishin veshur qartë atyre dhe nuk ishin të justifikuara nga ndonjë arsye legjitime.

Dosja e çështjes nuk përmbante asnjë tregues se kërkuesit nuk kishin respektuar rregulloret ligjore në fuqi ose nuk kishin vepruar me mirëbesim në çdo kohë gjatë izolimit të tyre në zonën e transitit ose në ndonjë fazë të procedurave të brendshme ligjore, për shembull, duke ndërlikuar shqyrtimin e çështjeve të tyre të azilit.

Edhe pse kërkuesit ishin lënë kryesisht në fatin e tyre brenda perimetrit të zonës së transitit, madhësia e zonës dhe mënyra në të cilën ajo kontrollohej ishin të tilla që liria e lëvizjes së kërkuesve ishte e kufizuar në një shkallë shumë të konsiderueshme, në një mënyrë të ngjashme me atë që është karakteristike e mjedisve të paraburgimit të regjimit të lehtë.

Largimi nga zona e transitit të aeroportit në një drejtim tjetër nga territori i Rusisë do të kërkonte planifikim, kontaktimin e linjave ajrore, blerjen e biletave dhe ndoshta aplikimin për një vizë në varësi të destinacionit. Qeveria nuk kishte arritur të

mbështeste pohimin e saj se përkundër këtyre pengesave “kërkuesit kishin qenë të lirë të largoheshin nga Rusia në çdo kohë dhe të shkonin ku të dëshironin”. Mundësia praktike dhe reale që kërkuesit të largoheshin nga zona e tranzitit në aeroport dhe ta bëjnë këtë pa ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tyre, siç dihet oseillet në vëmendjen e autoriteteve në kohën përkatëse, duhej të tregohej bindshëm se ekzistonte .

Duke pasur parasysh faktorë të ndryshëm - në veçanti mungesën e ndonjë dispozite ligjore të brendshme që përcaktonte kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të kërkuesve, karakterin kryesisht të parregullt të qëndrimit të kërkuesve në zonën e transitit në aeroport, kohëzgjatjen e tepërt të këtij qëndrimi dhe vonesat e konsiderueshme në shqyrtimin e brendshëm të kërkesave të azilit të kërkuesve, karakteristikat e zonës në të cilën ishin mbajtur kërkuesit dhe kontrolli të cilit ata i ishin nënshtruar gjatë periudhës përkatëse kohore dhe fakti që kërkuesit nuk kishin asnjë mundësi praktike për të lënë zonën - u nxor përfundimi që kërkuesit ishin privuar nga liria e tyre në kuptimin e Neni 5 të Konventës.

Kështu që ishte i zbatueshëm Neni 5, par 1.

#### (b) Themeli

Gjykata ishte plotësisht e vetëdijshme për vështirësitë që Shtetet Anëtare mund të përballen gjatë periudhave kur azilkërkuesit mbërrijnë në një numër të madh në kufijtë e tyre. Duke iu nënshtruar ndalimit të arbitraritetit, kërkesa për ligjshmëri e kësaj dispozite mund të konsiderohet e përmbushur në përgjithësi nga një regjim i brendshëm ligjor që parashikon, për shembull, jo më shumë se emrin e autoritetit kompetent për të urdhëruar heqjen e lirisë në një zonë tranziti, formën e urdhrit, arsyet dhe kufijtë e tij të mundshëm, kohëzgjatjen maksimale të ndalimit dhe, siç kërkohet nga Neni 5 § 4, rrugën e ndjekur për ankimin gjyqësor.

Për më tepër, Neni 5 § 1 (f) nuk i ndalonte Shtetet të miratonin dispozita në ligjin e tyre të brendshëm që të formulonin bazat mbi të cilat një ndalim i tillë mund të urdhërohej duke marrë parasysh realitetet praktike të një fluksi masiv të azilkërkuesve. Në veçanti, paragrafi 1 (f) nuk e ndalon privimin e lirisë në një zonë tranziti për një periudhë të kufizuar me arsyetimin se një izolim i tillë ishte përgjithësisht i nevojshëm për të siguruar praninë e azilkërkuesve në pritje të shqyrtimit të kërkesave të tyre të azilit ose, për më tepër, për arsye se kishte nevojë për të shqyrtuar me procedurë të përsheptuar pranueshmërinë e kërkesave për azil dhe se, për këtë qëllim, në zonën e transitit ishin vendosur një strukturë dhe procedurat e përshtatura.

Në të drejtën ruse nuk kishte pasur ndonjë bazë ligjore të përcaktuar në mënyrë të shprehur, e aftë të shërbente si bazë për të justifikuar heqjen e lirisë së kërkuesve.

Kjo në vetvete do të kishte qenë e mjaftueshme për të gjetur një shkelje të Nenit 5 1. Sidoqoftë, kishte faktorë shtesë që përkeqësonin situatat përkatëse të kërkuesve.

Aksesi i kërkuesve në procedurën e azilit ishte penguar në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndalimit të tyre, pasi në zonën e transitit nuk kishte pasur informacion në dispozicion për procedurat e azilit në Rusi dhe akses i tyre tek ndihma ligjore ishte rreptësisht e kufizuar.

Kërkuesit kishin përjetuar vonesa serioze kur u përpoqën të paraqisnin dhe regjistronin kërkesat e tyre për azil dhe, përkundër kërkesave të tyre me shkrim, nuk ishin lëshuar dhe dhënë çertifikata shqyrtimi siç kërkohet nga e drejta e brendshme.

Kishte vonesa në komunikimin kërkuesve të disa nga vendimet e marra nga organet administrative dhe gjyqësore ruse.

Për më tepër, kërkuesit ishin mbyllur në një vend që kishte qenë qartazi i papërshtatshëm për çdo qëndrim afatgjatë.

Së fundmi, kohëzgjatja e qëndrimit të secilit kërkues në zonën e transitit në aeroport kishte qenë e konsiderueshme dhe qartazi e tepruar në funksion të natyrës dhe qëllimit të procedurës në fjalë, duke filluar nga pesë muaj në mbi një vit dhe nëntë muaj.

Ndalimi i kërkuesve për qëllimet e pjesës së parë të paragrafit 1 (f) të Nenit 5 nuk i kishte përmbushur standardet e Konventës.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 3: Në bazë të materialit në dispozicion, Gjykata mund të shihte qartë se kushtet e qëndrimit të kërkuesve në zonën e transitit në aeroport kishin qenë të papërshtatshme për një qëndrim të detyruar afatgjatë. Sipas pikëpamjes së saj, një situatë kur një personi jo vetëm që duhej të flinte për muaj të tërë pa ndërprerje në dysHEME në një zonë tranziti të aeroportit të ndriçuar vazhdimisht, të mbushur me njerëz dhe të zhurmshëm pa mundësi të lirshme për dush ose ambiente gatimi dhe pa dalje në natyrë, por gjithashtu nuk kishte asnjë akses në ndihmë mjekësore ose sociale, nuk i përmbush standardet minimale të respektimit të dinjitetit njerëzor.

Kjo situatë ishte përkeqësuar nga fakti që kërkuesit ishin lënë në fatin e tyre në zonën e transitit, duke shpërfillur rregullat e brendshme ruse që i jepnin çdo azilkërkuesi

të drejtën e lëshimit të një certificate shqyrtimi dhe të vendoseshin përkohësisht mjedise akomodimi në pritje të shqyrtimit të kërkesës për azil.

Tre nga kërkuessit u njohën eventualisht nga UNHCR-ja si në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, e cila kishte sugjeruar që ankthi i tyre ishte përkeqësuar për shkak të ngjarjeve që kishin kaluar gjatë migrimit të tyre.

Së fundmi, ndalimi kishte qenë me një kohëzgjatje jashtëzakonisht të gjatë për secilin prej kërkuessve. Ndalimi i kërkuessve kishte zgjatur për shumë muaj rresht (midis gati pesë dhe njëzet e dy muajve).

Të marra së bashku, kushtet e tmerrshme materiale që kërkuessit duhet të duronin për periudha kaq të gjata kohore dhe dështimi i plotë i autoriteteve për t'u kujdesur për kërkuessit përbënin një trajtim poshtërues në kundërshtim me Nenin 3.

Kërkuessit kishin qenë nën kontrollin e Shtetit të paditur dhe nën kujdestarinë e tij gjatë gjithë periudhës përkatëse kohore.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: shumat nga 15,000 Euro deri në 26,000 Euro secila në lidhje me dëmin jo-material.

(Shih Buletinin faktik për [Kushtet e ndalimit dhe trajtimin e të burgosurve](#); shih gjithashtu Amuur kundër Francës, [19776/92](#), 25 qershor 1996; Shamsa kundër Polonisë, [45355/99](#) dhe [45357/99](#), 27 nëntor 2003, [Shënim Informativ 58](#); Mogoş kundër Romanisë (dec.), [20420/02](#), 6 maj 2004, [Shënim Informativ 79](#); Mahdid dhe Haddar kundër Austrisë (dec.), [74762/01](#), 8 dhjetor 2005, [Shënim Informativ 81](#); Riad dhe Idiab kundër Belgjikës, [29787/03](#) dhe [29810/03](#), 24 janar 2008, [Shënim Informativ 104](#); Nolan dhe K. kundër Rusisë, [2512/04](#), 12 shkurt 2009, [Shënim Informativ 116](#); M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë [DHM], [30696/09](#), 21 janar 2011, [Shënim Informativ 137](#); Kanagaratnam kundër Belgjikës, [15297/09](#), 13 dhjetor 2011, [Shënim Informativ 147](#); Ananyev dhe të Tjerë kundër Rusisë, [42525/07](#) dhe [60800/08](#), 10 janar 2012, [Shënim Informativ 148](#); Suso Musa kundër Maltës, [42337/12](#), 23 korrik 2013, [Shënim Informativ 165](#); Gahramanov kundër Azerbajxhanit (dec.), [26291/06](#), 15 tetor 2013, [Shënim Informativ 168](#); Muršić kundër Kroacisë [DHM], [7334/13](#), 20 dhjetor 2016, [Shënim Informativ 200](#); dhe Khlaifia dhe të Tjerë kundër Italisë [DHM], [16483/12](#), 15 dhjetor 2016, [Shënim Informativ 202](#))

## Neni 35

### Neni 35-1, Shterimi i mjeteve të brendshme

OJQ-të që ndjekin ankesat penale në interes të kërkuësve të piketuar nga komentet homofobike në Facebook: *e pranueshme*.

## Neni 13

### Mjet i efektshëm

Qëndrimet diskriminuese që ndikojnë në efektivitetin e mjeteve juridike në zbatimin e së drejtës së brendshme: *shkelje*

## Neni 14

### Diskriminimi

Refuzimi për të ndjekur penalisht autorët e komenteve serioze homofobike në Facebook duke përfshirë thirrje haptazi për dhunë, pa hetim efektiv paraprakisht: *shkelje*

***Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*** - 41288/15, Vendimi 14.1.2020 [Sektionii II]

***Faktet*** – Kërkuësit janë dy të rinj. Në vitin 2014, njëri prej tyre postoi një fotografi të çiftit duke u puthur në faqen e tij në Facebook (në profilin “publik”, pa kufizuar aksesin në një grup të veçantë të “miqve”); kjo kishte për qëllim të shoqëronte njoftimin e marrëdhënies së tyre dhe të nxiste një debat mbi të drejtat e personave LGBT në shoqërinë lituaneze. Ky postim në internet u bë viral dhe mori qindra komente homofobike virulente (që përmbajnë, për shembull, thirrje për të “kastruar”, “vlarë” dhe “djegur” kërkuësit).

Me kërkesë të kërkuësve, një organizatë që mbronte të drejtat e personave LGBT (anëtarë të së cilës ata ishin) depozitoi një ankesë në zyrën e prokurorit kundër tridhjetë e një prej këtyre komenteve, duke kërkuar që shërbimi i prokurorisë të hapte një hetim për nxitje të urrejtjes dhe dhunës homofobike (Neni 170 i Kodit Penal, që penalizon nxitjen e diskriminimit në bazë ndër të tjera – të orientimit seksual).

Ndërsa zyra e prokurorit refuzoi hapjen e një hetimi paraprak, gjykatat rrëzuan (në vitin 2015) ankesat e shoqatës kundër këtij refuzimi, bazuar në këto arsye:

- së pari, që postimi i kësaj fotografie “të çuditshme” publikisht kishte rezultuar në provokim nga ana e kërkuësve, në kundërshtim me respektimin e mendimeve të të tjerëve, në funksion të “vlerave tradicionale familjare” që mbizotëronin në Lituani;
- dhe, së dyti, se komentet e diskutuara shprehnin mendimin e pafavorshëm të autorëve të tyre në terma që ishin pa dyshim imorale, të pahijshme ose të zgjedhura keq, por që megjithatë ato nuk përmbajnë, vetëm mbi këtë bazë, elementët actus reus dhe mens rea të veprës në fjalë (pasi këto dukej se buronin nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë) në lidhje me secilin prej autorëve të tyre, të marrë individualisht.

### **Ligji – Neni 14**

(a) Pranueshmëria (shterimi i mjeteve juridike të brendshme) – Kërkuësit shpjeguan se ata kishin preferuar të kërkonin nga shoqata që të vepronte në emër të tyre nga frika e hakmarrjes nga autorët e komenteve në internet. Ankesa e shoqatës dhe ankesat pasuese për të mbrojtur interesat e kërkuësve kishin të bënin me incidente specifike që kishin shkelur të drejtat e dy anëtarëve të saj: pavarësisht nga aspekti i tyre i mundshëm “strategjik” për një kauzë më të gjerë, veprimet e shoqatës nuk ishin njëactio popularis. Për më tepër, pozita ligjore e shoqatës nuk ishte shqyrtuar ose kontestuar kurrë në nivelin e brendshëm. Në çdo rast, e drejta lituaneze kërkonte që zyra e prokurorit të kryente një hetim pas çdo njoftimi, edhe atje ku ai ishte paraqitur në mënyrë anonime. Së fundmi, ishin kërkuësit, që vepronin në emër të tyre, ata që kishin depozituar kërkesën në Gjykatën e Strasburgut, pasi gjykatat e brendshme kishin dhënë vendime në çështjen që preknin interesat e tyre.

Duke pasur parasysh seriozitetin e pretendimeve në fjalë, Gjykata konsideroi se duhej të ishte e mundur për shoqatën për të vepruar si përfaqësuese e interesave të kërkuësve brenda procedimeve të brendshme penale. Konstatimi ndryshe do të nënkuptonte parandalimin e shqyrtimit të akuzave serioze për shkelje të Konventës në nivelin kombëtar, duke pasur parasysh që në shoqëritë e ditëve moderne ndihma e dhënë nga organet kolektive ishte një nga mjetet e arritshme, ndonjëherë i vetmi mjet, në dispozicion të qytetarëve përmes të cilit ata mund të mbrojnë interesat e tyre të veçantë në mënyrë efektive (shih Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë [DHM], [47848/08](#), 17 korrik 2014, [Shënim Informativ 176](#), dhe Gorraiz Lizarraga dhe të Tjerë kundër Spanjës, [62543/00](#), 27 prill 2004, [Shënim Informativ 63](#)).

Sa i përket disponueshmërisë së mjeteve juridike përveç procedimeve penale, kjo pyetje ishte e lidhur thelbësisht me themelin (shih më poshtë).

(b) Themeli – Për arsyet e paraqitura më poshtë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit vërtet kishin vuajtur diskriminim për shkak të orientimit të tyre seksual, pa ndonjë arsye të përshtatshme, duke pasur parasysh se:

- komentet e urrejtjes nga individë privatë drejtuar kërkuesve dhe komunitetit homoseksual në përgjithësi u nxitën nga një qëndrim fanatik ndaj këtij komuniteti;
- dhe i njëjti mentalitet diskriminues ishte më pas në thelb të dështimit të autoriteteve për të përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të hetuar në një mënyrë efektive.

(i) Zbatueshmëria – Ishte e qartë se komentet në faqen e kërkuesit të parë në Facebook kishin ndikuar në mirëqenien dhe dinjitetin psikologjik të kërkuesve. Prandaj, Neni 14 ishte i zbatueshëm nën aspektin e “jetës private” të Nenit 8, duke pasur parasysh edhe nivelin e seriozitetit të këtyre sulmeve.

(ii) Natyra e pretenduar provokuese e postimit – Ndërsa pranoi që atmosfera në lidhje me këtë çështje ishte e tensionuar në Lituani, Gjykata gjeti se qëllimi i kërkuesve për të nxitur diskutime rreth homoseksualitetit nuk mund të shihej si një kërcënim për të shkakuar trazira publike. Përkundrazi, përmes një debati të drejtë dhe publik midis personave me pikëpamje të ndryshme kohezioni shoqëror mund të promovohet.

Autoritetet kishin theksuar natyrën “ekscentrike” të sjelljes së kërkuesve- dhe gjykata e apelit kishte shtuar se do të ishte e preferueshme që kërkuesit të ndanin fotografinë e tyre vetëm me “njerëz me mentalitet të njëjtë”, një mundësi e ofruar nga rrjeti Facebook. Në dritën e këtyre referencave specifike për orientimin seksual të kërkuesve, ishte e qartë se një nga arsyet e refuzimit të hapjes së një hetimi paraprak qëndronte në mosmiratimin e faktit që ata ishin të hapur për këtë orientim seksual.

Në lidhje me referencat shtesë të gjykatave për faktin se shumica e shoqërisë lituaneze vlerësonte vlerat e lidhura me familjen në kuptimin e saj tradicional dhe ruajtjen e atyre vlerave si themeli i shoqërisë, nuk kishte asnjë arsye të konsiderohej se këta faktorë ishin të papajtueshëm me pranimin shoqëror të homoseksualitetit, siç dëshmohet nga tendenca e përgjithshme në rritje për të parë marrëdhëniet midis çiftëve të të njëjtit seks si brenda konceptit të jetës familjare (Gjykata Kushtetuese Lituanëze kishte vendosur vetë për këtë efekt që nga viti 2011).

Dukej sikur ishte një rast që prima facie dukej sikur orientimi homoseksual i kërkuesve kishte luajtur një rol në mënyrën e trajtimit të tyre nga autoritetet. Si pasojë, i takonte Qeverisë të demonstronte se mënyra në të cilën autoritetet kishin vlerësuar faktet përkatëse, siç iu raportuan asaj, ishte e pranueshme.

(iii) Vlerësimi i natyrës kriminale të komenteve të diskutuara– Pa shkuar aq larg sa të themi se çdo shprehje e gjuhës së urrejtjes duhet, si e tillë, ti nënshtrohet ndjekjes penale dhe sanksioneve, Gjykata në çështjen konkrete nuk mund të pajtohet me arsyet e dhëna nga autoritetet vendase:

- në lidhje me përmbajtjen e brendshme të komenteve të diskutuara: koncepti i nxitjes së urrejtjes, në veçanti, nuk përfshinte domosdoshmërisht një thirrje për një akt dhune ose akte të tjera kriminale: fyerja, që shkonte deri në tallje ose shpifje mund të jetë e mjaftueshme për të anuar ekuilibrin kundër mbrojtjes së lirisë së shprehjes që u ushtrua në një mënyrë të papërgjegjshme. Përveç kësaj, Qeveria kishte dështuar t'i përgjigjej bindshëm argumentit që nëse komentet e diskutuara do të konsideroheshin se nuk ishin të mbuluara nga ligji penal në fjalë, atëherë ishte e vështirë të konceptohej se çfarë deklarata mund të ishin;

- në lidhje me rëndësinë e mungesës së një aspekti “sistematik” ndaj sulmeve: natyra e urrejtjes e një komenti - përfshirë thirrjet për të “vlarë” kërkuesit - ishte, sipas mendimit të Gjykatës, e mjaftueshme për t'u marrë seriozisht, madje nëse autori i saj do të kishte postuar vetëm një vërejtje të tillë.

Pa dyshim, rruga e sanksioneve penale, përfshirë kundër individëve përgjegjës për shprehjet më serioze të urrejtjes, duke nxitur të tjerët në dhunë, mund të thirret vetëm si një masë ultima ratio; kjo vlente po ashtu për gjuhën e urrejtjes kundër orientimit seksual dhe jetës seksuale të të tjerëve. Thënë kjo, çështja në fjalë kishte të bënte me thirrje të fshehura për një sulm ndaj integritetit fizik dhe mendor të kërkuesve. Si pasojë, kërkohej mbrojtja nga ligji penal.

Ndërsa Kodi Penal Lituanëz në teori e parashikonte një mbrojtje të tillë, në praktikë, megjithatë, ai ua ishte mohuar këtë kërkuesve si rezultat i qëndrimit diskriminues të autoriteteve, një qëndrim i cili ishte thjesht dështimi nga ana e atyre autoriteteve të përmbushin detyrimin e tyre pozitiv për të hetuar në një mënyrë efektive nëse komentet e kundërshtuara përbënin nxitje të urrejtjes dhe dhunës.

Në lidhje me faktin nëse mjete të tjera juridike ishin në dispozicion të kërkuesve (para gjykatave civile ose autoriteteve administrative), do të kishte qenë qartazi e paarsyeshme në këtë rast të kërkohej nga kërkuesit t'i shteronin ato dhe do të kishte ndikuar në minimizimin e seriozitetit të komenteve të diskutuara.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 13: Duke marrë parasysh natyrën dhe përmbajtjen e shkeljes së Nenit 14 të konstatuar më sipër, kërkohej një ekzaminim i veçantë në lidhje me faktin nëse, për shkak



të qëndrimeve diskriminuese që kishin ndikuar negativisht në zbatimin e ligjit vendas, mjetet juridike përgjithësisht efektive kishin rezultuar joefektive në këtë rast të veçantë.

Në nivelin teknik, meqenëse shumica e komenteve të kundërshtuara ishin postuar nga persona që përdorin profilet e tyre personale, nuk mund të argumentohet që autoritetet do të kishin hasur në vështirësi në identifikimin e autorëve të tyre, po të kishin dashur ta bënin këtë.

Duke pasur parasysh trendin e përgjithshëm në praktikën gjyqësore të gjykatave vendase, konkluzionet e arritura nga organet ndërkombëtare të monitorimit dhe informacionin statistikor të komunikuar asaj, Gjykata vendosi që pyetja e mësipërme duhej të përgjigjej në formën pohore. Në përmbajtje, konstatoi se:

- mënyra në të cilën prokurori e kishte parë të arsyeshme të zbatonte praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohej se parashikonte një mjet efektiv juridik të brendshëm në lidhje me ankesat mbi aktet e diskriminimit homofobik (pasi Gjykata e Lartë nuk kishte pasur kurrë mundësi të sqaronte standardet që do të zbatohen në rastet e gjuhës së urrejtjes të një ashpërsie të krahasueshme);
- autoritetet nuk po bënin pothuajse asgjë përballë intolerancës në rritje ndaj pakicave seksuale; në të vërtetë, organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit nuk i njohën paragjykimet si motivim në vepra të tilla; ata nuk kishin miratuar një qasje që merrte parasysh seriozitetin e situatës; dhe, në veçanti, nuk kishte një qasje gjithëpërfshirëse për të trajtuar çështjen e gjuhës raciste dhe homofobike të urrejtjes.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 5 000 Euro secilit prej kërkuesve në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu Buletinin faktik për [Homoseksualiteti: aspektet kriminale](#), dhe, në përgjithësi, në lidhje me atë nëse masat e së drejtës penale janë të nevojshme në raste të agresionit verbal dhe kërcënimeve fizike të drejtpërdrejta të motivuara nga qëndrime diskriminuese, R.B. kundër Hungarisë, [64602/12](#), 12 prill 2016, Shënim Informativ 195, dhe Király dhe Dömötör kundër Hungarisë, [10851/13](#), 17 janar 2017, Shënim Informativ 203 – çështje in të cilat viktimat ishin anëtarë të komunitetit rom)

## Neni 10

### Neni 10-1, Liria e shprehjes, Liria për të dhënë informacion

Baza ligjore e parashikueshme në masë të pamjaftueshme për një globë për një parti politike për vënien në dispozicion të një aplikacioni celular që lejon votuesit të ndajnë fotografi anonime të fletëve të tyre të votimit: shkelje

***Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë [DHM] - 201/17, Vendim 20.1.2020 [DHM]***

**Faktet** – Në vitin 2016 u mbajt në Hungari një referendum në lidhje me planin e Bashkimit European mbi zhvendosjen në kuadrin e migracionit. Par para referendumit kërkuesi, një parti politike e quajtur Magyar Kétfarkú Kutya Párt (“MKKP”), u kishte vënë në dispozicion votuesve një aplikacion në celular të cilin ata mund ta përdornin për të ngarkuar dhe shpërndarë në mënyrë anonime fotografitë të fletëve të tyre të votimit në publik. Pas ankesave nga një individ privat në Komisionin Kombëtar të Zgjedhjeve (KKZ), partia kërkuese u gjobit për shkeljen e parimeve të drejtësisë dhe fshehtësisë së zgjedhjeve dhe të ushtrimit të të drejtave në përputhje me qëllimin e tyre. Kúria mbështeti gjetjen e KKZ-së në lidhje me shkeljen e parimit të ushtrimit të të drejtave në përputhje me qëllimin e tyre, por rrëzoi përfundimet e tij në lidhje me fshehtësinë e votimit dhe drejtësinë e referendumit. Ankesa kushtetuese e palës kërkuese u shpall e papranueshme.

Me vendimin e datës 23 janar 2018 (shih [Shënimin Informativ 214](#)), një Dhomë e Gjykatës u shpreh, unanimisht, që ka patur shkelje të Nenit 10 të Konventës. Sipas mendimit të Gjykatës, sjellja e palës kërkuese nuk sillte ndonjë paragjykim në lidhje me fshehtësinë ose drejtësinë e referendumit. Sanksioni i vendosur ndaj kërkuesit nuk ndiqte asnjë nga qëllimet legjitime të renditura në Nenin 10 § 2.

Më 28 maj 2018, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

***Ligji – Neni 10***

(a) Ekzistenca e një ndërhyrjeje – Vendimet e autoriteteve të brendshme kishin ndërhyrë në lirinë e shprehjes së MKKP-së. Për Gjykatën, postimi i fotografive të fletëve të votimit ishte një formë e sjelljes që cilësohej si ushtrim i lirisë së shprehjes.

MKKP-ja nuk kishte qenë autori i fotografive në fjalë; përkundrazi, ajo kishte marrë pjesë në përhapjen e tyre duke siguruar një aplikacion në celular për publikimin e tyre. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata kishte konstatuar që Neni 10 zbatohet jo vetëm për përmbajtjen e informacionit, por edhe për mjetet e shpërndarjes, pasi që çdo kufizim i vendosur këtij të fundit domosdoshmërisht ndërhynte në të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacion. Aplikacioni në celular ishte një mjet i vendosur nga MKKP-ja për votuesit për të dhënë mendimet e tyre politike, duke i lejuar ata të ushtronin të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes.

Në përputhje me interpretimin e sjelljeve të MKKP-së nga autoritetet vendase, Gjykata konsideroi se MKKP-ja kishte kërkuar jo vetëm të siguronte një forum për votuesit për

të shprehur mendimin e tyre, por edhe për të përcjellë vetë një mesazh politik. Duke pasur parasysh kontekstin - kohën e një referendumi kombëtar - dhe emërtimin e aplikacionit - “Hidhni një votë të pavlefshme” - funksionimi i këtij aplikacioni në celular do të konsiderohej si një shprehje e mendimit politik të MKKP-së për referendumin në fjalë.

MKKP-ja kishte pretenduar se ishte penalizuar jo për kryerjen e aktivitetit të fushatës si e tillë, por bërjen e saj përmes aplikacionit celular në fjalë. Mbrojtja e Nenit 10 shtrihej jo vetëm në përmbajtjen e ideve dhe informacionit të shprehur, por edhe në formën në të cilën ato u përcollën. Sjellja e MKKP-së hynte në këtë kategori.

Në rrethanat e kësaj çështje, të dy aspektet - sigurimi i një forumi për përmbajtjen e palëve të treta dhe dhënia e informacionit dhe vetë ideve - ishin të ndërthurura në mënyrë të pandashme. Vënia në dispozicion të votuesve i një aplikacioni në celular dhe thirrja e tyre për të ngarkuar dhe publikuar fotografi të fletëve të votimit, duke i inkurajuar ata të hedhin një votë të pavlefshme, përfshinte ushtrimin e të drejtës së MKKP-së për lirinë e shprehjes në lidhje me të dy aspektet.

Reagimi i autoriteteve ndaj ushtrimit të të drejtave nga MKKP-ja sipas Nenit 10 të Konventës kishte kaluar në një ndërhyrje në ato të drejta.

(b) Nëse ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj – Objekti i nocionit të parashikueshmërisë varej në një shkallë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, fusha që ishte krijuar për të mbuluar dhe numri dhe statusi i atyre të cilëve u drejtohej. Konteksti zgjedhor mori një rëndësi të veçantë në këtë drejtim, duke pasur parasysh rëndësinë e integritetit të procesit të votimit në ruajtjen e besimit të elektoratit në institucionet demokratike.

Nëse dispozitat ligjore që rregullojnë zgjedhjet formojnë bazën për kufizimin e ushtrimit të lirisë së shprehjes, ky ishte një element shtesë që duhej të merrej parasysh kur merreshin parasysh kërkesat e parashikueshmërisë që ligji duhej të përmbushte. Në lidhje me këtë, fjala e lirë ishte thelbësore për të siguruar “shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve në zgjedhjen e ligjvënësit”. Për këtë arsye, ishte veçanërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirshëm. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë kur liria e shprehjes në fjalë ishte ajo e një partie politike. Siç kishte theksuar Gjykata në mënyrë të përsëritur, partitë politike luajtën një rol thelbësor në sigurimin e pluralizmit dhe funksionimin e duhur të demokracisë. Kufizimet në lirinë e tyre të shprehjes duhej ti nënshtroheshin mbikëqyrjes rigoroze. E njëjta zbatohet, mutatis mutandis, në kontekstin e një referendumi që synon identifikimin e vullnetit të elektoratit për çështje me interes publik.

Sipas mendimit të Gjykatës, kjo lloj mbikëqyrjeje natyrisht shtrihej në vlerësimin nëse baza ligjore ku mbështeteshin autoritetet në kufizimin e lirisë së shprehjes së një partie politike ishte e parashikueshme në efektet e saj deri në atë masë sa të përjashtojë çdo arbitraritet në zbatimin e saj. Mbikëqyrja rigoroze këtu jo vetëm që shërbeu për të mbrojtur partitë politike demokratike nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve, por gjithashtu mbrojt vetë demokracinë, pasi çdo kufizim i lirisë së shprehjes në këtë kontekst pa rregullime mjaftueshmërisht të parashikueshme mund të dëmtojë debatin e hapur politik, legjitimitetin e procesit të votimit dhe rezultatet e tij dhe, në fund të fundit, besimin e qytetarëve në integritetin e institucioneve demokratike dhe përkushtimin e tyre në sundimin e ligjit.

Çështja kryesore në rastin konkret ishte nëse MKKP-ja - në mungesë të një dispozite detyruese të legjislacionit vendas që rregullon shprehimisht bërjen e fotografive të fletëve të votimit dhe ngarkimin e atyre fotografive në një mënyrë anonime në një aplikacion mobil për shpërndarje ndërsa votimi kishte qenë në vazhdim e sipër - e dinte ose duhej ta dinte (nëse do të ishte e nevojshme, pasi të kishte marrë këshillat e duhura ligjore) që sjellja e saj do të shkelte ligjin ekzistues të procedurave zgjedhore.

Paqartësia e parimit të “ushtrimit të të drejtave në përputhje me qëllimin e tyre”, e mishëruar në Nenin 2 (1) (e) të Ligjit të Procedurës Zgjedhore (LPZ), ishte theksuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj. LPZ-ja nuk kishte përkufizuar se çfarë ishte në përmbajtje një shkelje e parimit dhe nuk kishte vendosur ndonjë kriter për të përcaktuar se cila situatë përbënte shkelje të kërkesës për të ushtruar të drejtat në përputhje me qëllimin e tyre, dhe as nuk jepte ndonjë shembull. Sipas konceptimit të Gjykatës Kushtetuese, gjithashtu nuk ishte e mundur të përcaktoheshin kritere përgjithësisht të zbatueshme për ushtrimin e të drejtave që nuk përputhen me qëllimin e tyre; përkundrazi, i takoi Komisionit Kombëtar të Zgjedhjeve (KKZ) dhe përfundimisht gjykatave vendase për të konkluduar, bazuar në shqyrtimin e të gjitha rrethanave të një çështjeje të caktuar, nëse një sjellje e caktuar kishte shkelur parimin.

Gjykata vlerësoi se një situatë që sjell si pasojë interpretimin gjyqësor të parimeve të sanksionuara në ligj nuk do të binte domosdoshmërisht në kundërshtim me kërkesën që ligji të hartohet në terma mjaftueshëm të saktë. Sidoqoftë, fakt mbeti që kuadri rregullator i brendshëm i aplikuar në rastin konkret kishte parashikuar mundësinë e një kufizimi në sjelljen në lidhje me shprehjen të lidhur me votimin rast pas rasti dhe për këtë arsye u kishte dhënë një diskrecion shumë të gjerë organeve zgjedhore dhe gjykatat vendase që kishin për ta interpretuar dhe zbatuar atë. Si pasojë, mungesa e qartësisë në Aeksionin 2 (1) (e) të LPZ-së dhe rreziku i mundshëm i natyrshëm në interpretimin e tij për gëzimin e të drejtave të lidhura me votimin, përfshirë

diskutimin e lirë të çështjeve publike, kërkonte një kujdes të veçantë nga autoritetet e brendshme.

Sa i përket interpretimit të Nenit 2(1)(e) të LPZ-së, Gjykata Kushtetuese kishte kufizuar efektin e dispozitës në sjelljen e lidhur me votimin që sillte “pasoja negative”, përfshirë shkeljen e të drejtave të të tjerëve. Një qasje e ngjashme doli nga praktika gjyqësore e Kúria-s. Megjithatë, Kúria kishte konstatuar se fshehtësia e votimit nuk ishte shkelur pasi që aplikacioni në celular nuk kishte lejuar hyrjen në të dhënat personale të përdoruesve dhe kështu kishte qenë i paafte për të lidhur një fletë votimi me një votues. Më tej ajo konstatoi se sjellja e MKKP-së nuk kishte asnjë ndikim lëndor në drejtësinë e referendumit kombëtar dhe nuk kishte qenë në gjendje të lëkundte besimin e publikut në punën e organeve zgjedhore. Nuk u nxor asnjë përfundim se si kufizimi i diskutuar, bazuar në parimin e ushtrimit të të drejtave në përputhje me qëllimin e tyre, lidhej dhe adresonte një “pasoje negative” konkrete, qoftë potenciale apo faktike.

Rasti konkret ishte me sa duket i pari në të cilin autoritetet vendase kishin zbatuar parimin e ushtrimit të të drejtave, në përputhje me qëllimin e tyre, për përdorimin e një aplikacioni celular për postimin e fotografive të fletëve të votimit në një mënyrë anonime. Kjo, si e tillë, nuk e bënte interpretimin e ligjit të paparashikueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të parashikueshmërisë së ligjit kur bëhej fjalë për kufizimin e lirisë së shprehjes së një partie politike në kontekstin e zgjedhjeve ose një referendumi, Gjykata mbështeti mendimin se pasiguria e konsiderueshme në lidhje me efektet e mundshme nga dispozitat ligjore të diskutuara të zbatuara nga autoritetet vendase kishin tejkaluar atë që ishte e pranueshme sipas Nenit 10 § 2 të Konventës.

**Përfundim:** shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një).

Neni 41: 330 Euro në lidhje me dëmin financiar.

### Neni 3

#### Hetimi efektiv, Detyrimet pozitive

Dështimi i autoriteteve për zhvilluar një hetim penal nga këndvështrimi i dhunës në familje: shkelje

## Neni 8

### Detyrime pozitive, Neni 8-1, Respektimi i korrespondencës

Dështimi i gjykatave për të shqyrtuar bazueshmërinë e një ankese të ngacmimit në internet të lidhur ngushtë me një ankesë mbi dhunën në familje: *shkelje*

***Buturugă kundër Rumanisë*** - 56867/15, Vendim 11.2.2020 [Seksioni IV]

**Faktet** – Duke u mbështetur në një certifikatë mjeko-ligjore, kërkesja raportoi tek autoritetet mbi sjelljen e dhunshme të ish-burrit të saj. Ajo kërkoi një kontroll elektronik të kompjuterit të familjes për t’u përdorur në provë në procedimin penal, duke pretenduar se ish burri i saj kishte konsultuar në mënyrë të gabuar llogaritë e saj elektronike, përfshirë llogarinë e saj në Facebook, dhe se ai kishte bërë kopje të bisedave, dokumenteve dhe fotografive të saj private. Kjo kërkesë u hodh poshtë me arsyetimin se çdo provë që mund të merrej në këtë mënyrë do të ishte e palidhur me kërcënimet e pretenduara dhe veprimet e dhunshme të kryera nga ish burri i saj. Më pas, kërkesja paraqiti një ankesë tjetër kundër ish burrit të saj për shkelje të konfidencialitetit të korrespondencës së saj, e cila u rrëzua si jashtë afatit. Zyra e prokurorisë publike i vendosi një gjobë administrative ish-burrit të saj dhe ndërpreu çështjen, duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Penal që rregullon dhunën midis individëve privatë dhe jo në ato që lidhen me dhunën në familje. Gjykata la në fuqi konkluzionet e zyrës së prokurorit për efekt se kërcënimet ndaj kërkueses nuk ishin aq serioze sa për t’u kualifikuar si vepra penale dhe se nuk ishte prodhuar asnjë provë e drejtpërdrejtë që të tregonte se dëmtimet e pësuar nga kërkesja ishin shkaktuar nga ish burri i saj. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të konfidencialitetit të korrespondencës së saj, gjykata vendosi që kjo çështje të mos kishte lidhje me përmbajtjen e çështjes dhe se të dhënat e publikuara në rrjetet sociale ishin publike.

**Ligji** – Neni 3 dhe 8:

(a) Hetimi i keqtrajtimit – Autoritetet nuk i trajtuan faktet e kundërshtuara nga këndvështrimi i i dhunës në familje. Në të vërtetë, hetimi nuk mori parasysh veçoritë specifike të dhunës në familje siç njihen nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjykata nuk ishte e bindur se konstatimet e gjykatës së brendshme në çështjen në fjalë kishin pasur një efekt parandalues në masë të mjaftueshme për të parandaluar një problem kaq serioz siç është dhuna në familje. Për më tepër, ndërsa asnjë nga autoritetet vendase nuk e kishte kundërshtuar realitetin dhe ashpërsinë e lëndimeve të pësuar nga kërkesja, asnjë provë e përshtatshme nuk kishte dalë nga hetimi

për të identifikuar personin përgjegjës. Autoritetet hetimore ishin kufizuar kështu në marrjen në pyetje të të afërmeve të kërkueses si dëshmitarë, duke mos arritur të mbledhnin asnjë lloj prove tjetër për të konstatuar origjinën e dëmtimeve të kërkueses dhe, ndoshta, ata që ishin përgjegjës për shkaktimin e tyre. Në një rast në lidhje me veprimet e pretenduara të dhunës në familje, autoritetet hetimore duhej të kishin ndërmarrë veprimet e nevojshme për të sqaruar rrethanat e çështjes. Prandaj, edhe pse kuadri ligjor i vendosur nga shteti i paditur i kishte siguruar kërkueses një formë mbrojtjeje, ky i fundit kishte hyrë në fuqi më pas veprimeve të diskutuara të dhunës dhe kishte dështuar të korrigjonte mangësitë në hetim.

(b) Hetimi për shkeljen e konfidencialitetit të korrespondencës së kërkueses –Si në të drejtën e brendshme ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare, fenomeni i dhunës në familje konsiderohet jo i kufizuar në dhunë fizike, por gjithashtu duke përfshirë dhunën psikologjike ose ngacmimin. Për më tepër, ngacmimi në internet njihet aktualisht si një aspekt i dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe mund të marrë forma të ndryshme, përfshirë shkeljet kibernetike të privatësisë, hakerimin e kompjuterit të viktimës dhe vjedhjen, ndarjen dhe manipulimin e të dhënave dhe imazheve, duke përfshirë detaje intime. Në kontekstin e dhunës në familje, mbikëqyrja kibernetike shpesh gjurmohet nga partneri i personit. Prandaj, Gjykata pranoi që veprime të tilla si monitorimi i pahijshëm, hyrja dhe ruajtja i korrespondencës së bashkëshortit ose partnerit mund të merren parasysh nga autoritetet e brendshme kur hetojnë rastet e dhunës në familje. Në bazë të pretendimeve të tilla për shkelje të konfidencialitetit të korrespondencës autoriteteve u kërkohej të kryenin një ekzaminim të fakteve në mënyrë që të përftonin një kuptim gjithëpërfshirës të fenomenit të të gjitha formave të mundshme të dhunës në familje.

Asnjë shqyrtim nuk ishte kryer në lidhje me themelin e çështjes në fjalë. Autoritetet vendase nuk kishin arritur të ndërmerrnin hapat procedurale për të mbledhur prova për të konstatuar realitetin ose klasifikimin ligjor të fakteve. Ato kishin qenë tepër formaliste në refuzimin e çdo lidhjeje të mundshme me dhunën në familje që kërkuesja tashmë kishte sjellë në vëmendjen e tyre, dhe kështu kishin shpërfillur format e ndryshme të mundshme që kishte marrë dhuna në familje.

Prandaj, Shteti nuk kishte arritur të respektojte detyrimet e tij pozitive sipas Neneve 3 dhe 8 të Konventës.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 10 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih Buletinin faktik për [Dhunën në familje](#) dhe [Dhunën ndaj grave](#). Shih gjithashtu Opuz kundër Turqisë, [33401/02](#), 9 qershor 2009, Shënim Informativ 120; E.S. dhe të Tjerë kundër Republikës së Sllovakisë, [8227/04](#), 15 shtator 2009, Shënim Informativ 122; E.M. kundër Rumanisë, [43994/05](#), 30 tetor 2012, Shënim Informativ 156; Valiulienë kundër Lituanisë, [33234/07](#), 26 mars 2013, Shënim Informativ 161; T.M. dhe C.M. kundër Republikës së Moldavisë, [26608/11](#), 28 janar 2014; dhe Bălșan kundër Rumanisë, [49645/09](#), 23 maj 2017, Shënim Informativ 207)

## Neni 4 i Protokollit Nr. 4.

### Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

Kthimi i menjëhershëm dhe i detyruar i të huajve nga një kufi tokësor, pas një përpjekjeje nga një numër i madh i migrantëve për ta kaluar atë në një mënyrë të paautorizuar dheen masse: *nuk ka shkelje*

**N.D. dhe N.T. kundër Spanjës [DHM]** - 8675/15 dhe 8697/15, Vendimi 13.2.2020 [DHM]

**Faktet** – Në gusht të vitit 2014, një grup prej disa qindra migrantësh nga Afrika nën-Sahariane, përfshirë kërkuesit, u përpoqën të hynin në Spanjë duke kapërcyer rrethimin e qytetit të Melillas, një enklavë spanjolle në bregun e Afrikës Veriore. Sapo ata kishin kaluar rrethimin, u kapën nga anëtarët e Guardia Civil, të cilët dyshohen se u vunë prangat dhe i kthyen në anën tjetër të kufirit. Kërkuesit thuhet se nuk iu nënshtruan asnjë procedure identifikimi dhe nuk kishin asnjë mundësi për të shpjeguar rrethanat e tyre personale. Ata më pas arritën të hyjnë në Spanjë pa autorizim dhe u lëshuan urdhra për dëbimin e tyre. Ankesat e tyre administrative u rrëzuan, ashtu si dhe kërkesa për azil e paraqitur nga njëri prej tyre.

Në një vendim të datës 3 tetor 2017 (shih [Shënimin Informativ 211](#)) një Dhomë e Gjykatës vendosi njëzëri se kishte pasur një shkelje të Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 për shkak të mungesës së shqyrtimit të individualizuar të situatës së secilit prej kërkuesve dhe një shkelje të Nenit 13 të Konventës të marrë së bashku me Nenin 4 të Protokollit nr. 4.

Më 29 shtator 2018, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

**Ligji** – Neni 4 i Protokollit nr 4:

(a) Zbatueshmëria –Gjykatws iu kërkua për herë të parë të trajtonte çështjen e zbatueshmërisë së Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 për kthimin e menjëhershëm dhe me



forcë të të huajve nga një kufi tokësor, pas një përpjekjeje nga një numër i madh i migrantëve për të kaluar atë kufi në mënyrë të paautorizuar dheen masse. Ndërsa Qeveria pohoi se çështja e kërkesve kishte të bënte me një refuzim të pranimit në territorin Spanjoll sesa një dëbim, Gjykata duhej të konstatonte nëse koncepti i “dëbimit” gjithashtu përfshinte mos-pranimin e të huajve në kufirin e një Shteti Kontraktues apo - në lidhje me shtetet që i përkasin zonës Shengen - në një kufi të jashtëm të asaj zone, sipas rastit.

Gjykata nuk kishte vendosur më parë mbi dallimin midis mos-pranimit dhe dëbimit të të huajve, dhe në veçanti të migrantëve ose azilkërkesve, të cilët ishin brenda juridiksionit të një Shteti që po i largonte me forcë nga territori i tij. Për personat në rrezik keq-trajtimi në vendin e destinacionit, rreziku ishte i njëjtë në të dy rastet, përkatësisht ai i të qenit viktimë e një trajtimi të tillë. Shqyrtimi i materialeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian mbështeste pikëpamjen e Gjykatës se mbrojtja e Konventës, e cila duhej të interpretohej në mënyrë autonome, nuk mund të varej nga konsiderata formale. Qasja e kundërt do të sillte rreziqe serioze të arbitraritetit, për aq sa personat që kanë të drejtë për mbrojtje sipas Konventës mund të privohen nga një mbrojtje e tillë, për shembull me arsyetimin se, duke mos kaluar kufijtë e Shtetit në mënyrë të ligjshme, ata nuk mund të paraqisnin një pretendim të vlefshëm për mbrojtje sipas Konventës. Shqetësimi legjitim i shteteve për të penguar përpjekjet gjithnjë e më të shpeshta për të shmangur kufizimet e imigracionit nuk mund të shkonte aq larg sa të bënte joefektive mbrojtjen e ofruar nga Konventa, dhe në veçanti nga Neni 3, i cili përqafoi ndalimin e rikthimit brenda kuptimit të Konventës së Gjenevës në lidhje me Statusin e Refugjatëve.

Këto arsye e kishin shtyrë Gjykatën që, në përdorimin konkret, ta interpretonte termin “dëbim” në kuptimin e përgjithshëm (“për të përzënë nga një vend”), si referim të çdo largimi me forcë të një të huaji nga territori i një Shteti, pavarësisht nga ligjshmëria e qëndrimit të personit, kohëzgjatjes që ai ose ajo ka kaluar në territor, vendndodhjes në të cilën ai / ajo është kapur, statusi i tij/saj si migrant ose azilkërkes dhe sjelljes së tij/saj kur kalon kufirin. Si rezultat, Neni 3 i Konventës dhe Neni 4 i Protokollit Nr. 4 ishin konstatuar të zbatoheshin për çdo situatë që përfshihej brenda juridiksionit të një Shteti Kontraktues, përfshirë situatat ose momentet kur autoritetet e shtetit në fjalë kishin nuk kishin shqyrtuar ende ekzistencën e shkaqeve që u jepnin të drejtë personave në fjalë të kërkonin mbrojtje sipas atyre dispozitave. Sipas Gjykatës, këto konsiderata, të cilat formuan bazën për vendimet e saj të fundit në Hirsi Jamaa dhe të Tjerë, Sharifi dhe të Tjerë dhe Khlaifia dhe të Tjerë, në lidhje me kërkesit që ishin përpjekur të hynin në territorin e një Shteti përmes detit, nuk kishin humbur asgjë

nga rëndësia e tyre. Prandaj nuk kishte asnjë arsye për të miratuar një interpretim të ndryshëm të termit “dëbim” në lidhje me largimet me forcë nga territori i një Shteti në kontekstin e një përpjekjeje për të kaluar një kufi kombëtar nëpërmjet tokës.

Në rastin konkret, kërkuesit ishin larguar nga territori spanjoll dhe ishin kthyer me forcë në Marok, kundër vullnetit të tyre dhe në pranga, nga anëtarët e Guardia Civil. Prandaj kishte pasur një “dëbim” brenda kuptimit të Nenit 4 të Protokollit Nr. 4.

(b) Themeli – Ndërsa Neni 4 i Protokollit Nr. 4 kërkonte nga autoritetet shtetërore të siguronin që secili prej të huajve të interesuar të kishte një mundësi të mirëfilltë dhe efektive për të paraqitur argumente kundër dëbimit të tij ose të saj, sjellja e vetë kërkuesit ishte një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e mbrojtjes që duhej dhënë sipas asaj dispozite. Sipas praktikës së mirë-vendosur të Gjykatës, nuk kishte shkelje të Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 nëse mungesa e një vendimi konkret për largimin ishte pasojë e sjelljes së vetë kërkuesit. Në veçanti, mungesa e bashkëpunimit aktiv me procedurën për kryerjen e një shqyrtimi individual të rrethanave të kërkuesve kishte shtyrë Gjykatën të konstatonte se Qeveria nuk mund të mbahej përgjegjëse për faktin se asnjë shqyrtim i tillë nuk ishte kryer. Sipas mendimit të Gjykatës, i njëjti parim duhet të zbatohet edhe për situatat në të cilat sjellja e personave që kaluan një kufi tokësor në një mënyrë të paautorizuar, qëllimisht shfrytëzuan numrin e tyre të madh dhe përdorën forcën, ishte e tillë që të krijonte një situatë qartazi penguese e cila ishte e vështirë për tu kontrolluar dhe rrezikonte sigurinë publike.

Sidoqoftë, në këtë kontekst, Gjykata do t’i kushtonte një rëndësi të konsiderueshme nëse, në rrethanat e çështjes konkrete, Shteti i paditur kishte siguruar një akses të mirëfilltë dhe efektiv në mjetet e hyrjes së ligjshme, veçanërisht në procedurat kufitare. Kur Shteti i paditur e kishte siguruar një akses të tillë por një kërkues nuk e kishte përdorur atë, Gjykata duhej të merrte parasysh, në kontekstin e çështjes në fjalë dhe pa paragjykuar zbatimin e Neneve 2 dhe 3 të Konventës, nëse kishte arsye bindëse që e pengonin personin në fjalë ta bëjë këtë, bazuar në fakte objektive për të cilat ishte përgjegjës Shteti i paditur.

Mjetet e hyrjes së ligjshme duhej të lejonin të gjithë personat që përballeshin me përndjekje të paraqisnin një kërkesë për mbrojtje, bazuar veçanërisht në Nenin 3, në kushtet që garantonin që kërkesa do të përpunohej në përputhje me normat ndërkombëtare. Në kontekstin e çështjes faktike, zbatimi i Kodit të Kufijve Shengen presupozonte ekzistencën e një numri të mjaftueshëm të pikave të kalimit kufitar. Në mungesë të rregullimeve të përshtatshme, Shtetet mund të refuzonin hyrjen në territorin e tyre; kjo mund të bënte të paefektshme të gjitha dispozitat e Konventës

të destinuara për të mbrojtur individët që përballeshin me një rrezik të vërtetë përndjekjeje.

Sidoqoftë, nëse ekzistonin rregullime të tilla dhe garantonin të drejtën për të kërkuar mbrojtje sipas Konventës, dhe në veçanti të Nenit 3, në një mënyrë të mirëfilltë dhe efektive, Konventa nuk i ndalonte Shtetet që, në përmbushje të detyrimit të tyre për të kontrolluar kufijtë, të kërkonin që aplikimet për një mbrojtje të tillë të paraqiteshin në pikat ekzistuese të kalimit kufitar. Si pasojë, ata mund të refuzonin hyrjen në territorin e tyre për të huajt, përfshirë azilkërkuesit e mundshëm, të cilët kishin dështuar, pa shkaqe të arsyeshme, të përmbushin këto kërkesa duke kërkuar ta kalonin kufirin në një vend tjetër, veçanërisht, siç kishte ndodhur në këtë rast, duke përfituar nga numri i tyre i madh dhe duke përdorur forcën në kontekstin e një operacioni që ishte planifikuar paraprakisht.

Ligji spanjoll u kishte ofruar kërkuesve disa mjete të mundshme për të kërkuar pranimin në territorin kombëtar. Është vërtetuar që në 1 Shtator 2014, menjëherë pas ngjarjeve në rastin në fjalë, autoritetet Spanjolle kishin ngritur një zyrë për regjistrimin e kërkesave të azilit në pikën e kalimit kufitar ndërkombëtar Beni Enzar. Për më tepër, edhe para ngritjes së asaj zyre, nuk kishte pasur vetëm një detyrim ligjor për të pranuar kërkesa për azil në atë pikë kalimi kufitar, por edhe një mundësi reale për të paraqitur kërkesa të tilla.

Kërkuesit nuk e kishin shfrytëzuar atë mundësi me qëllim që të paraqisnin arsyet kundër dëbimit të tyre në mënyrën e duhur dhe të ligjshme. Vetëm mungesa e shkaqeve të arsyeshme të bazuara në fakte objektive për të cilat Shteti i paditur ishte përgjegjës dhe parandalimi i përdorimit të asaj rruge ligjore mund të çonte që kjo të konsiderohej si pasojë e sjelljes së vetë kërkuesve, duke justifikuar faktin që rojet kufitare Spanjolle të mos i identifikonin ata individualisht. Gjykata nuk u bind se kërkuesit kishin shkaqe të arsyeshme për të mos përdorur pikën e kalimit kufitar Beni Enzar. Në rastin konkret, edhe duke supozuar vështirësitë që kishin ekzistuar në shkuarjen fizikisht në pikën e kalimit në anën marokene, nuk ishte konstatuar asnjë përgjegjësi e Qeverisë së paditur për atë situatë. Ky konstatim ishte i mjaftueshëm që Gjykata të konkludonte se nuk kishte shkelje të Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 në çështjen në fjalë.

Gjykata vuri në dukje argumentin e Qeverisë që, përveç ofrimit të aksesit të mirëfilltë dhe efektiv në territorin Spanjoll në pikën e kalimit kufitar Beni Enzar, kërkuesit mund të kishin aplikuar për një vizë ose për mbrojtje ndërkombëtare në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Spanjës në vendet e tyre të origjinës ose transitit ose

tjetër në Marok. Në mënyrë të veçantë, nëse kërkuesit do të kishin dashur të kërkonin një mbrojtje të tillë, ata mund të kishin udhëtuar lehtësisht në konsullatën Spanjolle në Nador, e cila ishte afër vendit ku kishte ndodhur sulmi i rrethimeve kufitarë. Ata nuk i kishin ofruar asnjë shpjegim Gjykatës se pse nuk e kishin bërë atë. Në veçanti, ata madje nuk pretenduan se ishin penguar në përdorimin e këtyre mundësive. Në çdo rast, përfaqësuesit e kërkuesve nuk kishin qenë në gjendje të tregonin as shkakun më të vogël konkret faktik ose ligjor, i cili, sipas së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme, do të përjashtonte largimin e kërkuesve po të ishin regjistruar individualisht. Për më tepër, ankesat e kërkuesve sipas Nenit 3 ishin deklaruar të papranueshme nga Dhoma.

Si pasojë, në përputhje me praktikën e saj gjyqësore të vendosur, Gjykata konsideroi se mungesa e vendimeve individuale të largimit mund t'i atribuohet faktit që kërkuesit, nëse vërtet dëshironin të pohonin të drejtat sipas Konventës, nuk kishin përdorur hyrjen aksesin procedurat ekzistuese për atë qëllim, dhe kështu kishin qenë pasojë e sjelljes së tyre.

Sidoqoftë, Gjykata specifikoi se kjo gjetje nuk vuri në pikëpyetje konsensusin e gjerë brenda bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me detyrimin dhe domosdoshmërinë që Shtetet Kontraktuese të mbrojnë kufijtë e tyre - d.m.th., kufijtë e tyre ose kufijtë e jashtëm të zonës Shengen, sipas rastit, - në një mënyrë që të përputhet me garancitë e Konventës, dhe veçanërisht me detyrimin emoskthimit.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

Gjykata gjithashtu u shpreh, njëzëri, se nuk kishte asnjë shkelje të Nenit 13 të marrë në lidhje me Nenin 4 të Protokollit Nr. 4, me arsyetimin se mungesa e një procedure individuale të largimit kishte qenë pasojë e sjelljes së vetë kërkuesve dhe që ankesa e kërkuesve në lidhje me rreziqet me të cilat mund të përballeshin në vendin e destinacionit ishte hedhur poshtë në fillim të procedimit.

(Shih Hirsi Jamaa dhe të Tjerë kundër Italisë [DHM], [27765/09](#), 23 shkurt 2012, [Shënim Informativ 149](#); Sharifi dhe të Tjerë kundër Italisë dhe Greqisë, [16643/09](#), 21 tetor 2014, [Shënim Informativ 178](#); Khlaifia dhe të Tjerë kundër Italisë [DHM], [16483/12](#), 15 dhjetor 2016, [Shënim Informativ 202](#); shih gjithashtu M.A. kundër Qipros, [41872/10](#), 23 korrik 2013, [Shënim Informativ 165](#); Berisha dhe Haljiti kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (dec.), [18670/03](#), 16 qershor 2005, [Shënim Informativ 76](#); dhe Dritsas dhe të Tjerë kundër Italisë (dec.), [2344/02](#), 1 shkurt 2011)

## Neni 4

### Detyrimet pozitive, Hetimi efektiv, Neni 4-1, Trafikimi i qenieve njerëzore

Mangësi të konsiderueshme në përgjigjen procedurale të brendshme ndaj pretendimit të diskutueshëm të trafikimit njerëzor dhe prostitucionit të detyruar, të mbështetur nga provat prima facie: shkelje

**S.M. kundër Kroacisë [DHM]** - 60561/14, Vendimi 25.6.2020 [DHM]

**Faktet** – Kërkesja paraqiti një ankesë penale kundër T.M., një ish-polic, duke pretenduar se ai e kishte detyruar atë fizikisht dhe psikologjikisht të futej në prostitucion. Më pas polici u akuzua me akuzat e detyrimit të dikujt për prostitucion, si një veprë e rëndë e organizimit të prostitucionit. Në vitin 2013, gjykata penale e shpalli të pafajshëm me arsyetimin se, megjithëse ishte vërtetuar se ai kishte organizuar një rrjet prostitucioni në të cilin ai kishte rekrutuar kërkuessen, nuk ishte vërtetuar se ai e kishte detyruar atë të prostituonte. Ai ishte akuzuar vetëm për formën e rëndë të veprës në fjalë dhe kështu ai nuk mund të dënohej për formën bazë të organizimit të prostitucionit. Ankesa e Zyrës së Avokatit të Shtetit kundër vendimit u rrëzua dhe ankesa kushtetuese e kërkuesses u deklarua e papranueshme.

Me vendimin e datës 19 korrik 2018 (shih [Shënimin Informativ 220](#)), një Dhomë e Gjykatës u shpreh, gjashtë vota me një, se autoritetet shtetërore përkatëse nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre procedurale sipas Nenit 4. Veçanërisht, ata as nuk kishin hetuar në thellësi të gjitha rrethanat përkatëse dhe as kishin bërë ndonjë vlerësim të ndikimit të mundshëm të traumës psikologjike në aftësinë e kërkuesses për të treguar në mënyrë të vazhdueshme dhe të qartë rrethanat e shfrytëzimit të saj.

Më 3 dhjetor 2018, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

**Ligji** – Neni 4 Gjykata sqaroi disa aspekte të praktikës së saj gjyqësore mbi trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit të prostitucionit.

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe “shfrytëzimi i prostitucionit” sipas Nenit 4

(i) Trafikimi i qenieve njerëzore ishte brenda objektit të Nenit 4. Kjo, megjithatë, nuk përjashtoi mundësinë që, në rrethanat të veçanta të një çështjeje, një formë e veçantë e sjelljes në lidhje me trafikimin njerëzor të mund të ngrejë një çështje sipas një dispozite tjetër të Konventës;

(ii) Nuk ishte e mundur të karakterizohej sjellja ose një situatë si çështje e trafikimit të qenieve njerëzore, e cila bie brenda sferës së zbatimit të Nenit 4, përveç nëse ishin

të pranishëm elementet përbërëse të përkufizimit ndërkombëtar të trafikimit, sipas [Konventës kundër Trafikimit](#) dhe [Protokollit të Palermos](#).

Tre elementët përbërës të këtij krimi ishin: (1) një veprim (çfarë është bërë: rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave); (2) mjetet (si është bërë: me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërs, abuzimit me pushtetin ose pozitën së cenueshmërisë, ose dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër); (3) një qëllim shfrytëzues (pse u bë: kjo përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë e detyruar ose shërbime, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, shërbim të detyruar ose heqjen e organeve). Një kombinim i tre elementëve përbërës ishte i nevojshëm në mënyrë që të konstatohet krimi i trafikimit në lidhje me viktimat e rritura.

Në lidhje me këtë, nga këndvështrimi i Nenit 4, koncepti i trafikimit të qenieve njerëzore ka të bëjë me trafikimin kombëtar dhe ndërkombëtar të qenieve njerëzore, pavarësisht nëse është apo jo i lidhur me krimin e organizuar;

(iii) Nocioni i “punës së detyruar ose të detyrueshme” sipas Nenit 4 synonte të ofronte mbrojtje në rastet e shfrytëzimit serioz, siç është prostitucioni i detyruar, pavarësisht nëse, në rrethana të veçanta të një çështjeje, ato kishin të bënin me kontekstin specifik të trafikimit të qenieve njerëzore. Çdo sjellje e tillë mund të ketë elemente që e kualifikojnë atë si “skllavëri” ose “shërbim të detyruar” sipas Nenit 4, ose mund të ngrejë një çështje sipas një dispozite tjetër të Konventës. Në atë kontekst, “forca” mund të përfshijë format e zbutura të sjelljes shtrënguese të identifikuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës mbi Nenin 4, si dhe nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe në materiale të tjera ndërkombëtare;

(iv) Pyetja nëse një situatë e veçantë përfshinte të gjithë elementët përbërës të “trafikimit të qenieve njerëzore” dhe/ose nxiste një formë të veçantë të prostitucionit të detyruar ishte një pyetje faktike e cila duhet të shqyrtohet në dritën e të gjitha rrethanave përkatëse të një çështjeje.

Shtirja e detyrimeve pozitive të Shteteve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe prostitucionin e detyruar.

Natyra dhe qëllimi i detyrimeve pozitive në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe prostitucionin e detyruar sipas Nenit 4 u përcaktuan në mënyrë gjithëpërfshirëse në çështjen Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë: (1) detyra për të vendosur një

kornizë legjislativë dhe administrative për të ndaluar dhe ndëshkuar trafikimin; (2) detyrimi, në rrethana të caktuara, për të marrë masa operacionale për të mbrojtur viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit; dhe (3) një detyrimi procedural për të hetuar situatat e trafikimit të mundshëm. Në përgjithësi, dy aspektet e para të detyrimeve pozitive mund të shënohen si lëndore, ndërsa aspekti i tretë përcakton detyrimin procedural (pozitiv) të Shteteve. Për më tepër, duke pasur parasysh afërsinë konceptuale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe prostitucionit të detyruar sipas Nenit 4, parimet përkatëse në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore ishin në përputhje me rrethanat të zbatueshme në rastet në lidhje me prostitucionin e detyruar.

Detyrimet procedurale të shteteve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe prostitucionin e detyruar

Tradicionalisht, qysh nga çështja Siliadin kundër Francës, parimet konverguese të detyrimit procedural sipas Neneve 2 dhe 3 të Konventës informojnë përmbajtjen specifike të detyrimit procedural sipas Nenit 4. Nuk kishte arsye për t'iu rikthyer asaj qasjeje të mirë-vendosur. Për më tepër, këto parime ishin të zbatueshme në përputhje me rrethanat për rastet e prostitucionit të detyruar. Siç ka theksuar Gjykata në çështjen Siliadin, defektet e mundshme në procedimet përkatëse dhe procesin vendim-marrës duhej të shkaktonin në defekte të konsiderueshme për të ngritur një çështje sipas Nenit 4. Me fjalë të tjera, Gjykata nuk u mor me pretendimet për gabime ose mosveprime sporadike, por vetëm me mangësi të konsiderueshme, domethënë ato që ishin të afta të minonin aftësinë e hetimit për të vërtetuar rrethanat e çështjes ose personin përgjegjës.

Nëse rrethanat e çështjes në fjalë ishin bërë shkak për një çështje sipas Nenit 4 të Konventës.

Ndërsa kërkueses i ishte njohur administrativisht statusi i një viktime të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, kjo nuk mund të merrej si njohje se elementet e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore ishin realizuar. Kësaj pyetjeje duhej ti jepej përgjigje në procedimet pasuese penale. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu thekson domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të të dyshuarve ose të akuzuarve, veçanërisht të së drejtës për prezumimin e pafajësisë dhe garancitë e tjera të gjyqimit të drejtë sipas Nenit 6 të Konventës.

Nëse ankesa e një kërkuesi do të kishte qenë në thelb e një natyre procedurale si në çështjen në fjalë, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse, në rrethanat e një çështje të veçantë, kërkuesja kishte bërë një kërkesë të arsyetuar ose nëse kishte pasur prova

prima facie(commencement de preuve) që ajo i ishte nënshtruar një trajtimi të tillë të ndaluar. Në lidhje me këtë, një përfundim nëse kishte lindur detyrimi procedural i autoriteteve vendase duhej të bazohej në rrethanat mbizotëruese në kohën kur ishin bërë pretendimet përkatëse ose kur provat prima facie të trajtimit në kundërshtim me Nenin 4 ishin sjellë në vëmendjen e autoriteteve dhe jo në një përfundim të mëvonshëm të arritur pas përfundimit të hetimit ose procedimeve përkatëse. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë kur kishte pasur pretendime se përfundime të tilla dhe procedimet përkatëse të brendshme ishin dëmtuar nga të meta të rëndësishme procedurale.

Hetimi paraprak i policisë në lidhje me pretendimet e kërkuases për prostitucion të detyruar kishte çuar në një kontroll të mjediseve të TM dhe makinës së tij, gjatë së cilës policia kishte gjetur prezervativë, dy pushkë automatike dhe municione shoqëruese, një granatë dore dhe një numër celularësh. Për më tepër, ishte vërtetuar që T.M., i trajnuar si polic, ishte dënuar më parë për prokurimin e prostitucionit duke përdorur forcën dhe për përdhunime.

Lidhur me elementët përbërës të trafikimit të qenieve njerëzore, T.M. dyshohet se kishte kontaktuar kërkuesen përmes Facebook-ut dhe i kishte premtuar asaj punësim, e cila ishte një nga mënyrat e njohura të përdorura nga trafikantët për të rekrutuar viktimat e tyre. Pretendimet e kërkuases që T.M. kishte bërë rregullimet e nevojshme që ajo të ofronte shërbime seksuale duke siguruar strehim dhe lehtësira të tjera, sugjeroi elementet e strehimit, si një nga “veprimet” e mundshme të trafikimit. Për më tepër, në lidhje me mjetet e përdorura, T.M. kishte pranuar se kishte përdorur forcë ndaj saj në një rast dhe i kishte dhënë hua para, gjë që ngriti një çështje të skllavërisë së mundshme nëpërmjet borxhit. Situata personale e kërkuases padyshim sugjeronte që ajo i përkiste një grupi të prekshëm, ndërsa pozicioni dhe formimi i T.M. sugjeronin se ai kishte qenë në gjendje të merrte një pozitë dominuese ndaj saj dhe të abuzonte me cënueshmërinë e saj për qëllime të shfrytëzimit të prostitucionit.

Si përmbledhje, kërkuësja kishte ngriur një pretendim të arsyeshëm dhe kishte pasur prova prima facie se ajo i ishte nënshtruar një trajtimi në kundërshtim me Nenin 4, trafikimit të qenieve njerëzore dhe/ose prostitucionit të detyruar.

Pajtueshmëria me detyrimin procedural sipas Nenit 4

Ndërsa autoritetet e ndjekjes penale kishin reaguar menjëherë ndaj pretendimeve të kërkuases, ata nuk kishin arritur të ndiqnin disa linja të dukshme hetimi të afta për të sqaruar rrethanat e çështjes dhe për të vërtetuar natyrën e vërtetë të marrëdhënies midis të dy palëve. Megjithatë provat në dispozicion sugjeronin që T.M. kishin



përdorur Facebook-un për të rekrutuar kërkuesen dhe për ta kërcënuar atë pasi ajo e kishte lënë atë, autoritetet kishin dështuar të inspektonin llogaritë e tyre përkatëse për të përcaktuar natyrën reale të kontakteve dhe marrëdhënieve të tyre të para, veçanërisht nëse ato kërcënime sugjeronin përdorimin e një mjeti shtrëngues nga T.M. As nuk kishin dhënë ndonjë konsideratë për marrjen e provave nga prindërit e kërkueses, pavarësisht nga fakti që nëna e kërkueses kishte pasur kontakte dhe vështirësi të hershme me T.M., të cilat ky i fundit i kishte përdorur si një nga mjetet e presionit dhe kërcënimeve ndaj kërkueses. Autoritetet e ndjekjes penale nuk kishin identifikuar dhe intervistuar asnjë nga fqinjët dhe pronarin e banesës ku kërkuesi jetonte me T.M., të cilët mund të kishin dhënë informacion mbi marrëdhëniet midis kërkueses dhe T.M. dhe të sqaronin nëse ajo kishte qenë nën kontrollin e tij në kohën përkatëse. Për më tepër, pronari mund të kishte hedhur dritë mbi rrethanat në të cilat banesa ishte marrë me qira dhe kështu të sqarohej se kush kishte qenë në të vërtetë përgjegjës për të gjithë procesin e qirasë, i cili ishte i rëndësishëm për krijimin e veprimit të mundshëm të “strehimit” (një nga elementet përbërëse të trafikimit të qenieve njerëzore). As personat, të cilët mund të kishin dhënë detaje mbi arratisjen e pretenduar të kërkueses nga T.M., nuk ishin marrë në pyetje.

Autoritetet e ndjekjes penale ishin mbështetur shumë në deklaratën e kërkueses dhe kështu, në thelb, krijuan një situatë në procedurat gjyqësore pasuese, ku pretendimet e saj thjesht duhej të ngriheshin kundër mohimit të T.M., pa u paraqitur shumë prova të tjera. Në këtë kontekst, siç është vërejtur nga organet ndërkombëtare të ekspertëve, mund të ketë arsye të ndryshme pse viktimat e trafikimit njerëzor dhe forma të ndryshme të abuzimit seksual mund të hezitojnë të bashkëpunojnë me autoritetet dhe të zbulojnë të gjitha detajet e çështjes. Për më tepër, duhej të merrej parasysh ndikimi i mundshëm i traumës psikologjike. Ekzistonte kështu rreziku i mbivlerësimit të vetëm dëshmisë së viktimës, e cila çoi në nevojën për të sqaruar dhe, nëse është e përshtatshme, mbështetur deklaratën e viktimës me prova të tjera.

Mangësitë e shumta në menaxhimin e çështjes nga autoritetet e ndjekjes penale kishin dëmtuar rrënjësisht aftësinë e autoriteteve të vendit, duke përfshirë gjykatat përkatëse, për të përcaktuar natyrën e vërtetë të marrëdhënies së kërkueses dhe T.M. dhe nëse kërkuesja ishte shfrytëzuar nga ai siç kishte pohuar ajo. Si përmbledhje, kishte pasur të meta të konsiderueshme në përgjigjen procedurale të autoriteteve vendase ndaj pretendimit të argumentuar dhe provave prima facie që kërkuesja i ishte nënshtruar trajtimit në kundërshtim me Nenin 4.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 5 000 Euro për dëmin jo-financiar.

(Po ashtu shihni në lidhje me Nenet 2 dhe 3: Makaratzis kundër Greqisë [DHM], [50385/99](#), 20 dhjetor 2004, [Shënim Informativ 70](#); Nachova dhe të Tjerë kundër Bullgarisë [DHM], [43577/98](#) dhe [43579/98](#), 6 korrik 2005, [Shënim Informativ 77](#); Beganović kundër Kroacisë, [46423/06](#), 25 qershor 2009, [Shënim Informativ 120](#); Denis Vasilyev kundër Rusisë, [32704/04](#), 17 dhjetor 2009, [Shënim Informativ 125](#); Hassan kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], [29750/09](#), 16 shtator 2014, [Shënim Informativ 177](#); Mocanu dhe të Tjerë kundër Rumanisë [DHM], [10865/09](#) dhe al., 17 shtator 2014, [Shënim Informativ 177](#); Bouyid kundër Belgjikës [DHM], [23380/09](#), 28 shtator 2015, [Shënim Informativ 188](#); Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], [5878/08](#), 30 mars 2016, [Shënim Informativ 194](#); Hovhannisyan kundër Armenisë, [18419/13](#), 19 korrik 2011, [Shënim Informativ 220](#); në lidhje me Nenin 4: Siliadin kundër France, [73316/01](#), 26 korrik 2005, [Shënim Informativ 77](#); Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë, [25965/04](#), 7 janar 2010, [Shënim Informativ 126](#); M. dhe të Tjerë kundër Italisë dhe Bullgarisë, [40020/03](#), 31 korrik 2012, [Shënim Informativ 154](#); C.N. kundër the Mbretërisë së Bashkuar, [4239/08](#), 13 nëntor 2012, [Shënim Informativ 157](#); L.E. kundër Greqisë, [71545/12](#), 21 janar 2016, [Shënim Informativ 192](#); J. dhe të Tjerë kundër Austrisë, [58216/12](#), 17 janar 2017, [Shënim Informativ 203](#); Chowdury dhe të Tjerë kundër Greqisë, [21884/15](#), 30 mars 2017, [Shënim Informativ 205](#); dhe në lidhje me Nenin 6: Schatschaschwili kundër Gjermanisë [DHM], [9154/10](#), 15 dhjetor 2015, [Shënim Informativ 191](#); [Konventa e ILO-s për Punën e Detyruar, 1930 \(Nr. 29\)](#))

## II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

*Arsovski*, A. nr.30206/06, aktgjykim nga data 7 shkurt 2019

### **Neni 1 Protokollit nr. 1, Neni 41 – dëmi material**

**Fakte** – Tre shtetas maqedonas – z. Stojko Arsovski, z. Stefan Arsovski dhe znj. Verka Arsovska paraqitën aplikacion në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ /Gjykata) për pretendimin e shkeljes së nenit 1 të Protokollit numër 1 nga Konventa për atë se shteti i paditur, me shpronësimin e parcelës në dobi të një kompanie private, aplikantët i ka privuar nga gëzimi paqësor i pasurisë së tyre, dhe për këtë u formua lënda Arsovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut (A.nr.30206/06).

Më 15 janar të vitit 2013, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ /Gjykata) nxori aktgjykim në të cilin përcaktoi shkelje të së drejtës së pronësisë së aplikantëve të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ /Konventa) meqë edhe pse bëhet fjalë për tokë me interes publik, shteti me shpronësimin e plotë të tokës e cila ka qenë në pronësi të aplikantëve u ka shkaktuar barrë të tepruar dhe i ka privuar nga gëzimi paqësor i pasurisë së tyre, në dobi të kompanisë private SHA S. nga Kratova me arsyetimin se ka qenë në interes publik. U është shkaktuar shkelje duke e pasur parasysh faktin se në këtë çështje nuk është dhënë arsyetimi pse është zbatuar shpronësimi i plotë, në vend të shpronësimit jo të plotë, ndërsa edhe kompensimi i paluajtshmërisë së shpronësuar të cilin gjykata vendore ua ka ndarë aplikantëve, nga Gjykata ndërkombëtare është vlerësuar si i pamjaftueshëm. Me fjalë të tjera, në bazë të çmimit të caktuar të tregut të tokës, nga ana e ekspertit ligjor, gjykata vendore ka përcaktuar shumë të përgjithshme për kompensimin e tokës e cila ka qenë objekt i shpronësimit në lartësi prej 54.560,00 denarë, ndërsa me vendimin e njëjtë ish-pronarët u ngarkuan që shfrytëzuesit të paluajtshmërisë – SHA S., t’ia kompensojnë shpenzimet në lartësi prej 29.500 denarë. Njëherësh, me shkelen e konstatuar, GJEDNJ me Aktgjykimin nga viti 2013 përcaktoi një shumë për kompensimin e dëmit jomaterial e cila në kohë të duhur iu pagua aplikantëve, ndërsa çështjen për kompensimin e dëmit material e rezervoi për vendimarrjen plotësuese me konstatimin se kjo çështje nuk është “e maturuar” për vendimarrje.

**E drejta** – sipas rregullave procedurale të GJEDNJ, madje ashtu siç e përcakton edhe vet aktgjykimi nga viti 2013, sa i përket shumës së dëmit material i cili rezulton nga

shkelja e konstatuar të së drejtës së pronësisë së aplikantëve, u dha mundësia për ujdi ndërmjet Qeverisë nga njëra anë dhe aplikantëve nga ana tjetër, megjithatë duke i pasur parasysh rrethanat specifike në rastin konkret, ndërsa në mungesë të ujdise, GJEDNJ më datë 7 shkurt 2019 nxori aktgjykim me të cilin e përcaktoi shumën e dëmit material, me atë që e ngarkoi shtetin që aplikantëve t’u paguajë një shumë të përgjithshme prej 15.000 euro.

Sa i përket mundësisë së restitutio in integrum, si çështje kontestuese ndërmjet palëve lidhur me atë se a mundet toka t’u kthehet në pronësi aplikantëve. Gjykata vlerësoi se në këtë rast nuk mund të veprohet në bazë të parimeve të restitutio in integrum dhe kërkesën e aplikantëve për kthimin e tokës në pronësi të tyre e hodhi poshtë.

GJEDNJ mori qëndrim se nuk kanë ekzistuar baza mbi të cilat aplikantët mund të kërkojnë kompensim të dëmit për humbjen e gëzimit të së drejtës mbi tokën nga momenti i shpronësimit.

Sa i përket fitimit të humbur, aplikantët kanë kërkuar 14% nga profiti të cilin koncesioneri e ka realizuar nga shitja e ujit mineral të eksploatuar nga toka si dhe qiranë e humbur të cilën do të kishin mundësi ta realizojnë.

Në lidhje me kërkesën e parë, Gjykata vuri në dukje se nuk i janë paraqitur kurrfarë shembuj nga e drejta dhe praktika vendore ose ndonjë material tjetër relevant, i cili do të dëshmojë se pronarët – persona privatë e kanë këtë të drejtë dhe se nuk janë paraqitur prova të këtilla as sa i përket përqindjes konkrete nga profiti i kërkuar.

Në lidhje me qiranë e humbur, aplikantët iu referuan shpalljes publike për qira të bufesë në objektin e Gjykatës në Shkup. Gjykata është e mendimit se të dy pronat për nga natyra janë të ndryshme dhe se kontratat e qirasë nuk mund të krahasohen.

Për më shumë, Gjykata konsideron se “situata më e përafërt e mundshme nga ajo që do të ekzistonte nëse në këtë rast nuk shkactohej shkelja” do të ishte vetëm pagesa e një kompensimi të caktuar i cili duhej të përcaktohet në kohën e shpronësimit. GJEDNJ në lidhje me shumën e përcaktuar të aplikantëve përsëriti se autoritetet vendore nuk e kanë marrë parasysh ekzistimin e ujit mineral gjatë përcaktimit të kompensimit të shpronësimit.

Gjykata vuri në dukje se aplikantët nuk kanë paraqitur akt-ekspertizë për tokën me të cilën do të merrej parasysh ekzistimi i ujit mineral gjatë përlllogaritjes së vlerës së saj. Ata iu referuan eVau shitjes të një toke përafërsisht të ngjashme në Serbi dhe kanë konstatuar se bëhet fjalë për tokë në një shtet tjetër dhe në mungesë të

informacioneve për madhësinë dhe natyrën e tokës, si dhe për epilogun e shitjes në fjalë, referimi në këtë shembull ka qenë joadekuat.

GJEDNJ erdhi në përfundim se dokumentet e paraqitura nga Qeveria po ashtu nuk kanë qenë të mjaftueshme që GJEDNJ të mbështetet në të njëjtat, meqë kishin të bëjnë vetëm me një shembull nga praktika vendore edhe pse i ngjashëm me rastin e aplikantëve.

**Konkluzion:** Neni 41 – GJEDNJ kompensimin e përcaktoi mbi parimin e drejtësisë dhe mbi këtë bazë, u përcaktoi aplikantëve shumën kuturu prej 15, 000 euro.

**Ziberi**, A.nr.2166/15, aktgjykim nga data 6 qershor 2019

### **Neni 6 paragrafi 1 dhe 3 (g) – e drejta e procedurës së drejtë**

Aplikantit nuk i është mundësuar t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit të munguar, dëshmia e të cilit ka qenë provë vendimtare për dënimin e aplikantit

**Fakte** – Aplikanti u ankua për shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të ndershëm në procedurën penale kundër tij në të cilën është akuzuar për vrasje dhe tentativë për vrasje. Ai ka pohuar se të gjitha provat inkriminuese burojnë vetëm nga një dëshmitar, (shtetas i huaj), më saktësisht deklarata e tij, identifikimi nga ana e tij të aplikantit nga fotografitë e prezantuara nga policia dhe identifikimi përmes smotrës; se këto prova janë siguruar në procedurën hetimore dhe pa prezencën e përfaqësuesit të aplikantit, ndërsa dëshmitari nuk është siguruar në mënyrë plotësuese dhe nuk është marrë në pyetje gjatë gjykimit; dhe se provat e tjera nuk e kanë lidhur aplikantin me veprën penale. Veç tjerash, aplikanti ka pohuar se gjykatat medoemos është dashur ta sigurojnë prezencën e dëshmitarit gjatë procesit të gjykimit.

**E drejta** – GJEDNJ erdhi në përfundim se gjykatat vendore kanë bërë disa tentativa që ta thërrasin dëshmitarin përmes mjeteve diplomatike, por pa sukses. Megjithatë, meqë këto tentativa ishin të pasuksesshme, gjykatat vendore është dashur të kërkojnë ndihmë ndërkombëtare juridike dhe të kërkojnë që dëshmitari të merret në pyetje para gjykatave në Shqipëri (aty ku dëshmitari ka pasur vendbanim për të cilin kanë qenë në dijeni gjykatat vendore), me qëllim që t'i mundësohet palës mbrojtëse t'i parashtrojë pyetje përmes video-linkut.

Pastaj, meqë adresa e dëshmitarit ka qenë e njohur dhe së paku një thirrje është pranuar në atë adresë, ndërsa disa janë pranuar me vonesë, pas caktimit të seancave

gjyqësore, GJEDNJ vuri në dukje se është e paqartë përse gjykatat vendore nuk kanë ndërmarrë asgjë në lidhje me këtë, përkatësisht nuk kanë lejuar më shumë kohë ndërmjet seancave gjyqësore, siç ishte propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në mënyrë që dëshmitari t'i pranojë thirrjet në mënyrë të rregullt dhe në kohë të duhur.

Gjykatat vendore aktgjykimin dënues e bazuan edhe në këqyrjen aty për aty, megjithatë GJEDNJ erdhi në përfundim se mbetet e paqartë se si këqyrja fare nuk e ndërlihd aplikantin me veprat për të cilat është dënuar.

Gjykata veç tjerash përcaktoi se nuk ka pasur indicje se avokati i aplikantit është paralajmëruar se dëshmitari është shtetas i huaj dhe se ishin të mundshme vështirësitë në lidhje me seancën dëgjimore pas procedurës hetimore. Sipas kësaj, Gjykata konsideron se avokati i aplikantit edhe pse nuk e ka shfrytëzuar mundësinë e marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë hetimit, kjo nuk mund të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e marrjes në pyetje të dëshmitarit.

Për këto shkaqe, GJEDNJ konsideron se gjykatat vendore nuk kanë dhënë arsye mjaftueshëm të justifikuara pse nuk e kanë siguruar prezencën e dëshmitarit gjatë gjykimit, veçanërisht për faktin se ai ka qenë dëshmitari i vetëm okular ndërsa aktgjykimi është bazuar vetëm mbi deklaratimet e tij dhe në identifikimin nga ana e tij të aplikantit si kryerës i veprës penale, e cila i vihet në barrë.

### **Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 2.400 euro për dëm jomaterial dhe 1.250 euro për kompensim të shpenzimeve (Shih edhe *Schatschaschwili* kundër Gjermanisë, A Nr. 9154/10, aktgjykim nga data 15.12.2015 [DHM]; *Asani*, A.nr. 27962/10, aktgjykim nga data 01.05.2018, *Dushko Ivanovski*, A.nr. 10718/05, aktgjykim nga data 24.07.2014; *Iljazi*, A. nr. 56539/08, aktgjykim nga data 03.01.2014, *Panadakis*, A. nr. 50254/07, aktgjykim nga data 26.05.2013, *Smičkovski*, A.nr. 15477/14, aktgjykim nga data 05.07.2018; *Tramnevski*, A.nr. 4570/07, aktgjykim nga data 10.10.2012)

***Bileski kundër Maqedonisë së Veriut***, A.nr.78392/14, aktgjykim nga data 6 qershor 2019

### **Neni 6 paragrafi 1 – padrejtësi e plotë e procedurës së lustracionit**

Shkelja e të drejtës së gjykimit të drejtë në procedurën e lustracionit si tërësi, së këtejmi duke nxjerr konkluzion në bazë të disa aspekteve të veçanta të cilat ishin në

thelbin e pretendimeve të aplikantit për shkeljen e KEDNJ, duke i vlerësuar bashkërisht dhe në mënyrë kumulative

**Fakte** – aplikanti ka lindur në vitin 1951. Në vitin 2012 i ashtuquajtimi Komisioni për Lustracion e shpalli për bashkëpunëtor të ish-shërbimeve të sigurisë. Vendimi në mënyrë përkatëse në vitin 2012 dhe 2013, u konfirmua nga dy instancat e gjykatës administrative. Në vitin 2014, si pasojë e rezultatit të procedurës së lustracionit, aplikanti u shkarkua nga pozicioni i gjyqtarit nacional.

***E drejta***

## **Neni 6 paragrafi 1**

### ***Pranueshmëria***

I papranueshëm është pretendimi i aplikantit për shkeljen e KEDNJ për shkak të pretendimit për qasje të kufizuar në dokumentet e ish-shërbimit të sigurisë të cilat janë përdorur në procedurën e lustracionit, në këtë mënyrë duke e marrë në konsideratë kundërshtimin e Qeverisë i cili bazohej në mos shfrytëzimin e mjeteve juridike vendore.

GJEDNJ e shpalli të vonuar dhe për këtë shkak e shpalli të papranueshëm edhe pretendimin e aplikantit për shkeljen e KEDNJ për pretendimin e paanshmërisë së Këshillit Gjyqësor gjatë vendimmarrjes për ndërprerjen e funksionit të aplikantit si gjyqtar sipas vendimit të lustracionit.

***Bazueshmëria***

#### **a) aplikanti nuk ka mundur në mënyrë efikase ta prezantojë rastin e tij**

Përkatësisht, GJEDNJ, konstatoi se aplikanti nuk është përfshirë në procedurën para Komisionit kompetent, ndërsa gjykatat administrative vendimet e tyre i kanë bazuar kryesisht mbi dokumentacionin me shkrim dhe kryesisht në bazë të provave të cilat i vihen në barrë aplikantit; gjatë kësaj nuk i kanë marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar nga aplikanti V.P. dhe P.K. pa dhënë justifikime të mjaftueshme për një gjë të këtillë, ndërsa në kushte veçanërisht specifike, por pa kufizime në lidhje me atë se deklarata me shkrim e P.K. e cila mesa duket ka qenë në favor të aplikantit, gjykatat vendore po ashtu, pa arsyetim, kanë vendosur të mos e marrin në konsideratë. Rrethanat e këtilla, GJEDNJ konkludoi se kanë qenë vendimtare për të drejtën e aplikantit në mënyrë efikase ta prezantoj lëndën e tij.

## **b) aplikantit i është shkelur e drejta për seancë verbale**

GJEDNJ konstatoi mungesë të seancës verbale në kushte kur aplikanti shprehimisht ka kërkuar të mbahet seancë verbale në procedurat para gjykatave administrative. Në dritën e rrethanave të cilat e kanë vënë në dukje gjendjen kontestuese faktike dhe juridike, GJEDNJ nuk përcaktoi ekzistim të rrethanave specifike të cilat do ta justifikonin mungesën e seancës verbale në rrethanat e rastit konkret.

## **c) se në këtë rast ekziston shkelje të së drejtës së arsyetimit të aktgjykimit gjyqësor**

GJEDNJ konkludoi se autoritetet vendore nuk u kanë dhënë përgjigje përkatëse pretendimeve dhe provave të paraqitura nga aplikanti në lidhje me atë se bashkëpunimi i pretenduar nuk i ka kënaqur kriteret kualitative të Ligjit për lustracion.

## **Neni 8 dhe neni 13**

Aplikanti në procedurën para GJEDNJ u ankua edhe për shkeljen e nenit 8 të KEDNJ për shkak të përdorimit të dosjeve nga ish-shërbimet e sigurisë në procedurën e lustracionit dhe pamundësinë në mënyrë efikase t'i kontestoj pretendimet e institucioneve kompetente vendore. Aplikanti u ankua edhe për shkeljen e nenit 13 të KEDNJ i cili e garanton të drejtën e mjetit efikas juridik vendor.

Megjithatë, GJEDNJ erdhi në përfundim se në dritën e konkluzioneve të veta për shkeljen e nenit 6 të KEDNJ, nuk ekzistojnë arsye të cilat do ta justifikonin shqyrtimin e veçantë të pretendimeve për shkeljen e nenit 8 dhe nenit 13 të KEDNJ.

**Konkluzion:** shkelja e nenit 6 paragrafit 1 (njëzëri)

Neni 41: 2.400 euro për dëm jomaterial dhe 300 euro për shpenzime

(Shih dhe *Ivanovski*, A.nr. 29908/11, aktgjykim nga data 21.01.2016; *Karajanov*, A/nr. 2229/15, aktgjykim nga data 06.04.2017)

**ASP PP SHPKNJ**, A.nr.66313/14, aktgjykim nga data 6 qershor 2019

Neni 6 paragrafi 1 – gjykim i drejt, procedurë civile

Lëshim i gjykatave vendore të japin arsyetim për motivet për shkak të të cilave në rastin e kompanisë aplikante është vendosur në kundërshtim me praktikën ekzistuese gjyqësore vendore



**Fakte** – Kompania – aplikante u ankua se në procedurën që e ka ngritur për përcaktimin e anulimit të pjesshëm të dispozitave nga Kontrata për aprovimin e kredisë nga fondi kompensues me ndihmë të jashtme – Japoni, të lidhur ndërmjet kompanisë – aplikante dhe Ministrisë së Financave, i është shkelur e drejta për gjykim të ndershëm të parashikuar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, meqë me vendimin e Gjykatës Themelore Ohër, e cila pastaj është shkelur edhe nga Gjykata e Apelit Manastir, të miratuara në rastin e kompanisë aplikante, është devijuar nga praktika e vendosur e institucioneve vendore për lëndë të ngjashme, pa u respektuar detyrimi të cilin e përcakton neni 6 i KEDNJ, të jepet arsyetim për devijimin e këtillë.

**E drejta** – GJEDNJ nga provat që janë paraqitur konstatoi se në praktikën vendore gjyqësore është marrë qëndrim, përfshirë këtu edhe vendimet e Gjykatës Supreme, i cili është aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, kur kërkesa është shprehur ose përcaktuar në valutë të huaj ose kundërvlera e saj është përcaktuar sipas kursit të asaj valute në ditën e pagesës, kamata të përcaktohet sipas lartësisë së kamatës domicile të asaj valute. GJEDNJ erdhi në përfundim se në rastin konkret, konform Aneksit të kontratës, në rastin e aplikantit është parashikuar se detyrimet e pa arkëtuara po ashtu përllogariten në valutë të huaj. Megjithatë gjykatat vendore në këtë rast kanë pasur qëndrim të ndryshëm.

**Konkluzion:** Neni 6 paragrafi 1 – shkelje (njëzëri); Neni 1 Protokollit nr. 1 (e drejta e pronësisë) – në dritën e shkeljes së konstatuar, GJEDNJ erdhi në përfundim se nuk ka nevojë t'i shqyrtojë pretendimet për shkeljen e Nenit 1 të Protokollit nr. 1

Neni 41: 2.400 euro për dëm jo materiale dhe 1.390 euro për kompensim të shpenzimeve

(Shih dhe *Atanasovski*, A.nr. 36815/03, aktgjykim nga data 14.01.2010)

### **Atanasov, A.nr.46082/14, aktgjykim nga data 26 shtator 2019**

#### **Neni 1 i Protokollit numër 1 – e drejta e pronësisë, gëzimi paqësor i pronësisë**

Sekuestrimi i automjetit në kontekstin e procedurës për kundërvajtje edhe kundrejt plotësimit të afatit të parashkrimit

**Fakte** - Më 31 janar 2008 gjatë tentativës me automobil të dalë jashtë shtetit, nga doganierët u konstatua se aplikanti ka bërë kundërvajtje doganore. Komisioni për vendimmarrje në lidhje me kundërvajtjen doganore konstatoi se gjatë muajit qershor

të vitit 2006, aplikanti e ka importuar automobilin në fjalë (të blerë në Gjermani) në zonën doganore të territorit të Maqedonisë së Veriut, megjithatë nuk e ka paraqitur për kontroll tek autoritetet kompetente doganore në mënyrë të përcaktuar, përkatësisht aplikanti nuk i ka zbatuar procedurat përkatëse doganore dhe nuk i ka paguar detyrimet e nevojshme për importin e automobilin në fjalë. Për shkak të kundërvajtjes së kryer, u mor vendimi me të cilin aplikantit i është shqiptuar gjobë, si dhe sekuestrim të përkohshëm të automjetit me të cilin është kryer kundërvajtja. Aplikanti këtë vendim e ka kundërshtuar para gjykatave administrative vendore të shkallës së parë dhe të dytë, dhe pas kësaj vendimi është anuluar për shkak të plotësimit absolut të afatit të parashkrimit, megjithatë automjeti në fjalë nuk i është kthyer.

**E drejta** – GJEDNJ në rastin konkret konstatoi shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 nga Konventa meqë sekuestrimi i detyrueshëm i automjetit (përfundimisht gjykata vendore gjatë vendimmarrjes për sekuestrim i është referuar Nenit 101 – a të Kodit Penal) të aplikantit bashkë me mungesën e mundësisë reale për kompensimin e humbjes së tij paraqet barrë të tepërt për aplikantin, duke e pasur parasysh proporcionalitetin midis mjeteve të cilat përdoren për ruajtjen e interesit të përgjithshëm, nga njëra anë, dhe mbrojtjen e të drejtës themelore të kundërvajtësit për respektimin e pronës së tij, nga ana tjetër.

Neni 41: 1.500 euro

**Jakimovski dhe Kari transport**, A.nr.51599/11, aktgjykim nga data 14 nëntor 2019

### **Neni 1 i Protokollit nr. 1 – e drejta e pronësisë**

Sekuestrimi i automjetit për transport në procedurë kundërvajtëse, si sanksion plotësues: shkelje

**Fakte** – Më 8 mars të vitit 2008 aplikanti i parë (Jakimovski) duke e drejtuar kamionin e ngarkuar ka hyrë në shtet në pikën e kalimit kufitar Novo Sellë, kamionin e kanë matur autoritetet doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe aplikanti është larguar nga terminali doganor. Vulat e plumbit të vendosura në kamion nga autoritetet bullgare kanë qenë të padëmtuara, kur inspeksioni i autoritetit doganor në Manastir më 10 mars, të vitit 2008, ka e ka kryer kontrollin e kamionit. Nga nëpunësit doganorë, ndërsa pastaj edhe nga Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje

doganore është konstatuar se aplikanti ka kryer kundërvajtje doganore meqë deklarata doganore nuk është regjistruar në zyrën doganore Novo Sellë, përkatësisht se malli i cili është transportuar nuk është paraqitur në mënyrë të rregullt për inspektim. Për këtë shkak, i është shqiptuar dënim në para në shumë prej 1500 euro, sekuestrim të mallit (si masë e detyrueshme dhe e veçantë për kundërvajtje) dhe sekuestrim të kamionit (si masë mbrojtëse). Aplikanti pastaj ka ngritur kontest administrativ për të cilin Gjykata Administrative i ka marrë në konsideratë kërkesat e tij dhe ka marrë vendim për përsëritjen e procedurës, ndërsa në procedurën e përsëritur Komisioni përsëri ka konstatuar kundërvajtje të kryer doganore dhe ka nxjerrë vendim identik si edhe gjatë vendimit të parë. Pas ankesës së paraqitur nga ana e aplikantit, më datë 2.2.2010 Gjykata Administrative nxori vendim me të cilin e ka hedhur poshtë ankesën dhe i ka pranuar gjetjet e Komisionit, i cili u konfirmua më datë 22.11.2010 me aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

**E drejta** – GJEDNJ gjatë vendimmarrjes për lëndën konkrete e vlerësoi procedimin e autoriteteve vendore, përkatësisht sekuestrimin e kamionit në bazë të tekstit standard i cili i përfshinë kriteret e ligjshmërisë, realizimit të qëllimit legjitim dhe proporcionalitetin gjatë procedimit.

a) ligjshmëria

Gjykata erdhi në përfundim se sekuestrimi i kamionit, përkatësisht ndërhyrja në pronësinë e aplikantit ka qenë e ligjshme meqë është parashikuar me Ligjin e doganave.

b) qëllimi legjitim

Gjykata, po ashtu, pranoi se sekuestrimi i kamionit ka pasur qëllim legjitim të pengohet kontrabanda e mallit dhe shpërdorimi i sistemit doganor, ndërsa me këtë të mbrohet interesi i përgjithshëm.

c) proporcionaliteti

Në vlerësimin e proporcionalitetit të sekuestrimit të kamionit, si masë kontestuese, Gjykata erdhi në përfundim se sekuestrimi nuk ka qenë i detyrueshëm, meqë autoritetet vendore është dashur t'i përkushtojnë vëmendje më të madhe sjelljes së aplikantit, përkatësisht pronarit të automjetit dhe rrethanave të rastit. Në këtë kuptim, Gjykata erdhi në përfundim se autoritetet vendore gjatë vendimmarrjes nuk e kanë marrë mjaftueshëm parasysh lidhjen midis sjelljes së aplikantit dhe kundërvajtjes, përkatësisht faktin se kamioni ka hyrë në pikën e kalimit kufitar zyrtar dhe në mënyrë përkatëse i është paraqitur inspeksionit pranë shërbimeve doganore

me vula plumbi të padëmtuara (edhe pse një gjë e këtillë ishte marrë parasysh, por vetëm gjatë matjes së dënimit), si dhe fakti se kamioni i sekuestruar ka qenë burim i vetëm i të ardhurave për aplikantin dhe familjen e tij. Gjykata, mes tjerash, thekson se nuk janë marrë parasysh faktet se malli nuk ka qenë jolegal, e që nuk është konstatuar se kamioni është adaptuar për qëllime të kontrabandës, e as që se ka pasur prova për incidente të ngjashme paraprake të shkaktuara nga aplikantët që të pengohet përdorimi i automjetit për kryerjen e kundërvajtjeve të ngjashme.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, Gjykata konsideron se edhe pse masa është përcaktuar me ligj, autoritetet vendore është dashur që vëmendje më të madhe t'i përkushtojnë rrethanave në të cilat është kryer kundërvajtja. Sipas Gjykatës, fakti që aplikanti është dënuar me para dhe i është sekuestruar malli të cilin e ka transportuar do të ishin të mjaftueshme që ta arrijnë efektin e dëshiruar për parandalimin dhe mbrojtjen e shkeljeve të ardhshme të legjislacionit vendor. Sipas Gjykatës, sekuestrimi i kamionit, si sanksion plotësues i dedikuar për parandalimin e kundërvajtjeve të ngjashme, nuk korrespondon me seriozitetin e kundërvajtjes, dhe prandaj ka qenë joproporcional dhe ka shkaktuar barrë të tepruar mbi aplikantët.

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: Gjykata e ngarkoi shtetin në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e të njëjtit tua kthej kamionin e sekuestruar aplikantëve në gjendjen ashtu siç ka qenë kur ia kanë sekuestruar. Nëse një gjë e këtillë nuk është e mundshme, atëherë në afatin e njëjtë duhet t'u paguhet shuma prej 13.000 euro si dëm material. Gjykata e ngarkoi shtetin që aplikantëve t'u paguaj edhe një shumë prej 14.500 euro në emër të dëmit material si përgjigje ndaj kërkesës për kamatë ligjore të vlerës së kamionit. Gjykata, po ashtu, e përcaktoi shumën prej 3.000 euro për dëm jomaterial dhe 925 euro për shpenzime.

**Romeva kundër Maqedonisë së Veriut**, A.nr.32141/10, aktgjykim nga data 12 dhjetor 2019

**Neni 1 i Protokollit nr. 1 – e drejta e pronësisë, gëzimi paqësor i pronësisë**

Aplikantja vazhdimisht është privuar nga pensioni të cilin e ka marrë nga viti 2000 për shkak të gabimit të zbuluar gjatë vlerësimit se a i ka plotësuar ajo kushtet për pension

**Fakte** – Aplikantja e lindur në vitin 1947, para fakteve kontestuese të cilat e kanë privuar nga e drejta e pensionit, ka pranuar kompensim në rast të papunësisë të cilin ia kanë ndërprerë pas pranimi të së drejtës së pensionit. Me fjalë të tjera, aplikantja në vitin 2000, pasi që e kanë thirr në Agjencinë për Punësim, ka paraqitur kërkesë për realizimin e të drejtës së pensionit. Në vendimin e tij Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi) ka konstatuar se aplikantja e ka plotësuar kushtin e atëhershëm për pensionim prej minimum 35 vjet stazh pune.

Në periudhën e vendimmarrjes, Fondi i ka mbledhur, ruajtur dhe përpunuar informacionet në lidhje me punësimet.

Megjithatë, në bazë të revizionit të brendshëm të Fondit, në vitin 2007, mes tjerash, është konstatuar se dokumentet e aplikantes nuk kanë qenë të plota, përkatësisht ka munguar librezat e saj e punës. Meqë nuk janë siguruar prova plotësuese në lidhje me marrëdhënien e punës së aplikantes për periudhën kohore nga viti 1963 deri në vitin 1967, Fondi ka konstatuar se aplikantja nuk ka qenë e punësuar në periudhën në fjalë dhe prandaj nuk e plotëson kushtin e pensionit prej minimum 35 vjet stazh pune. Për këtë shkak, në vitin 2007 Fondi sipas detyrës zyrtare e anuloi vendimin nga viti 2000 dhe në mënyrë retroaktive e ka refuzuar kërkesën e aplikantes për pension. Pas kësaj ajo nuk ka pranuar pension.

Aplikantja është ankuar se në rastin e saj ka pasur zbatim retroaktiv të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ndërsa gjatë procedurës në të cilën është konstatuar se të dhënat në bazë të të cilave fillimisht i është pranuar e drejta e pensionit nuk kanë qenë të sakta dhe autentike, ajo pohon se nuk ka pasur ndikim mbi të dhënat në bazë të të cilave Fondi fillimisht ia ka pranuar të drejtën e pensionit. Megjithatë, procedura përfundoi me vendim të Gjykatës Supreme nga viti 2010 e cila ka ardhur në përfundim se vendimi i kundërshtuar i Fondit nga viti 2000 ka qenë i ligjshëm.

Në vitin 2012 Fondi ngriti kallëzim penal kundër aplikantes me pretendime për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara në procedurën para Fondit, megjithatë procedura u ndërpre për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit.

Në ndërkohë në vitin 2008, Fondi ngriti padi kundër aplikantes me kërkesë për kthimin e shumës së paguar në total në periudhën kohore nga viti 2000 deri në vitin 2007 për shkak të fitimit të pabazë. Gjykata Themelore Civile e mori në konsideratë kërkesën e këtillë ndërsa aktgjykimi u bë i plotfuqishëm në vitin 2014 dhe i njëjti është dhënë në ekzekutim. Aplikantja ka ngritur edhe kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme e cila është refuzuar me vendim nga viti 2015.

**E drejta** – GJEDNJ gjatë vendimmarrjes për lëndën konkrete e vlerësoi procedimin e autoriteteve vendore, përkatësisht nëse refuzimi i kërkesës dhe heqja e pensionit të aplikantes, që paraqet ndërhyrje në të drejtën e pronësisë së aplikantes, ka qenë në bazë të kriterëve të ligjshmërisë, realizimit të qëllimit legjitim dhe proporcionalitetit gjatë procedimit (test standard).

Gjykata erdhi në përfundim se ndërhyrja në të drejtat pronësore të aplikantes, përkatësisht hapja e sërishme e procedurës përfundimisht të kryer ka qenë e ligjshme meqë e njëjta është parashikuar në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor dhe në Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative. Gjykata, gjithashtu, pranoi se rishikimi i procedurës ka ndodhur për shkak të gabimit të konstatuar nga ana e Fondit gjatë vlerësimit fillestar të kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit nga ana e aplikantes. Gjykata konsideron se privimi i aplikantes nga pensioni ka pasur qëllim legjitim të siguroj se mjetet publike nuk përdoren për subvencionim në kohë të pacaktuar, të përfituesve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme.

Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të heqjes së pensionit të aplikantes, Gjykata erdhi në përfundim se nuk ka pasur indice se aplikantja ka qenë përgjegjëse për vlerësimin e padrejtë fillestar të kërkesës së saj për përcaktimin e pensionit nga ana e Fondit. Më saktësisht, GJEDNJ erdhi në përfundim se përkundrazi, Fondi ka vepruar pa kujdes të mjaftueshëm për grumbullimin e drejtë dhe ruajtjen e të dhënave relevante në lidhje me aplikanten dhe përpunimin e kërkesës së saj fillestare, dhe që ka rezultuar me vendim të gabuar, të cilin Fondi më vonë u përpoq ta korrigjoj në shpenzim të aplikantes. Gjykata theksoi se autoritetet vendore nuk duhet të pengohen që t'i korrigjojnë gabimet, madje edhe ato të cilat rezultojnë nga pakujdesia e tyre, megjithatë gjatë korrigjimeve të këtilla nuk mund të kërkohej nga personi i prekur të ketë barrë më të madhe si rezultat të masës që ia heq tërësisht beneficionin, përkatësisht të drejtën e fituar. Me fjalë të tjera, nëse është bërë gabim nga autoritetet, pa kurrfarë faji të personit të tretë, duhet të ketë qasje të ndryshme të proporcionalitetit me të cilën do të përcaktohet nëse, në këtë rast, aplikantes do t'i vihet barrë e tepërt.

Në rastin konkret, Gjykata ka ardhur në përfundim se revokimi i aktvendimit për dhënien e pensionit aplikantes nuk është bazuar në prova të reja, por vetëm në rishikimin e të njëjtave në bazë të të cilave fillimisht i është njohur e drejta e pensionit, ndërsa ky rishikim i provave e vë në pikëpyetje sigurinë juridike në fushën e sigurimit social. Pastaj, Gjykata konkludoi se në rastin në fjalë nuk bëhet fjalë vetëm për anulimin e pensionit të aplikantes, por për heqjen e plotë të të drejtave të saj për pension, me ç'rast pensioni ka qenë burim i vetëm i saj i të ardhurave në një

periudhë të caktuar kohore. Për shkak të vendimit të këtyllë të autoriteteve vendore, aplikantja më shumë se dy vjet nuk ka pasur kurrfarë të ardhurash, ndërsa padia civile dhe procedura ekzekutive për kthimin e pensioneve të paguara, në masë të konsiderueshme e kanë përkeqësuar gjendjen e vështirë financiare të saj.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, Gjykata konsideron se barra që i është vënë aplikantes ka qenë tepër e madhe, me çka nuk është arritur balancim i drejt midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, dhe prandaj konstatoi shkelje të të drejtës së pronësisë të garantuar me Konventën.

Gjykata me aktgjykimin e vet e ngarkoi shtetin të siguroj se urdhër pagesa e lëshuar kundër aplikantes në procedurë ekzekutive të mos zbatohet.

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 6.000 euro për dëm jomaterial dhe për dëm potencial material.

*Sinadinovska*, A.nr.27881/06, aktgjykim nga data 16 janar 2020

### **Neni 6 paragrafi 1**

#### Zvarritje e paarsyeshme e tri procedurave vendore

**Fakti** – aplikantja e cila posedon shtëpi me hapësirë afariste të papërfunduar në qendër të Tetovës, ka zhvilluar procedura të ndryshme kundër dy fqinjëve S.B. dhe I.F., ndërsa disa nga procedurat janë zhvilluar edhe kundër komunës dhe shtetit, për shkak të shkeljes së të drejtës së pronësisë meqë fqinji i saj ka ndërtuar ndërtesë në parcelën pranë saj, ndërsa me ndërtimin, mes tjerash, ka përfshirë edhe një pjesë të parcelës së saj; mosekzekutim të aktvendimit për shembjen e objektit të cilin e ka ndërtuar S.B. i cili më vonë është legalizuar, ndërsa fqinji I.F. ka ndërtuar objekt (i cili me sa duket më vonë është legalizuar) për shkak të të cilit, ka pretendime se, i është pamundësuar hyrje-dalja në hapësirat e saj afariste dhe për këtë shkak e ka humbur fitimin.

Aplikantja u ankua se procedurat që i ka ngritur kundër fqinjëve janë zvarritur tej mase, ndërsa gjykatat vendore i kanë bazuar në shkaqe pamjaftueshëm të arsyetuara dhe për këtë shkak i është shkelur edhe e drejta e pronësisë së garantuar me Konventën.

Me fjalë të tjera, aplikantja u ankua se i është shkelur e drejta e gjykimin në afat të arsyeshëm nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës në: A) procedurën civile kundër

fqinjit S.B. për pengimin e zotërimit dhe për procedurën rrjedhëse të ekzekutimit, B) procedurën administrative të S.B. në lidhje me lejen e tij të ndërtimit në të cilën aplikantja ka qenë e përfshirë dhe C) procedurën civile kundër fqinjit I.F. shtetit dhe komunës në të cilën aplikantja ka kërkuar kompensim monetar për shkak të fitimit të humbur dhe vlerës së reduktuar të hapësirës së saj afariste deri te e cila pretendon se është e pamundur të hyhet nga rruga për shkak të objektit të ndërtuar të paligjshëm nga ana e I.F. dhe se shteti dhe komuna nuk kanë ndërmarrë asgjë që ta pengojnë një gjë të këtillë.

## ***E drejta***

### **E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm**

A) Sa i përket pjesës së pretendimeve ankimore për shkeljen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm në procedurë civile kundër S.B., GJEDNJ erdhi në përfundim se edhe pse Gjykata Supreme ka konstatuar kohëzgjatje të paarsyeshme (vetëm) të procedurës ekzekutive (ashtu siç ka kërkuar aplikantja) megjithatë ajo ka bërë lëshim ta zbatoj parimin e GJEDNJ në përputhje me të cilin kur bëhet fjalë për ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të miratuar në procedurë civile (ndërkaq kur pala duhet të iniciojë procedurë të posaçme ekzekutive), ekzekutimi duhet të konsiderohet si fazë e dytë e procedurës meritore dhe pjesë përbërëse e procedurës initiale (procedurës civile) (paragrafi 54 nga aktgjykimi). Së këtejmi, GJEDNJ erdhi në përfundim se procedura ka zgjatur 10 vjet e 5 muaj (nga paraqitja e padisë civile deri në vendimin e Gjykatës së Apelit me të cilin u konstatua se propozimi për ekzekutim është revokuar), dhe jo 6 vjet, 6 muaj e 7 ditë, siç ka konkluduar Gjykata Supreme. Duke e pasur parasysh atë se vendimi i Gjykatës Supreme sipas kërkesës për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm nga data 21.12.2010 është miratuar para vendimit të Gjykatës së Apelit me të cilin është konstatuar se propozimi për ekzekutim është revokuar (14.12.2012), GJEDNJ vuri në dukje se procedura për të cilën është konstatuar se ka zgjatur paarsyeshëm gjatë, duhet ta ruaj karakterin e këtillë edhe në rrjedhën e më tutjeshme, përkatësisht pas miratimit të vendimit të Gjykatës Supreme nga data 21.12.2010 (paragrafët 17,18 dhe 57 të aktgjykimit). Në periudhën aktuale në shtet nuk kishte mjet efikas juridik për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm (vendimi i GJEDNJ në rastin *Axhi Spirkovska etj.* me të cilin GJEDNJ e shpalli mjetin juridik vendor para Gjykatës Supreme si efikas dhe rrjedhimisht të miratuar, përkatësisht më 3 nëntor të vitit 2011), dhe për këtë shkak aplikantja nuk e ka pasur për obligim ta shfrytëzojë mjetin juridik vendor. Megjithatë, në kushte kur aplikantja e ka shfrytëzuar të njëjtin, GJEDNJ e merr parasysh vendimarrjen e Gjykatës Supreme.



B) Në lidhje me procedurën administrative në të cilën aplikantja ka qenë e përfshirë, Gjykata, po ashtu, konstatoi shkelje të së drejtës së kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurës, përkatësisht procedura e cila nuk ka qenë komplekse dhe e ndërlkuar ka zgjatur 4 vjet e 11 muaj. Në periudhën relevante në shtet nuk kishte mjet juridik efikas për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm.

C) GJEDNJ po ashtu erdhi në përfundim se aplikantes i është shkelur e drejta e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurës edhe në procedurën civile kundër fqinjit I.F., shtetit dhe komunës (shih veçanërisht paragrafët 70-73 të aktgjykimit). Shkelja e KEDNJ në lidhje me këtë procedurë është konstatuar në dritën e rrethanave sipas të cilave aplikantja gjatë rrjedhës së kohëzgjatjes së procedurës civile në fjalë dy herë është drejtuar me kërkesë për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm në Gjykatën Supreme. Herën e parë vendimi i Gjykatës Supreme me të cilin kërkesa e aplikantes për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm është hedhur poshtë është bërë i plotfuqishëm më datë 7.3.2011, përkatësisht para përfundimit të procedurës kontestuese civile e cila përfundoi me vendim të Gjykatës Supreme nga data 27 qershor të vitit 2013 dhe para shpalljes së mjetit juridik vendor për efikas me vendimin e rastit Axi Spirkovska. Megjithatë, GJEDNJ e vë në dukje se kur më datë 15.5.2012 Kolegji i shkallës së parë i Gjykatës Supreme e ka refuzuar kërkesën e dytë të aplikantes për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm, mjeti juridik vendor para Gjykatës Supreme në dritën e praktikës së GJEDNJ vlente si efikas. Gjatë vendimmarrjes për kërkesën e dytë, Gjykata Supreme në shkallë të dytë vlerësimin e vet e kufizoi në periudhën prej 2 vjet e 5 muaj kohëzgjatje të procedurës në fjalë, për të cilën ka konstatuar se nuk është e paarsyeshme, edhe pse njëkohësisht ka konstatuar se procedura e përgjithshme nga paraqitja e padisë civile deri në paraqitjen e kërkesës së dytë për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm ka zgjatur gjithsej 4 vjet. Qëndrimi i këtillë i Gjykatës Supreme ka rezultuar nga fakti se periudha initiale prej 1 viti e 5 muaj nga paraqitja e padisë civile tanimë ishte objekt i vlerësimit nga ana e Gjykatës Supreme kur ka vendosur për kërkesën e parë për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm të paraqitur nga aplikantja, me ç'rast Gjykata Supreme po ashtu nuk ka konstatuar kohëzgjatje të paarsyeshme të procedurës. Nga ana tjetër, GJEDNJ e ka marrë në konsideratë atë se në periudhën e vlerësimit nga ana e Gjykatës Supreme të kërkesës së dytë të aplikantes për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm, procedura civile ka qenë në rrjedhë e sipër para Gjykatës Supreme sipas kërkesës për revizion. Në këtë kontekst, GJEDNJ, veç tjerash, potencoi se procedura e kërkesës për revizion para Gjykatës Supreme ka

zgjatur 1 vit e 9 muaj, dhe e vlerësoi si prolongim të procedurës e që ka kontribuar në kohëzgjatjen e përgjithshme tej mase të së njëjtës (paragrafi 71 i aktgjykimit).

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

### **Pretendime në lidhje me vendime të pajustificuara gjyqësore**

Aplikantja në ankesën para GJEDNJ, veç tjerash, u ankua në kontekstin e Nenit 6 të KEDNJ se gjykatat vendore nuk kanë prezantuar shkaqe mjaftueshëm të justifikuara në lidhje me argumentet e saj për procedurat në vijim: A) procedura administrative e S. B. në lidhje me lejen e tij të ndërtimit në të cilën ka qenë e përfshirë edhe aplikantja dhe B) procedura civile kundër fqinjit I.F., shtetit dhe komunës.

Gjykata erdhi në përfundim se aplikimi në këtë pjesë është i pabazuar meqë procedura administrative e S.B. në lidhje me lejen e tij të ndërtimit nuk i referohet çështjes nëse aplikantja ka pësuar çfarëdo lloj dëmi ose nëse të drejtat e saj pronësore janë shkelur. Në dritën e faktit se çështja e devijimit gjatë ndërtimit nga ana e S.B. nga kushtet e lejes së ndërtimit janë shqyrtuar në procedurë të veçantë në të cilën është lëshuar urdhër për shembje, ndërsa në mënyrë plotësuese në procedurë të veçantë aplikantes i është përcaktuar kompensim për dëmin që e ka pësuar në bazë të ndërtimit të paligjshëm nga ana e S.B., GJEDNJ nuk gjeti mangësi në justifikimin e Gjykatës Administrative.

Në lidhje me pjesën e aplikimit për mungesën e arsyeve të justifikuara në procedurën civile kundër fqinjit I.F., shtetit dhe komunës GJEDNJ e vuri në dukje se pretendimet e aplikantes fillimisht kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit të legjislacionit vendor dhe vlerësimin e provave në procedurën vendore, që të dy elementët në parim të rezervuar për institucionet vendore, përveç rastit nëse vendimet vendore nuk janë arbitrare ose dukshëm të pabaza. Në dritën e konstatimit se vendimet vendore përmbajnë shkaqe të mjaftueshme, ndërsa vendimet me sa duket nuk janë arbitrare ose dukshëm të pabaza, GJEDNJ në pjesën përkatëse aplikimin e shpalli si *dukshëm të papranueshëm*.

**Konkluzion:** njëzëri

### **Neni 1 Protokolli nr. 1 (e drejta e pronësisë)**

Aplikantja është ankuar edhe për shkeljen e të drejtës së pronësisë, përkatësisht se për shkak të kohëzgjatjes së gjatë të procedurës për ekzekutimin e vendimeve kundër dy fqinjëve të saj, shteti i paditur nuk pati sukses ta mbrojë të drejtën e saj të pronësisë, njëherësh duke pësuar dëm material, si dhe fitimin e humbur për shkak të mospasjes së hyrje-daljes nga rruga deri te hapësira e saj afariste.

Në pjesën në të cilën aplikantja ankohej në lidhje me mosekzekutimin e vendimit kundër S.B., GJEDNJ erdhi në përfundim se shumica e kompensimit monetar që iu përcaktua nga gjykatat vendore në lidhje me shkeljen e kryer nga fqinji S.B. (ndërsa këtë lartësi aplikantja nuk e kontestoi), bashkë me njohjen eksplicite të shkeljes mjafton për shmangien e statusit të viktimës nga aplikantja në kontekstin e pretendimeve konkrete për shkeljen e KEDNJ.

Sa u përket pretendimeve në lidhje me ekzekutimin e urdhrit për shembje kundër fqinjit I.F., GJEDNJ erdhi në përfundim se në rrethanat specifike të rastit, aplikantja në procedurën para gjykatave vendore nuk dëshmoi se e ka pësuar dëmin e pretenduar, ndërsa GJEDNJ erdhi në përfundim se vendimet e gjykatave vendore nuk kanë qenë arbitrare ose dukshëm të paarsyeshme, kështu që pretendimi përkatës për shkeljen e KEDNJ e vlerësoi si dukshëm të pabazë.

**Konkluzion:** njëzëri

Neni 41: 3.830 euro për kompensim të dëmit jomaterial dhe 700 euro për kompensim të shpenzimeve

**L.R.,** A.nr. 8067/15, aktgjykim nga data 23 janar 2020

**Neni 3 (ndalimi i trajtimit dhe hetimit çnjerëzor ose poshtërues)**

Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues duke zbuluar se autoritetet kishin qenë përgjegjës për vendosjen e L.R.-së në një institut i cili nuk mund të plotësonte nevojat e tij, mungesën e kujdesit të duhur dhe trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues që ai kishte përjetuar dhe shkeljen e Nenit 3 ( hetimi) për shkak të dështimit të autoriteteve për të kryer një hetim të përshtatshëm për çështjen

**Faktet** - Kërkesa u paraqit nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Shkup ("KHDNJ") në emër të L.R.-së, një maqedonas/shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

L.R.-ja u braktis nga prindërit e tij të sëmurë mendërisht pasi ai lindi në vitin 2004. Një qendër e mirëqenies sociale u emërua si kujdestare e tij, e cila qysh atëherë urdhëroi dhe rregulloi vendosjen e tij në disa institucione të kujdesit shoqëror të drejtuara nga shteti. Vonesa në zhvillimin e tij u zbulua kur ai ishte një vjeç dhe, në moshën tre vjeç e gjysmë, një ekip i mjekëve të spitalit e diagnostikuan atë me aftësi të kufizuara mendore, fizike (paralizë cerebrale) dhe në të folur.

Në bazë të kësaj diagnoze, L.R.-ja u vendos në qershor të vitit 2012 në Institutin e Rehabilitimit B.B.S.-së, një institucion shtetëror i tipit të hapur për njerëzit me aftësi të kufizuara fizike. Instituti, si para pranimit të L.R.-së ashtu edhe gjatë gjithë qëndrimit të tij gjatë një viti dhe nëntë muajve të ardhshëm, shprehu vazhdimisht shqetësimet e tij tek autoritetet përkatëse se nuk mund të strehonte persona me aftësi të kufizuara mendore, se ishte me personel të pakët dhe se personeli i tij nuk ishte i kualifikuar për të komunikuar me L.R.-në, i cili ishte i shurdhër dhe i paafhtë për të folur.

Në nëntor të vitit 2013, Avokati i Popullit vizitoi institutin dhe gjeti L.R.-në të lidhur në shtratin e tij, gjë që ai e bëri të ditur në një konferencë shtypi duke prezantuar raportin e tij vjetor, në qershor të vitit 2014.

Menjëherë pas kësaj KHDNJ-ja mori përsipër çështjen e kërkuarit dhe u ankua tek autoritetet e ndjekjes penale. Autoritetet vazhduan të shqyrtojnë dokumentet e ofruara nga instituti dhe Avokati i Popullit dhe të dëgjonin prova gojore nga drejtori i institutit dhe katër punonjës të tij. Ata vërtetuan se vendosja e L.R.-së në institut ishte e papërshtatshme dhe se ai ishte lidhur herë pas here në shtratin e tij me një litar për “arsye sigurie”, domethënë për ta parandaluar atë që të largohej dhe ta vinte veten në rrezik.

Sidoqoftë, ata zbuluan se nuk kishte asnjë bazë për të pohuar se ishte kryer një veprë penale, sepse nuk kishte ekzistuar si qëllim që fëmija ti nënshtrohej në trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Kështu, ankesa u refuzua në vitin 2014. Autoritetet e larta të ndjekjes penale i konfirmuan këto gjetje në vitin 2015.

Në ndërkohë, prokurori i shkallës së parë kishte njoftuar prokurorin me juridiksion mbi spitalin i cili kishte bërë diagnozën mjekësore të L.R.-së në vitin 2008 për një mospërputhje midis konstatimit se ai ishte me të meta të rënda fizike dhe gjendjes së tij të dukshme të shëndetit siç ishte perceptuar nga instituti. Hetimi pasues nuk dha asnjë rezultat.

L.R.-ja u transferua në një institut tjetër në Prill të vitit 2014. Një raport mjekësor deklaroi që ai ka një nivel shumë të ulët zhvillimi, veçanërisht për shkak të stimulimit të pamjaftueshëm dhe trajtimit në kohë.

Duke u mbështetur në Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) dhe Nenin 13 (e drejta për një mjet efektive), L.R.-ja u ankua se ai ishte diagnostikuar gabimisht si i paafhtë fizikisht, gjë që çoi në vendosjen e tij në një institut i cili nuk kishte qenë në gjendje të plotësonte nevojat e tij dhe në një kujdes dhe trajtim joadekuat deri në neglizhencë. Ai gjithashtu u ankua se hetimi mbi pretendimet e tij kishte qenë jo-efektiv.

**Ligji** - Së pari, Gjykata konsideroi se në rrethanat e jashtëzakonshme të çështjes dhe duke pasur parasysh natyrën serioze të pretendimeve, KHDNJ-së duhet t'i jepej e drejta për të vepruar si përfaqësues i kërkuarit. KHDNJ-ja kishte e vizituar kërkuarin menjëherë pasi çështja e tij ishte bërë publike nga Avokati i Popullit, kishte kontaktuar autoritete të ndryshme në lidhje me situatën e tij, kishte paraqitur ankesën penale te prokurori publik pa vonesë dhe e kishte ndjekur çështjen, duke e çuar atë tek autoritetet më të larta të ndjekjes penale.

Neni 3 (Vendosja dhe trajtimi i L.R. në Institutin B.B.S.)

Gjykata pranoi konkluzionet e autoriteteve të ndjekjes penale se vendosja e L.R.-së në Institutin B.B.S kishte qenë e papërshtatshme dhe shtoi se, si rezultat, ai nuk kishte marrë kujdesin që i kërkohej.

Ajo konstatoi veçanërisht befasuese që kujdestari i tij dhe autoritetet e tjera ishin vënë në dijeni që nga fillimi, madje edhe para pranimit të tij në institut, që ai nuk mund të plotësonte nevojat e tij. Sidoqoftë, asgjë nuk ishte bërë në përgjigje të shqetësimeve serioze të personelit dhe vendosja kishte vazhduar për një periudhë të konsiderueshme kohore. Qeveria nuk kishte dhënë asnjë shpjegim për dështimin e autoriteteve për të reaguar në një mënyrë të shpejtë, konkrete dhe të përshtatshme.

Një trajtim i tillë jo i përshtatshëm ishte përkeqësuar nga lidhja e ankuesit në shtratin e tij, gjë që Gjykata e konsideroi të arsyeshme të prezumonte se kishte qenë një praktikë e zakonshme, duke pasur parasysh problemin e personelit të pamjaftueshëm në institut. Gjykata nuk ishte e bindur se një masë e tillë kishte qenë opsioni më pak ndërhyrës i disponueshëm për të garantuar sigurinë e tij. Me sa duket nuk ishte konsideruar asnjë alternativë.

Për më tepër, ajo e konsideroi shqetësuese që një masë e tillë ishte përdorur për dikë aq të pambrojtur sa kërkuari, një fëmijë me aftësi të kufizuara tetë vjeç, i cili ishte i shurdhër dhe nuk mund të fliste dhe për këtë arsye nuk mund të ankohej për trajtimin e tij, për afro një vit dhe nëntë muaj.

Në të vërtetë, një neglizhencë e tillë kishte çuar në një përkeqësim të përgjithshëm të gjendjes së tij, siç theksohet në raportin mjekësor të vitit 2014.

Gjykata konsideroi se autoritetet kishin qenë nën detyrimin për të mbrojtur dinjitetin dhe mirëqenien e kërkuarit pasi ai kishte qenë vazhdimisht në kujdesin e tyre, dhe ata kishin qenë përgjegjës për vendosjen e tij të papërshtatshme në institut, mungesën e kujdesit të duhur dhe trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues që ai kishte duruar. Ajo arriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje të të drejtave të kërkuarit sipas Nenit 3.

### Neni 3 (detyrimi procedural):

Gjykata konstatoi se hetimi mbi pretendimet e KHDNJ-së kishte qenë i plotë. Kishte zgjatur më pak se një vit, ku autoritetet e ndjekjes penale shqyrtuan shumë dokumente, duke dëgjuar ata që përfshiheshin drejtpërdrejt në neglizhencën e pretenduar dhe duke vërtetuar faktet.

Autoritetet kishin konkluduar në veçanti se vendosja e kërkesit kishte qenë e papërshtatshme; që instituti kishte njoftuar autoritetet për pamundësinë e tij për t'u kujdesur për të; dhe se kishte pasur mangësi në lidhje me diagnozën e tij mjekësore.

Këto përfundime, të bëra në kontekstin e akuzave kundër punonjësve të institutit, nuk kishin rezultuar me ndonjë përpjekje efektive për të konstatuar në përgjithësi nëse përfaqësuesit e autoriteteve ose ndonjë nëpunës tjetër publik mund të mbanin përgjegjësi për dështimet e sistemit.

Në të vërtetë, ajo që ishte në diskutim në procedimin përkatës nuk ishte përgjegjësia penale individuale, por përgjegjësia e Shtetit sipas së drejtës ndërkombëtare për të kryer një hetim efektiv.

Për më tepër, hetimi pasues nga një prokuror në një juridiksion tjetër mbi diagnozën e gabuar mjekësore nuk kishte dhënë ndonjë rezultat.

Prandaj, përgjigjja e përgjithshme e autoriteteve ndaj pretendimeve për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ishte jo e përshtatshme, në shkelje të mëtejshme të Nenit 3.

### Neni 13 (e drejta për një mjet efektiv juridik)

Gjykata konstatoi se asnjë çështje e veçantë nuk lindi sipas kësaj dispozite të Konventës dhe për këtë arsye nuk kishte nevojë për të shqyrtuar këtë pjesë të ankesës së kërkesit.

**Përfundim:** Neni 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) (unanimisht)

Shkelja e Nenit 3 (hetimi) gjashtë vota kundër një

Neni 41: 18 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; 1 650 Euro në lidhje me koston dhe shpenzimet

**Trajkovski dhe Çipovski**, A.nr. 53205/13 dhe 63320/13, aktgjykim nga data 13 shkurt 2020

## **Neni 8 – e drejta e jetës private**

Ruajtja e përhershme e të dhënave DNK të siguruara gjatë procedurës penale kundër aplikantëve pa u marrë parasysh aspekti serioz i veprës penale ose të kriterëve të tjera dhe pa pasur pamundësi të kërkohet shlyerja e tyre ose rishikimi i nevojës së ruajtjes së mëtutjeshme

**Fakte** – Në vitin 2010 aplikanti i parë (z. Trajkovski) me dyshimin se ka kryer vjedhje të rëndë është shoqëruar në stacionin policor ku nëpunësit policorë i kanë marrë mostër nga goja. Rezultatet e mostrës-DNK u përdorën në procedurën kundër aplikantit dhe i njëjti u dënua për vjedhje të rëndë. Në vitin 2009 aplikanti i dytë (z. Çipovski) po ashtu është arrestuar me dyshimin se ka kryer vjedhje dhe i është marrë mostër nga goja. Në vitin 2014 aplikanti i dytë u dënua për vjedhje të rëndë, megjithatë analiza-DNK nuk u propozua si provë. Në muajin mars dhe maj të vitit 2010, aplikantët në mënyrë përkatëse kanë paraqitur kërkesë për mbrojtjen e të dhënave personale në Drejtorinë e atëhershme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke pohuar se me marrjen e mostrës-DNK u është shkelur e drejta e privatësisë. Meqë Drejtoria e atëhershme i refuzoi kërkesat e tyre duke thënë se policia ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore, aplikantët ngritën konteste administrative duke pohuar se nuk ka pasur akt normativ me të cilin rregullohet marrja, ruajtja dhe përpunimi i materialeve-DNK, si dhe mungesa e ruajtjes së kufizuar kohore të të dhënave-DNK. Këto padi u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative ndërsa aktgjykimet u konfirmuan nga Gjykata e Lartë Administrative.

E drejta – GJEDNJ gjatë vendimmarrjes në lëndën konkrete e vlerësoi procedimin e autoriteteve vendore, përkatësisht ndërhyrja në të drejtën e jetës private të aplikantëve (meqë marrja e materialit-DNK padyshim se është ndërhyrje në jetën private) a ka qenë në përputhje me ligjin, si synim drejt realizimit të qëllimit legjitim dhe a ka qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata erdhi në përfundim se marrja dhe ruajtja e materialit-DNK nga aplikantët ka qenë e rregulluar me legjislacionin vendor, megjithatë i njëjti nuk ka qenë mjaftueshëm preciz. Gjykata ra dakord se marrja e të dhënave –DNK për synim e ka pasur realizimin e qëllimit legjitim-zbulimin dhe parandalimin e krimit.

Gjykata e shqyrtoi edhe atë se ruajtja e materialeve-DNK (profileve-DNK dhe ruajtjen e tyre) të aplikantëve, konform legjislacionin vendor, a ka qenë proporcional dhe a është

bërë një balancim i drejt midis interesit publik përmes optikës së prizmit të qëllimit legjitim – zbulimit dhe parandalimit të krimit dhe interesit publik të aplikantëve nga aspekti i të drejtës së tyre të privatësisë. Aktgjykimin, në rastin konkret, Gjykata e bazoi mbi parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën e vet gjyqësore në lëndën *S and Marper v the United Kingdom*, A. nr. 30562/04 që kanë të bëjnë me situatën në të cilën aplikantët nuk janë dënuar, e që nuk është rasti edhe në lëndën e Trajkovski-it dhe Çipovski-it, megjithatë GJEDNJ i vlerësoi si relevante dhe të zbatueshme në këtë rast. Në rastin konkret kundër shtetit, Gjykata e mori parasysh se mostrat DNK të aplikantëve dhe profilet DNK të cilat kanë rezultuar nga ato mostra, janë marrë në procedurat penale kundër aplikantëve në të cilat ishin të dyshuar për vjedhje të rënda, por edhe atë se dënimi i aplikantit të parë është bazuar në gjetjet-DNK, që nuk ka qenë rast edhe me aplikantin e dytë, si dhe atë se të dhënat-DNK, duke i përfshirë edhe profilet-DNK të aplikantëve nuk janë përdorur në asnjë procedurë tjetër penale kundër tyre, megjithatë konkludoi se veçanërisht kjo e fundit është relevante për vendimin e saj në këtë rast.

Gjykata e mori parasysh se në legjislacionin pozitiv i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së mostrave-DNK, përkatësisht të materialit biologjik nga aplikantët, nuk është përcaktuar një periudhë specifike e ruajtjes së të dhënave-DNK, por edhe atë se në përputhje me ndryshimet në vijim të Ligjit për polici, të cilat akoma janë pjesë të legjislacionit pozitiv, të dhënat-DNK ruhen përgjithmonë.

Sipas Gjykatës, terminologjia në ligjet relevante të cilët kanë qenë në fuqi në periudhën kritike, përkatësisht “të dhënat ruhen derisa të përmbushet qëllimi për të cilin janë marrë” neni 5 i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale i cili pushoi të vlejë me miratimin e Ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale (“Gazeta Zyrtare” nr. 42/2020) lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Nga ana tjetër, dispozita në fuqi e neneve 69 dhe 75 të Ligjit për polici (dispozitat e nenit 75 të ndryshuara me nenin 54 të ndryshimeve dhe plotësimeve në fuqi nga 1 dhjetori i vitit 2012), sipas të cilave “të dhënat-DNK do të ruhen përgjithmonë” nënkupton se nuk ka periudhë të caktuar të ruajtjes, e që Gjykata e vlerësoi në kundërshtim me standardet e të drejtës ndërkombëtare. Gjykata i kishte parasysh edhe dispozitat relevante të Ligjit për procedurë penale, megjithatë vlerësoi se ato janë të pazbatueshme për situatën, në të cilën kanë qenë aplikantët meqë kanë të bëjnë me raste kur kundër personit në fjalë nuk është ngritur procedurë penale, e që nuk ishte rast me aplikantët. Pastaj, Gjykata e vuri në dukje se natyra ose rëndësia e veprës për të cilën është dënuar personi, ose dënimi i shqiptuar ose cilado qofshin kriteret të definuara të tjera, nuk kanë ndikim mbi marrjen dhe ruajtjen e të dhënave-DNK. Gjykata konsideron se edhe



pse policia, konform dispozitave të Ligjit për polici, ka autorizim t'i shlyej të dhënat personale nga regjistrat, Ligji nuk i përcakton kushtet me të cilat mund të bëhet një gjë e këtillë dhe procedurën që duhet të ndiqet. Pastaj, Gjykata e vë në dukje atë se edhe pse Ligji në përgjithësi parashikon mundësi për mbikëqyrje gjyqësore, megjithatë, nuk ka dispozitë e cila lejon rishikim specifik të nevojës së ruajtjes së të dhënave. Po ashtu, Gjykata e vuri në dukje atë se nuk ekziston dispozitë sipas së cilës personi i prekur mund të kërkojë të dhëna që kanë të bëjnë me atë ose jo të shlyhen nëse ruajtja e të dhënave nuk është më e nevojshme duke e pasur parasysh natyrën e veprës, moshën e personit të prekur ose kohën që ka kaluar.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, Gjykata konsideron se për shkak të karakterit të përgjithshëm dhe joselektiv të autorizimeve të ruajtjes së profileve-DNK të aplikantëve, si persona të dënuar për vepra penale, si dhe mungesa e masave mbrojtëse të aksesshme për aplikantët nuk është arritur balancë i drejt midis interesit publik dhe privat dhe është tejkaluar margjina e pranueshme e respektimit të cilën e ka shteti. Në përputhje me këtë, Gjykata erdhi në përfundim se ruajtja e materialeve-DNK të aplikantëve është ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e tyre të jetës private dhe nuk mund të konsiderohet se është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, dhe për këtë shkak është përcaktuar shkella e Nenit 8 të Konventës.

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: Gjykata konsideron se përcaktimi i shkeljes vetvetiu nënkupton dëmshpërblim të mjaftueshëm ligjor të dëmit jomaterial të pësuar nga aplikantët

**Strezovski dhe 7 aplikantë të tjerë**, A.nr.14460/16, 14958/16, 14962/16, 14966/16, 27884/16, 16064/17, 20229/17 dhe 30206/17, aktgjykim nga data 27 shkurt 2020

### **Neni 1 i Protokollit nr. 1 – e drejta e pronësisë, gëzimi paqësor i pronësisë**

Detyrimin e imponuar aplikantët pronarë të apartamenteve, të shkyçur nga sistemi i ngrohjes qendrore të paguajnë kompensim për fuqinë e angazhuar sipas Rregullave të furnizimit me energji termike në procedurë në të cilën nuk ka pasur garanci të mjaftueshme procesuale gjatë zbatimit të legjislacionit vendor

**Fakte** – Aplikantët, të cilët janë pronarë të apartamenteve të shkyçur nga sistemi i ngrohjes qendrore që i furnizon objektet e tyre kolektive të banimit, u ankuan se detyrimi të paguajnë kompensim për fuqinë e angazhuar sipas Rregullave të furnizimit

me energji termike (“Rregulla nga viti 2012”) furnizuesve privat me energji termike, e ka shkelur të drejtën e tyre për gëzim paqësor të pronësisë, në përputhje me Nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Në rastet e tetë aplikantëve paraqiten tri gjendje të ndryshme faktike – apartamentet e tyre asnjëherë nuk kanë qenë të lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore të ndërtesës, ose janë shkyçur nga sistemi para 30 qershorit të vitit 2012 kur u miratuan Rregullat e lartpërmendura, ose apartamenti është shkyçur para miratimit të Rregullave, por me kërkesë të ish- pronarit të apartamentit.

GJEDNJ e kishte parasysh atë se më 22 maj të vitit 2013, Gjykata Kushtetuese i shpalli për kushtetuese dispozitat kontestuese të Rregullores, duke u thirr në “natyrën specifike të objekteve kolektive të banimit”, dhe e ka pasur në konsideratë atë se “për shkak të transmetimit të energjisë termike nëpër materien, nga një zonë me temperaturë më të lartë në një zonë me temperaturë më të ulët (konduksioni termik)” dhe tuba të cilat kalojnë nëpër apartamentet, apartamentet e shkyçur në mënyrë “pasive” e marrin ngrohtësinë nga apartamentet e ndërtesës të cilët janë të lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore. Sipas kësaj, apartamentet e shkyçura për shkak të ngrohtësisë që e pranojnë në llogari të apartamenteve që e shfrytëzojnë shërbimin e siguruar përmes sistemit të ngrohjes qendrore të instaluar në ndërtesë, duhet të llogariten si “shfrytëzues pasiv të energjisë termike të cilën e pranojnë nga apartamentet fqinje dhe nga apartamentet e tjera të ndërtesës” të cilat janë të lidhura me këtë sistem.

GJEDNJ erdhi në përfundim se furnizuesit privat me energji termike kanë lëshuar fatura duke i ngarkuar aplikantët ta paguajnë kompensimin për fuqi të angazhuar, ndërsa pasi që të njëjtit nuk e kanë bërë pagesën, noteri i ka aprovuar kërkesat e furnizuesve për ekzekutimin e faturave të papaguara dhe ka lëshuar aktvendime për lejimin e ekzekutimit për disa fatura të papaguara mujore. Faturat mujore të cilat është dashur t’i paguajnë aplikantët ka lëvizur nga 5 deri 29 euro.

GJEDNJ, veç tjerash, në aktgjykimin konstatoi se aplikantët kanë paraqitur kundërshtim kundër aktvendimeve për ekzekutim para Gjykatës Themelore Shkup duke pohuar (i) se nuk kanë lidhur kontratë me furnizuesin; (ii) se kompensimi është inkorporuar me Rregullat nga viti 2012, edhe përkrah faktit se detyrimi i këtillë mund të inkorporohet vetëm me ligj; (iii) se Ligji për energjetikë nuk i përfshin terminet “shfrytëzues të shkyçur” dhe “shfrytëzues pasiv” të inkorporuara me Rregullat nga viti 2012; (iv) se apartamentet e tyre ose asnjëherë nuk kanë qenë të lidhura ose kanë qenë të shkyçura nga sistemi i ngrohjes qendrore para se të hyjnë në fuqi Rregullat

nga viti 2012; dhe (v) se kanë fituar ose kanë fituar pak apo aspak energji termike meqë nuk kanë pasur tuba të cilët kalojnë në apartamentet e tyre dhe/ose të gjitha apartamentet fqinje po ashtu kanë qenë të shkyçura.

**E drejta** – GJEDNJ erdhi në përfundim se masa kontestuese është një mjet për kontrollin shtetëror të shfrytëzimit të pronësisë në kuptimin e paragrafit të dytë të Nenit 1 nga Protokollin numër 1, kështu që duke e aplikuar testin e vet standard, kur bëhet fjalë për të drejtën e pronësisë, konstatoi se masa e kontestuar ka qenë e ligjshme dhe pranoi se e njëjta ka qenë në interes të përgjithshëm.

Megjithatë, GJEDNJ konstatoi mungesë të proporcionalitetit, përkatësisht “balancim të drejtë” midis kërkesave në interes të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore individuale të aplikantëve për shkak të mungesës së garancive të mjaftueshme procedurale gjatë zbatimit të së drejtës vendore nga ana e gjykatave vendore në lidhje me arkëtimin e “kompensimit tek të shkyçurit” nga sistemi i ngrohjes qendrore.

Në vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata fillimisht nënvizoi se aplikantët i kanë shkyçur apartamentet e tyre nga sistemi i ngrohjes qendrore para se të miratohen Rregullat e vitit 2012, dhe prandaj në kohë relevante aplikantët nuk kishin mundësi të parashikojnë me siguri të arsyeshme se në të ardhmen, do të inkorporohet kompensimi për fuqinë e angazhuar madje as shumë e saj. Detyrimi për pagesën e kompensimit ishte në fuqi së paku gjashtë vjet e gjysmë dhe së këtejmi nuk mund të konsiderohet se barra e përgjithshme financiare e aplikantëve ka qenë e papërfillshme.

Gjykata vuri në dukje se autoritetet gjyqësore, që e kanë trajtuar këtë çështje, e kanë justifikuar arkëtimin e kompensimit vetëm duke theksuar se ata në mënyrë pasive e kanë shfrytëzuar energjinë termike të siguruar në ndërtesë përmes sistemit të ngrohjes qendrore. Pas përcaktimit të Gjykatës Kushtetuese të parimit sipas të cilit apartamentet e shkyçura janë “shfrytëzues pasiv”, gjykatat me kompetencë të përgjithshme e kanë aplikuar qasjen e njëjtë më shumë se pesë vjet, përkatësisht deri në momentin kur Gjykata Supreme e kufizoi vëllimin e zbatimit të kësaj qasje me përjashtimin e një kategorie të caktuar të apartamenteve nëse i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në opinionin e tij juridik. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se ky opinion nuk është zbatuar në mënyrë konsekuente nga ana e gjykatave kompetente.

Së këtejmi, në bazë të vendimeve të miratuara nga gjykatat vendore në lëndët konkrete me të cilat kanë të bëjnë aplikimet për të cilat u miratua aktgjykimi i lëndës (PLP. 1486/13; 1487/14; 1794/14; 1824/14; 1907/14; 2133/14; 2837/14 dhe 977/15),

GJEDNJ erdhi në përfundim se gjykatat vendore duke iu referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe pa këqyrje në aty për aty, (përveç rastit me aplikanten e gjashtë) ose pa dhënë urdhër për akt ekspertizë, i refuzuan kundërshtimet e aplikantëve dhe i konfirmuan aktvendimet për ekzekutim, duke theksuar se aplikantët janë “shfrytëzues pasivë” të energjisë termike të distribuuar në ndërtesë përmes rrjetit të ngrohjes qendrore, dhe sipas kësaj e kanë për detyrë ta paguajnë kompensimin për fuqi të angazhuar, siç është theksuar në Rregullat e vitit 2012. Gjykatat vendore në dy instanca kanë theksuar se “të gjitha apartamentet (e shkyçura) të ndërtesës të cilët janë lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore e kanë pasur për detyrë të paguajnë për kompensim për fuqinë e angazhuar, pavarësisht pozitës ose kompozicionit apo konstruksionit të instalimit të brendshëm”. GJEDNJ erdhi në përfundim se kjo është një qasje blanko dhe është bazuar vetëm mbi presupozimin se aplikantët kanë shfrytëzuar energji termike e cila është distribuuar në ndërtesë përmes sistemit të ngrohjes qendrore.

GJEDNJ mori qëndrim se nevojitet, gjykatat vendore të cilat i kanë trajtuar kundërshtimet e aplikantëve në tetë lëndët kontestuese, kundër urdhrave për ekzekutim për qëllimet e arkëtimit të detyrueshëm të kompensimit të fuqisë së angazhuar, t’i përcaktojnë të gjitha faktet relevante në lidhje me sasinë e energjisë termike e cila u është livruar aplikantëve, në mënyrë që të kenë vlerësim objektiv për dhe rreth shfrytëzimit “indirekt” të energjisë termike nga ana e aplikantëve. GJEDNJ erdhi në përfundim se në procedurat vendore, rrethanat individuale që kanë të bëjnë me apartamentet e aplikantëve nuk kanë pasur kurrfarë roli gjatë vendimmarrjes së gjyqtarëve në lidhje me kërkesat e tyre dhe se është dashur të përcaktohen faktet të cilat janë kontestuar nga aplikantët, përmes verifikimit të argumenteve të tyre dhe se vetëm në këtë mënyrë do të ishte e mundshme që autoritetet vendore të bëjnë një vlerësim objektiv të shfrytëzimit “pasiv” të energjisë termike.

Përfundimisht, edhe pse masa e përgjithshme në parim mund të konsiderohet se ka qenë me interes të përgjithshëm, sipas qëndrimeve të GJEDNJ fakti se në këtë rast ka ekzistuar edhe interesi implicit privat i natyrës komerciale nuk guxon të anashkalohej, me ç’rast shteti është dashur ta zbatoj rolin mbikëqyrës nga aspekti i asaj që masat të mos shkaktojnë disbalancë që u imponon barrë të tepër aplikantëve.

Duke i pasur parasysh shkaqet për shkeljen e konstatuar të KEDNJ, GJEDNJ e vuri në dukje mundësinë e përsëritjes së procedurave kontestuese, si masë individuale e qëllimeve të ekzekutimit të aktgjykimit të GJEDNJ.

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 320 euro për aplikanten e parë për shpenzime; 1.000 euro për dëm jomaterial dhe 2.100 euro për shpenzime për aplikantin e shtatë; dhe 1000 euro për dëm jomaterial dhe 360 euro për shpenzime për aplikantin e tetë.

**Auto Atom SHPK Koçani**, A.nr.21954/16, aktgjykim nga data 28 maj 2020

### **Neni 1 i Protokollit nr. 1 – e drejta e pronësisë, gëzimi paqësor i pronësisë**

Shkelja e të drejtës së gëzimit paqësor të pronësisë të kompanisë aplikante për shkak të privimit nga e drejta e zbritjes së TVSH-së të cilën ajo ia ka paguar furnizuesit i cili në kundërshtim me ligjin nuk ka qenë i regjistruar si obligues i TVSH-së.

**Fakte** – Kompania-aplikante është e specializuar për transportin e udhëtarëve me autobusë dhe ka qenë obligues i regjistruar tatimor në përputhje me dispozitat e Ligjit për tatimin e vlerës së shtuar. Kjo kompani, ka paraqitur tatim të vlerës së shtuar (TVSH) për të gjitha faturat hyrëse dhe dalëse, dhe për këtë shkak i është mundësuar të kërkojë zbritjen e TVSH-së. Në vitin 2007, gjatë kontrollit nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Publike (DAP) është konstatuar se njëri nga furnizuesit e kompanisë-aplikante nuk ka qenë i regjistruar si obligues TVSH. Për shkak të kësaj se faturat e lëshuara nga furnizuesi kanë pasur numër tatimor dhe në të njëjtat është përcaktuar TVSH, kompania-aplikante në bazë të këtyre faturave ka pasur kërkesa për zbritjen e TVSH-së. Në bazë të këtyre konstatimeve DAP kompanisë-aplikante i lëshoi urdhër pagesë në shumën e realizuar të obligimit për zbritjen e TVSH-së së kompanisë-aplikante në bazë të faturave të lëshuara nga furnizuesi, të cilën kompania aplikante përkundrejt faktit se e kishte paguar, të njëjtën e kontestoi. Pas dy vendimmarrjeve të përsëritura Gjykata Administrative e hodhi poshtë padinë e kompanisë-aplikante duke konstatuar se nuk e ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së, meqë furnizuesi nuk ka qenë i regjistruar si obligues TVSH. Gjykata e Lartë Administrative e konfirmoi këtë vendim.

Në vitin 2006 kompania-furnizuese u shlye nga Regjistri i kompanive, ndërsa në vitin 2009 u nxor aktgjykimi me të cilin pronari i kompanisë-furnizuese u dënua me dënim të kushtëzuar me burgim për evazion tatimor, për periudhën e njëjtë me të cilën ka të bëjë edhe urdhërpagesa e kompanisë-aplikante.

**E drejta** – GJEDNJ erdhi në përfundim se kompania-aplikante ka pasur besim në faturat e lëshuara nga furnizuesi të cilat kanë pasur numër tatimor dhe në të njëjtat

është përcaktuar TVSH-ja, si dhe atë se kompania-aplikante nuk ka pasur motive në periudhën relevante të dyshoj në punën e paligjshme të furnizuesit dhe se e njëjta nuk ka pasur kurrfarë mjete të aksesshme për mbikëqyrje dhe kontroll të harmonizimit të furnizuesit me detyrimet e tij të TVSH. Gjykata, mes tjerash, konstatoi se nuk është e qartë pse shteti nuk ka pasur sukses që ta kërkojë shumën e përgjithshme të TVSH-së nga pronari i furnizuesit në procedurën kundër tij.

GJEDNJ, veç tjerash, konsideron se arkëtimi i një pjese të borxhit të TVSH të kompanisë-furnizuese nga pronari i saj e vë në dukje atë se ka ekzistuar mundësia për arkëtimin e plotë të borxhit të TVSH nga i njëjti, dhe jo nga kompania-aplikante. Në përputhje me këtë, Gjykata konsideron se mos lejimi i zbritjes së TVSH-së së kompanisë-aplikante nuk mund të konsiderohet si i arsyeshëm për nevojën e arkëtimit të tatimeve.

**Konkluzion:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 52.468 euro, shumë të cilën kompania-aplikante e ka paguar në bazë të urdhërpagesës së lëshuar nga DAP për dëmin material, 600 euro për shpenzime.

# IRZ



Makavej, 2020